



**KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT**

# **RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2021**

---

## **STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

### **I. Informacion përmbledhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planit të Veprimit 2020-2023**

- 1.1 Metodologjia e monitorimit
- 1.2 Konsultimi publik

### **II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit**

- 2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës
- 2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian
- 2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit
- 2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

### **III. Progresi i lidhur me qëllimet politikë, objektivat specifike dhe masat**

- 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 3.3 Konkluzione dhe rekomandime

### **IV. Risqet /risku dhe hapat për të adresuar**

- 4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit
- 4.2 Hapat e radhës

## **ANEKSE:**

ANEKSI I: RAPORTIMI I AKTIVITETEVE DHE MASAVE

ANEKSI II: RAPORTIMI I INDIKATORËVE DHE OBJEKTIVAVE

## LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
NDI	Instituti Kombëtar i Demokracisë
NJP	Njësi Përgjegjëse
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
VJC	Vlerësime të Jashtme të Cilësisë
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## **I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2023 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2020-2023**

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi.

Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë.

Qeveria shqiptare ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritet evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 01.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023.

Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*.

Qëllimet madhore të politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit parashikojnë objektiva dhe masa specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Gjatë tre vjeçarit të parë të SNKK, institucionet implementuan masa konkrete antikorrupsion të parashikuara në Planin e Veprimit 2015-2017. Në vijim, Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit rishikoi Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, në mënyrë që të mundësonte përshtatjen e Strategjisë me realitetet e reja dhe prioritetet e sektorëve. Plani i Veprimit 2018 – 2020, ishte plani i dytë

i veprimit në zbatim të Strategjisë, i cili pasi kaloi nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në luftën kundër korrupsionit, institucione të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile etj, çoi në një nivel më të lartë luftën kundër korrupsionit. Në hartimin e këtij dokumenti u morën parasysh dhe u reflektuan edhe ndryshimet e ndodhura si pasojë e reformave të ndërmarra si Reforma në Drejtësi dhe Reforma Administrative Territoriale.

Pasaporta e Treguesve u miratua në vitin 2018, me vendimin nr.241, datë 20.04.2018, të Këshillit të Ministrave, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie. Në këtë vendim u miratua edhe krijimi i Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK-së dhe të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Komiteti Koordinator kryesohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje 10 anëtarë, në nivel Zëvendësministri nga secila Ministri linje (pa përfshirë këtu 2 Ministritë pa portofol). Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion është përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të SNKK. Ajo kryesohet nga Ministri i Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Antikorrupsion dhe ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektoriati Qendror.

Në datë 01.07.2020, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.516, i cili miratoi zgjatjen e afatit të zbatimit të SNKK deri në vitin 2023, Planin e ri të Veprimit në zbatim të saj për periudhën 2020–2023 të shoqëruar nga një rishikim i vlerave të treguesve (aneksi 2: Pasaporta e Indikatorëve) për vitet e zbatimit të planit të veprimit (2020-2021-2022-2023).


Plani i Veprimit 2020-2023 përmban 83 masa për zbatimin e të cilave janë të përfshira 22 institucione, të cilat do të punojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend. Masa prioritare të këtij plani veprimi janë forcimi i transparencës së institucioneve publike, shtimi i shërbimeve publike online në mënyrë progresive, fillimi nga zbatimi i deklarimit të pasurive online të zyrtarëve publikë, ngritja dhe zbatimi i instrumenteve të luftës së korrupsionit në administratën publike (planet e integritetit), forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve dhe agjencive ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit, rritja e forcës ndëshkuese të korrupsionit nga institucionet e posaçme të fushës, ndërveprim i shtuar i autoriteteve që marrin denoncimeve kundër korrupsionit dhe deri në ndërshkrimin e tij, forcimi i ndërgjegjësimit publik dhe sensibilizim i shtuar i publikut. Këto masa vijnë në përputhje me agjendën e mirëqeverisjes dhe synojnë t'i japin një hov më cilësor zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

Ky raport monitorimi, pasqyron progresin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit, për periudhën *janar-dhjetor 2021*, që korrespondon me vitin e dytë të zbatimit të planit të veprimit në fuqi. Raporti do të ofrojë një informacion mbi progresin e arritur në zbatimin e reformave të fushës

antikorrupsion kundrejt çdo qëllimi politik, objektivi specifik, bazuar në statusin e arritjeve të treguesve të performancës dhe të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit për vitin 2021.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2021*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 64 masa e 119 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 33 masa e 66 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 22 masa e 31 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 9 masa e 22 aktivitete për qasjen ndërgjegjëse (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit gjatë periudhës *janar - dhjetor 2021* janë realizuar plotësisht 37 masa, pjesërisht 20 masa dhe nuk janë realizuar 7 masa si dhe janë realizuar plotësisht 77 aktivitete, pjesërisht 16 aktivitete dhe nuk janë realizuar 26 aktivitete.



Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektivave të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe të treguesve të performancës.


Objektivat	Shkalla e realizimit sipas masave
A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	86 në 110 për qind e masave të realizuara
A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	51 në 85 për qind e masave të realizuara

A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të realizuara
A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	86 në 110 për qind e masave të realizuara
A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	86 në 110 për qind e masave të realizuara
A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.	31 deri në 50 për qind e masave të realizuara
C.1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
C.2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 to 30 për qind e masave të realizuara

Për këtë periudhë *janar - dhjetor 2020*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 37 tregues performance, të shpërdarë përkatësisht në 21 tregues për objektivat specifike në qasjen

parandaluese, 9 tregues për objektivat specifike në qasjen ndëshkuese dhe 7 tregues për objektivat specifike në qasjen ndërgjegjësuese. Gjatë vitit 2021, janë arritur vlerat e synuara për 21 tregues performance, pjesërisht për 4 tregues performance dhe nuk janë arritur për 12 tregues performance.

Qasja	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht <sup>1</sup>	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht <sup>2</sup>	Vlera e synuar nuk është e realizuar <sup>3</sup>
Parandaluese	21	13	2	6
Ndëshkuese	9	3	2	4
Ndërgjegjësuese	7	5	0	2
<b>Total</b>	<b>37</b>	<b>21</b>	<b>4</b>	<b>12</b>



Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektiveve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të treguesve të performancës:

<sup>1</sup> Që është realizuar në shkallën 100 për qind

<sup>2</sup> Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>3</sup> Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna



Objektivat		Shkalla e realizimit sipas treguesve të performancës <sup>4</sup>
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	115%
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	100%
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	180%
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	100%
	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	75%
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	80%
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	59.2 <sup>5</sup>
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	100%
	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	100%
	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	100%
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	25%
Ndë shki	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	50%

<sup>4</sup> Përllogaritur sipas formulës  $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$

<sup>5</sup> Matja e Objektivit A7 është kryer vetëm me vlerësimin dhe matjen e tre treguesve të performancës të tij, përkatësisht A7.b dhe A7.c dhe A7d. Treguesi A7.a nuk mund të matet për këtë raport monitorimi pasi është në pamundësi raportimi nga MFE. Ky tregues për vitin 2021 do të raportohet në maj 2022.

	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit	50%
	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	25%
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	50%
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjërë mbi pasojat e korrupsionit	100%
	C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	100%
	C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	33%

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se, progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim, paraqitet:

Qasja Parandaluese (A)	94.01 %
Qasja Ndëshkuese (B)	43.75 %
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	76.66 %

Për këtë periudhë *janar – dhjetor 2021*, janë shënuar arritje të mira në qasjen parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) të zbatimit të strategjisë, përmendim:

- KDIMDHP ka vijuar me kryerjen e monitorimit ndaj të gjithë koordinatorëve të autoriteteve publike për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 36 autoritete publike të shtuara, gjatë vitit 2021, duke e çuar numrin total të autoriteteve publike në 95. Gjatë këtij viti, e kanë publikuar Programin e Transparencës 242 nga 313 autoritete publike dhe 58 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore.
- APP ka miratuar rregullat e reja të prokurimit publik, të cilat detajojnë përmbajtjen e njoftimeve paraprake. Janë miratuar 29 sete të dokumentave standarde të tenderit sipas tipit të kontratës mall, punë apo shërbim, pjesë e të cilave janë edhe formularët standard për këto njoftime.
- AKSHI ka tejkaluar numrin e shërbimeve online të shtuara dhe në përdorim. Janë 1 212 shërbime në shërbim të plotë të qytetarëve (nga 670 që ishte vlera e synuar për vitin 2021), duke e realizuar me 542 më shumë.

- Janë hartuar, miratuar, publikuar Planet e Integritetit në 12 institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
- ILDKPKI ka hartuar dhe miratuar aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklaramit dhe ka krijuar të gjithë databazën e nevojshme për fillimin nga përdorimi të sistemit të deklaramit të interesave private EACIDS. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e këtyre formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklaramit elektronik EACIDS. <https://www.ildkpkj.al/akte-nenligjore>.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka realizuar 25 vlerësime të jashtme të cilësisë, përkatësisht në Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin e Mjeksësisë Tiranë, Ujësjetllës Kanalizime Vlorë, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, Spitalin Rajonal Gjirokastër, Qendrën Spitalore Berat, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ALBCONTROL, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Bashkinë Kavajë, Bashkinë Kolonjë, Bashkinë Dibër, Bashkinë Shkodër, Bashkinë Lezhë, Kuvend, Radio Televizionin Shqiptar, OST sha, Postën Shqiptare sha, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Dropull, KLGJ, Universitetin e Mjekësisë, Bashkinë Roskovec dhe Bashkinë Patos, janë evidentuar mangësitë dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
- AAPSK ka ngritur regjistrin elektronik për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, që administrohet nga kjo Agjenci. Ky regjistër është funksional në 90% të tij dhe institucionet janë në fazën e aksesimit në të.
- Policia e Shtetit ka arritur të ketë akses në 9 baza të dhënash të reja (sistemi konsultimi jashtë saj) duke e çuar numrin total të tyre në përdorim të saj, në 21. Në total, janë 60 sisteme të dhënash me të cilat operon dhe ka funksionalitet.
- Policia e Shtetit (Drejtoria për Krimin Ekonomik dhe Financiar) gjatë vitit 2021 ka trajtuar/shkëmbyer 569 praktika me Interpolin, nga të cilat 403 me sektorin e Krimin Ekonomik dhe Financiar dhe 166 nga Sektori për Pastrimin e Parave dhe Aseteve Kriminale; me Europol janë trajtuar/shkëmbyer 200 praktika, nga të cilat 116 nga Sektori për Krimin Ekonomik e Financiar dhe 84 nga Sektori për Pastrimin e Parave; me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë trajtuar/shkëmbyer gjithashtu 284 praktika.
- SPAK ka hetuar gjithsej 255 procedime me 129 persona në hetim. Janë regjistruar gjithsej 123 procedime me 56 persona nën hetim përgjatë vitit. Gjithsej, janë përfunduar 90 procedime penale me 80 persona. Janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 25 procedime penale me 53 të pandehur ndërsa me kërkesë për pushim, 21 procedime penale me 8 persona në hetim. Janë transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 35 procedime penale me 19 persona në hetim. Janë pezulluar 9 procedime penale dhe mbeten në hetim 153 procedime penale me 48 persona në hetim.
- SHÇBA ka vijuar punën me inspektimin e veprimtarisë së strukturave, aplikimit dhe përdorimit të formave dhe metodave të veprimtarisë inteligjente dhe kryerjes së hetimeve paraprake për dyshime të arsyeshme mbi implikimin e punonjësve të strukturave, subjekt i

veprimtarisë së Shërbimit, në veprimtari të kundërligjshme. Në përfundim, janë referuar pranë organit të Prokurorisë 224 çështje për 329 subjekte, të cilat sipas nivelit të drejtimit, ndahen në: 88 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 223 punonjës policie të nivelit zbatues; 10 punonjës civil (administrativ); 3 efektiv të Gardës; 5 PMNZSH dhe 61 shtetas.

- Gjatë vitit 2021, janë përgatitur dhe publikuar video ndërgjegjësimi për të denoncuar raste korrupsioni në institucione të ndryshme. Është rishikuar dhe zbatuar Plani Vjetor 2021 i Vizibilitetit dhe Komunikimit në fushën e antikorrupsionit. Janë ndërmarrë aktivitete, takime, forume, konferenca me grupe interesi në fusha të ndryshme si akademi, sport, biznes, shoqëri civile, etj. Ka pasur bashkëpunim dhe konsultim të shtuar të akteve dhe dokumentave të politikave dhe të monitorimit në fushën antikorrupsion.

Gjatë vitit 2021, janë identifikuar gjithashtu edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa prej objektivave të strategjisë dhe në arritjet e qëllimit themelor dhe përfundimtar të politikave.

Sfida kryesore të zbatimit të planit të veprimit mund të përmenden:

- Kryerja dhe analiza paraprake e raportit të monitorimit nga të gjitha institucionet raportuese, sipas metodologjisë së kërkuar.
- Monitorimi i ecurisë së vlerës së treguesve të performancës miratuar me Pasaportën e Indikatorëve (vlera e synuar vjetore krahasueshmërisht me treguesin e arritur në vitin 2020).
- Problematika me koordinimin dhe bashkërendimin e kryerjes së objektivëve të përbashkët të Strategjisë.
- Çështje që lidhen me mjedisin e brendshëm rregullativ, kapacitetet planifikuese e administrative, proceset operacionale dhe komunikimin institucional.
- Analiza e faktorëve të riskut që shoqërojnë arritjen e vlerës së synuar për secilin tregues performance.
- Identifikimi i vështirësive kryesore dhe adresimi i pengesave serioze nga institucionet që kanë një nivel të ulët realizueshmërie, të objektivëve strategjikë.

## ***1.1 Metodologjia e monitorimit***

### **1.1.1 Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 20.10.2021 dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.128, datë 08.11.2021, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë dhe është ngritur Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, e cila është

struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015 - 2023.

Ministria e Drejtësisë kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNKK) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2021 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

### **1.1.2 Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNKK-së për 2 vitet e ardhshme.

### **1.1.3 Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS**

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencinë SASPAC.

### **1.1.4 Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes**

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e acquis, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë acquis. Në fushat e tjera, parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre parimeve themelore. Bashkërendimi për vlerësimin e raportit të monitorimit<sup>6</sup> dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

---

<sup>6</sup> Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovet në strukturat vendimmarrëse

### **1.1.5 Mekanizimi i Integruar i Politikave**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).<sup>7</sup>

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

### **1.1.6 Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që do të ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit dhe monitorimit të performancës, paraqiten si më poshtë:

**Faza 1:** dërgimi i kërkesës për kontribut në datë 5 janar 2022 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;

**Faza 2:** dërgimi i paketës së plotë për vlerësim më datë 04.03.2022 pranë Njësisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

**Faza 3:** konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

**Faza 4:** organizimi i mbledhjes së GTA-së më datë 13.03.2022 për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;

**Faza 5:** reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;

**Faza 6:** publikimi i raportit vjetor në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

---

<sup>7</sup> Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

**Faza 7:** dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njesisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

**Faza 8:** dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

### **1.1.7 Parimet e Mirëqeverisjes që do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatojë parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- **EFIKASITETI:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, aktivitetet, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **LLOGARIDHËNIA:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **RËNDËSIA:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

#### **Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim**

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit.
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe raporti i monitorimit është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në webin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marrë në konsideratë).

- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integritimit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

### **Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat**

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës. Është vlerësuar analiza përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raportin e monitorimit se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/jo rezultative, vs performancën më të lartë të objektivave, duke përdorur treguesit e rezultateve, përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave.
- Treguesit e Performancës janë pjesë e analizës për çdo qëllim politike dhe çdo objektiv specifik dhe jepen me premisa krahasueshmërie në vite apo për periudha të caktuara.
- Konkulzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrigjime/përmirësim për t'u adresuar në vendimmarrje.

### **Performanca e kategorizuar sipas standarteve**

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Eshtë llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.
- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me çdo objektiv të veçantë. (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës)
- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu Intervali është përcaktuar në bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkualuar)

### **Risqet**

- Shkalla në të cilën identifikohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Shkalla në të cilën analizohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.



- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

### **Analizat financiare**

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

### **Plani i Veprimit**

- Plani është zbërthyer në realizueshmërinë e masave/produkte/aktivitete.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.
- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore)

#### **1.1.8 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës**

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.

Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përlogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

**E zbatuar:** është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.

**Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

**E pazbatuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përlogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës është përdorur formula si më poshtë <sup>8</sup>:

$$NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$$

Përlogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:<sup>9</sup>

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga katër qëllimet e politikave: 1. Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien; 2. Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane; 3. Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit; 4. Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

### **Matrica e Riskut**

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë<sup>10</sup>:

<sup>8</sup> Formula e përlogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.

<sup>9</sup> Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

<sup>10</sup> Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

Mundësia	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8
	E ulët	1	4	7
		E ulët	E mesme	E lartë
		Ndikimi		

### 1.1.9 Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 04.03.2022 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe me datë 04.03.2022 publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit [www.drejtësia.gov.al](http://www.drejtësia.gov.al), në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar datë 29 mars 2022, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ministrisë, [www.drejtësia.gov.al](http://www.drejtësia.gov.al).

## II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të

zbatimit të Planit të Veprimit 2020 - 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021*.

## **2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës**

Zbatimi i SNKK kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritetit evropian.

SNKK ka identifikuar tre qëllime kryesore politikash (Qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifike, si më poshtë:

**Qasja Parandaluese** ka për qëllim forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo qasje ka dhe numrin më të madh të objektivave dhe për pasojë dhe masave/aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikojnë të zbatojnë për arritje e objektivave:

- A.1 *Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*
- A.2 *Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike*
- A.3 *Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike*
- A.4 *Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit*
- A.5 *Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave*
- A.6 *Forcimi i regjimit të kontroleve mbi financimin e partive politike*
- A.7 *Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut*
- A.8 *Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion*
- A.9 *Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë*
- A.10 *Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit*
- A.11 *Adaptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore*

**Qasja Ndëshkuese** ka për qëllim të forcojë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, të ndëshkojë aktet korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe të garantojë integritetin e organeve shtetërore. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- B.1 *Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*
- B.2 *Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit*
- B.3 *Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar*

*B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit*

**Qasja Ndërgjegjësuese** ka për qëllim përfshirjen e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive kanalet për ta denoncuar atë. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit*
- C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit*
- C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

***Realizueshmëria e objektivave specifike të të tre qëllimeve të politikave (3 qasjeve) të SNKK, në nivel objektiv***

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të qëllimeve të politikës dhe pjestuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitucional kundër korrupsionit, për këtë periudhë monitorimi është 71.47%.

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	115%
A.2.	100%
A.3	180%
A.4	100%
A.5	75%
A.6	80%
A.7	59.2% <sup>11</sup>
A.8	100%
A.9	100%
A.10	100%
A.11	25%

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	50%
B.2	50%
B.3	25%
B.4	50%

Qasja C	Realizueshmëria
C.1	100%
C.2	100%
C.3	33%

<sup>11</sup> Ibid footnote 5.

Numri i institucioneve të përfshira në procesin e zbatimit të Planit të Veprimit 2020 – 2023 është 22 (10 Ministri, 12 institucione të nivelit qëndror).

Zbatimi i SNKK realizohet përmes Planit të Veprimit 2020 - 2023, i cili përmban **83 masa** dhe **152 aktivitete**, të ndara përkatësisht në: 45 masa dhe 81 aktivitete për qasjen parandaluese, 29 masa dhe 44 aktivitete për qasjen ndëshkuese, dhe 9 masa dhe 27 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuere.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Parashikimi për Realizimin e Masave			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023
Parandaluese	Masa	34	33	31	33
	Aktivitete	63	66	64	61
Ndëshkuese	Masa	25	22	21	20
	Aktivitete	37	31	31	31
Ndërgjegjësuere	Masa	9	9	9	9
	Aktivitete	24	22	18	18
<b>Total</b>	<b>Masa</b>	<b>68</b>	<b>64</b>	<b>61</b>	<b>62</b>
	<b>Aktivitete</b>	<b>124</b>	<b>119</b>	<b>113</b>	<b>110</b>

Rezulton se parashikimi i masave dhe aktiviteteve përgjatë viteve të zbatimit të planit të veprimit është pothuaj në raporte të njëjta për të tre qasjet. Ka një balancim të planifikimit për zbatim, të masave dhe aktiviteteve duke siguruar të njëjtën masë ndërveprimi dhe iniciativash institucionale dhe ndër-institucionale.

Gjatë periudhës raportuese *1 janar - 31 dhjetor 2021*, janë monitoruar në total 64 masa e 119 aktivitete, nga të cilat rezulton se janë zbatuar në total 37 nga masat dhe kryer 77 nga aktivitetet.

Qasja	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2021
-------	--


(Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara <sup>12</sup>	Masa dhe aktivitete të <b>porealizuara</b> <sup>13</sup>
Parandaluese	Masa	33	21	10	2
	Aktivitete	66	48	6	12
Ndëshkuese	Masa	22	11	7	4
	Aktivitete	31	18	6	7
Ndërgjegjësuere	Masa	9	5	3	1
	Aktivitete	22	11	4	7
<b>Total</b>	<b>Masa</b>	<b>64</b>	<b>37</b>	<b>20</b>	<b>7</b>
	<b>Aktivitete</b>	<b>119</b>	<b>77</b>	<b>16</b>	<b>26</b>

Rezulton se nga totali prej 64 masash e 119 aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit për periudhën *janar - dhjetor 2021*, statusi aktual i tyre për të tre qëllimet e politikave (qasjet e Strategjisë), është raportuar si më poshtë:

- 37 masa e 77 aktivitete të realizuara;
- 20 masa e 16 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 7 masa e 26 aktivitete të pazbatuara.

<sup>12</sup> Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>13</sup> Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.



Përsa më sipër, nga **37 masa e 77 aktivitete të realizuara** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 21 masa/48 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 11 masa/18 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 5 masa/11 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **20 masa e 16 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 10 masa/6 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 7 masa/6 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 3 masa/4 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

Nga **7 masa e 26 aktivitete të parealizuar** për janar-dhjetor 2021, konkretisht 2 masa/12 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 4 masa/7 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 1 masë/7 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuere (C).

## **2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian**

Ky raport monitorimi mat ndër të tjera, vlerën dhe ecurinë e disa treguesve të performancës që lidhen me çështje prioritare në agjendën e shtetit shqiptar, në procesin e integrimit evropian.

Konkretisht, në fillimin e monitorimit të SNKK në vitin 2015, sipas Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian, rezultoi se reforma në administratën publike, ekzistenca e funksionimit të ekonomisë së tregut dhe kontrolli financiar, kishin një përgatitje të moderuar me një pikëzim 3-5 deri në 3. Në vijim, lufta kundër korrupsionit, prokurimet publike, statistikave dhe kapaciteti për të përballuar trysinë e konkurrencës, janë vlerësuar me një pikëzim 1.5 deri 2, i cili dëshmon një nivel mesatar përgatitjeje. Drejtësia, liria e siguria dhe lufta kundër krimit të organizuar janë vlerësuar me pikëzimin 1, çka dëshmon një nivel fillestar përgatitjeje. Sa i takon këtyre të dhënave, zbatimi i masave dhe aktiviteteve që parashikohen në Planin e Veprimit 2015-2020 dhe 2020-2023 si dhe vlerat e përcaktuara në treguesit e performancës, kanë synuar përmirësimin e objektivave të përgjithshëm të përcaktuara më lartë, me qëllim rritjen e shkallës së përgatitjes së vendit në procedurat e integrimit në Bashkimin Evropian.



Në vijim, raporti i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit, 2021, ka sjellë një seri treguesish, të cilët kanë ndikim në disa komponentë prioritarë që vlerësohen gjatë procesit të integritetit. Në këtë kuadër, nga zbatimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 - 2023, ka rezultuar se janë bërë përparime të dukshme në disa fusha të cilat prekin qasjen parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere antikorruption.

Rritja e aksesit në numrin e databazave shtetërore për organet e zbatimit të ligjit si dhe digjitalizimi i shtuar i shërbimeve publike, duke tejkaluar parashikimet vjetore me 1212 shërbime publike që ofrohen në mënyrë elektronike, kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë përballë publikut. Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë publikimin e Programit të Transparencës në 313 autoritete publike, si dhe fakti që 95 autoritete publike po përdorin aktualisht regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, është një tregues që dëshmon gjithashtu rritjen e transparencës në këtë drejtim.

Kultura e integritetit në administratën publike është rritur këtë vit me miratimin e 12 instrumenteve të Planeve të Integritetit, në të 12 varësitë e Ministrisë së Drejtësisë. Këto akte janë miratuar, publikuar dhe filluar nga zbatimi.

Sa i takon mirëfunksionimit të administratës publike dhe bashkëpunimit efektiv institucional, gjatë vitit 2021, vihet re një përmirësim në ngritjen e grupeve të përbashkëta institucionale të punës midis PSh - SHÇBA, përmirësimi i rasteve të hetimeve të përbashkëta, kryerja e trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit si dhe rritje e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave me institucionet homologe ndërkombëtare.

Gjithashtu, forcimi i rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, përmes rishikimit të bazës ligjore, riorganizimit të kompetencave dhe ngritjes së Drejtorisë së Përgjithshme Antikorruption pranë Ministrisë së Drejtësisë me një rrjet të gjerë koordinatorësh në 44 institucione publike në vend, është një tjetër rekord pozitiv i arritur gjatë vitit 2021, i cili dëshmon progres sa i takon komponentit të luftës kundër korrupsionit në vend.

Në funksion të këtij raporti progresiv monitorimi, për periudhën raportuese *janar - dhjetor 2021*, është kryer vlerësimi për masat, aktivitetet dhe treguesit e performancës në përmbushje të rekomandimeve të adresuara. MD/KKK ka zbatuar metodologjinë e kërkuar të monitorimit, dhe ka ndjekur procesin e konsultimit dhe bashkërendimit me institucionet dhe në përputhje me parimet e transparencës me publikun dhe grupet e interesuara.

### **2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit**

Rezulton se ndër objektivat me mungesë të plotë realizueshmërie apo me realizueshmëri të dobët, për periudhën raportuese *1 janar - 31 dhjetor 2021*, janë përkatësisht disa prej objektivëve në të tre qasjet e SNKK, përmendim përkatësisht, objektivet A11, B1, B2, B3 dhe C2 e C3.

Për periudhat në vijim të zbatimit të Planit të Veprimit, rekomandohet të merren gjithashtu masa për përmirësim, përkatësisht:

Objektivi A5: Të fillojë deklarimi i pasurisë dhe interesave privatë nga subjektet deklaruese dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet sistemit online dhe vijimi i punës me regjistrimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm.

Objektivi A6: Të zhvillohet modeli i raportimit financiar si dhe me trajnimet përkatëse me personat përgjegjës për financat e partive politike për vitin kalendarik. Të merren masa për auditimin e raporteve financiare të fushatës elektorale dhe partive politike gjithashtu.

Objektivi A7: Shqyrtimi i sinjalizimeve të jashtme të regjistruara për inspektim financiar publik dhe rritja e rasteve të auditit të brendshëm, për të cilat duhet të referohen inspektimet financiare.

Objektivi A11: Miratimi i planeve të integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut nga bashkitë e tjera dhe alokimi i buxhetit përkatës për zbatimin e tyre.

Objektivi B1: Përditësimi dhe plotësimi i regjistrimit elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe rritja e kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit.

Objektivi B2: Të vijohet me rritjen e numrit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore për policinë dhe prokurorinë me qëllim që të arrihen treguesit e performancës në vijim

Objektivi B3: Finalizimi i vendimmarrjes dhe ngritja e funksionimi i Zyrës së Rekuperimit të Aseteve.

Objektivi C2: Të përmirësohet komunikimi institucional dhe të fokusohet raportimi në denoncimet e ardhura pranë platformës vetëm për veprat penale që lidhen me korrupsionin në sektorë të ndryshëm privatë apo publikë.

Objektivi C3: AMSHC duhet të nxisë organizatat e shoqërisë civile që të aplikojnë në projekte që lidhen me tematikën e antikorrupsionit, duke u fokusuar mbi fusha të ndryshme, në të cilat rezulton se është më i përhapur korrupsioni në vend. Gjithashtu AMSHC do duhet të hartojë një program anti-korrupsioni, si një tregues performance i përcaktuar në vite.

## **2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit**

Financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë (donatorë).

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave/aktivitetëve të Planit të Veprimit 2020 - 2023, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur në bazë të aktivitetit të kryer për realizimin e objektivit specifik të strategjisë nga secili institucion përgjegjës.

Buxheti i përdorur sipas objektivave dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

A1: 4.116.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A2: 26.223.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A4: 43.140.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A5: 19.910.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A6: 638.000 lekë, mbuluar nga donatorë (NDI).

A7: 6.260.800 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A8: 270.273 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A9: 232.182 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A10: 712.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A11: 10.869.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B1: 260.982 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorë: GIZ Albania, Këshilli i Evropës dhe OSCE.

B3: 138.364 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C1: 409.613 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C3: 11.850.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Objektivat B2, B4 dhe C2 nuk kanë raportuar kosto të përdorur (0).

Edhe për këtë raport monitorimi, rezulton se për një pjesë të aktiviteteve të kryera gjatë këtij viti, zbatimi, kostot vijnë të raportohen në “kosto administrative”, dhe mungon një vlerë konkrete e tyre. Në total, janë 33 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 42 aktivitete me 0 (zero) kosto/pa raportuar.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

***Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A)***

111.733.255 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

638.000 lekë mbuluar nga donatorë

***Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B)***

399.364 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

***Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuese - C)***

12.259.613 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Totali i buxhetit të përdorur për këtë periudhë është:

- ***Financimi nga buxheti i shtetit është në shumën 124.392.232 lekë.***
- ***Financimi nga donatorët është në shumën 638.000 lekë.***

### III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të SNNK, në drejtim të secilit qëllim politik,<sup>14</sup> objektivi dhe masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020-2023, për periudhën e monitorimit *1 janar - 31 dhjetor 2021*.

Qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

#### 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Në përputhje me SNKK, janë kryer aktivitete dhe realizuar dhe masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023 për periudhën raportuese të lidhura me të 3 qëllimet e politikës, përkatësisht parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin.

#### *Qasja Parandaluese - Përmbledhje për arritjet në parandalimin e korrupsionit*

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) parandaluese SNKK** synon çrënjosjen e korrupsionit në administratën publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore, si dhe nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Kjo qasje përmban numrin më të madh të objektivave specifike dhe për rrjedhojë dhe të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar nga institucionet e përfshira.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara <sup>15</sup>	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b> <sup>16</sup>
Parandaluese (A)	Masa	33	21	10	2
	Aktivitete	66	48	6	12

<sup>14</sup>Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është përfshirë në aneksin e këtij raporti.


<sup>15</sup> Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>16</sup> Aktivitet "i përealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

Rezultoni se nga 33 masa e 66 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-dhjetor 2021, për Qasjen A (Parandaluese), janë zbatuar 21 masa/48 aktivitete prej tyre, 10 masa/6 aktivitete janë ende në proces zbatimi, 2 masa/12 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa A.6.1; A.6.4; dhe aktivitete A.4.2.1; A.6.1.1; A.6.1.2; A.6.4.1; A.6.4.2; A.6.5.1; A.6.5.2; A.7.1.2; A.7.1.3; A.7.1.4; A.7.3.2; dhe A.7.3.4)

Nga 21 treguesit e performancës për qasjen parandaluese (A), është arritur vlera e synuar për 13 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 2 tregues performance si edhe nuk është arritur<sup>17</sup> vlera e synuar për 6 tregues performance.

Qasja Parandaluese	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht <sup>18</sup>	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht <sup>19</sup>	Vlera e synuar nuk është e realizuar <sup>20</sup>
	21	13	2	6



<sup>17</sup> Këtu është përfshirë edhe treguesi nuk mund të matet (A.7.a).

<sup>18</sup> Që është realizuar në shkallën 100 për qind

<sup>19</sup> Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>20</sup> Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna

## **A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion**

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programe transparence*

*A.1 b: Bërja operacional regjistrin qendror për ankesat dhe përgjigjet që në vitin 2020*

Plani i Veprimit për Objektivin A.1 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

### **A.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.a** për vitin 2021 është *9% rritje krahasuar me vitin parardhës* (2020-rritja me 12% e numrit të institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programin e transparencës). Për vitin 2022 vlera e synuar *7% rritje krahasuar me vitin paraardhës* dhe për vitin 2023 vlera e synuar është *5% rritje krahasuar me vitin parardhës*.

Gjatë vitit 2020, nga 417 autoritete publike të monitoruara rezultoi se 239 autoritete publike qendrore e vendore kishin zbatuar në mënyrë të saktë parimet e transparencës (programin e transparencës).

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masat (2) si më poshtë.

A.1.1	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë.
A.1.1.1	Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publik ( <i>Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor</i> ).
A.1.1.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total të autoriteteve publike çdo 3 muaj.
A.1.2	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore.
A.1.2.1	Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore ( <i>Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor</i> ).

A.1.2.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor
---------	--

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor dhe me vlera të matshme përkundrejt prodhimit të raportit mbi indeksin e transparencës të autoriteteve publike qendrore dhe raportit mbi indeksin e transparencës së autoriteteve publike të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Për *janar-dhjetor 2021*, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Komisioneri) në kuadër të zbatimit të urdhërit nr.187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”, i ndryshuar, që vendosnin për zbatim modelet e reja të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, ka monitoruar të gjitha autoritet publike qendrore dhe të varësisë së tyre dhe ka publikuar raportin mbi indeksin e transparencës së Autoriteteve Publike, i aksesueshëm në link [https://www.idp.al/ep-content/uploads/2022/01/Indeksi-2021-Monitorimi-i-institucioneve-qendrore-dhe-te-varesise\\_2021\\_me-kopertine.pdf](https://www.idp.al/ep-content/uploads/2022/01/Indeksi-2021-Monitorimi-i-institucioneve-qendrore-dhe-te-varesise_2021_me-kopertine.pdf)

Gjithashtu, Komisioneri ka hartuar dhe publikuar raportin mbi indeksin e Transparencës së Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore në faqen zyrtare të internetit: [https://www.idp.al/ep-content/uploads/2022/01/Indeksi\\_-i-transparences\\_monitorim\\_bashkite.pdf](https://www.idp.al/ep-content/uploads/2022/01/Indeksi_-i-transparences_monitorim_bashkite.pdf) dhe për 61 njësi të Vetëqeverisjes Vendore, rezulton se 58 njësi të tyre e kanë implementuar Programin e Transparencës ndërsa 3 njësi rezultojnë se nuk kanë faqe interneti aktive.

Në total, nga 374 autoritete publike të monitoruara online (përfshirë autoritetet qendrore dhe të varësisë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore), ka rezultuar 300 prej tyre kanë zbatuar saktë Programin e Transparencës ose 23% rritje në krahasim me vitin e kaluar (2020).


Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi është arritur në masën 80%.  $(300/374)*100=80\%$  Kjo vlerë është arritur duke mbajtur në konsideratë targetin e përcaktuar 9% rritje në krahasim me vitin 2020, vlerën e arritur për vitin 2020 me 239 autoritete publike, të cilat e kanë zbatuar saktë programin e transparencës dhe vlerën e arritur për vitin 2021 me 300 autoritete publike të cilat e kanë zbatuar saktë programin e transparencës.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:

	2015
	N/A


<b>Vlerat Bazë</b>	2017	181
	2018	20% rritje nga vlera bazë
	2019	15% rritje në krahasim me vitin 2018
	2020	12% rritje në krahasim me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 57%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	9% rritje në krahasim me vitin 2020
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>80%</b>
	2022	7% rritje në krahasim me vitin 2021
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	5% rritje në krahasim me vitin 2022

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve, paraqitet si në grafikun më poshtë:



Grafiku me të dhënat kumulative:





### A.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.b** për vitin 2021 është 50% krahasuar me vitin parardhës (2020-krijimi dhe vënia në funksion e regjistrit qendror për ankesat dhe përgjigjet nga më shumë se 70% e autoriteteve publike krahasuar me vitin 2019). Për vitin 2022 vlera e synuar është 30% krahasuar me vitin parardhës, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është 25% krahasuar me vitin parardhës.

Gjatë vitit 2020, regjistri u bë i zbatueshëm në 59 institucione dhe agjenci qendrore përfshirë ministri dhe institucione të pavarura.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.1.3	Instalimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione).
A.1.3.1	Numri i institucioneve ku është instaluar regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve
A.1.3.2	Monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatorëve të AP për regjistrin e kërkesë-ankesave

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 muaj.

Për janar-dhjetor 2021, regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 36 autoritete të reja publike. Janë 95 autoritete publike në total, që kanë instaluar dhe përdorin regjistrë elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, përkatësisht 36 autoritete të reja ose 12 autoritete me shumë sesa planifikimi i bërë në masën A.1.3. Gjithashtu, Komisioneri ka kryer edhe monitorimin ndaj koordinatoreve të së drejtës së informimit. Lidhur me treguesin regjistri elektronik qendror për ankesat dhe përgjigjet në autoritetet publike, vlera e synuar në PV 2019 -2023 ka qenë 24 autoritete publike për vitin 2021, ndërkohë kjo është shifër është tejkaluar me një rritje prej 36 autoritete publike, nga 59 operacional në 2020, për 2021 kemi 95 autoritete publike që e kanë operacional regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Për këtë arsye konkludohet se, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, me këtë numër institucionesh ku është instaluar regjistri elektronik, treguesi është arritur në masën 150%.

Në total 36 autoritetet publike që kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve janë: Bashkia Belsh, Bashkia Delvinë, Bashkia Dimal, Bashkia Divjakë, Bashkia Dropull, Bashkia Finiq, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Has, Bashkia Kavajë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Konispol, Bashkia Krujë, Bashkia Kuçovë, Bashkia Kurbin, Bashkia Librazhd, Bashkia Lushnje, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Mallakastër, Bashkia Mirditë, Bashkia Pukë, Bashkia Roskovec, Bashkia Sarandë, Bashkia Tropojë, Bashkia Vorë, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë dhe Emergjencën në Miniera, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Qendror dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.


Kostoja e masave të parashikuara për këtë objektiv është parashikuar në kosto administrative, nga buxheti i Zyrës së Komisionerit.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:


<b>Vlerat Bazë</b>	2015	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Përdorimi i regjistrit nga 30 institucione (p.sh. të gjitha ministrisë dhe institucionet e pavarura)
	2020	Përdorimi i regjistrit nga 70 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 133%)

<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Përdorimi i regjistrit nga 50 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2020
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>150%</b>
	2022	Përdorimi i regjistrit nga 30 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2021
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Përdorimi i regjistrit nga 25 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2022

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Grafiku me të dhënat kumulative:



### Niveli i realizimit të objektivit A.1.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është 115%.*

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR A.1 = \frac{TP A.1.a (80\%) + TP A.1.b (150\%)}{2 TP} \times 100\% = 115\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.1 për këtë periudhë raportimi është **tejkalar** (111 dhe më lart e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2021. Të dy raportet e indeksit të transparencës (qendrore dhe vendore) janë të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit në link <https://www.idp.al/raporte-monitorimi-2021/> si dhe indeksimi i tyre në bazë të pikëve.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.1

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objekti.

## A.2 ***Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

A.2.a: *Raporti i elementëve të ndryshuar në Planet Vjetore të Prokurimit*

A.2.b: *Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës*

A.2.c: *Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit*

Plani i veprimit për Objektivin A.2 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

### A.2.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.a** për vitin 2021 është: **ulja në 20% e raportit ndërmjet numrit të elementeve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit** krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën 20% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Gjatë vitit 2020, përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve ishte 19.3%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.2.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit
A.2.1.1	Hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit
A.2.1.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit (trajnime, vizita studimore, etj)

Për *janar - dhjetor 2021*, është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, në të cilin përcaktohen rregullat e prokurimit publik, të cilat detajojnë përmbajtjen e këtyre njoftimeve. Gjithashtu, janë miratuar nga APP, 29 sete të dokumentave standarde të tenderit sipas tipit të kontratës mall, punë apo shërbim, pjesë e të cilave janë edhe formularët standard për këto njoftime.

Gjatë kësaj periudhe, stafi i APP ka marrë pjesë në disa sesione informuese dhe trajnuese për kuadrin e ri ligjor, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me ASPA. Po ashtu, stafi i APP ka marrë pjesë në ëorkshope online dhe në vend të organizuara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit. Trajnimet e zhvilluara në bashkëpunim me ASPA janë pa kosto. Po ashtu dhe ëorkshopet janë organizuar dhe mundësuar nga organizatat

ndërkombëtare dhe nuk kanë patur kosto për APP. Një nga ëorkshopet që vlen për tu përmendur ishte trajnimi me temë “Zbulimi i mashtrimit në tenderat publike”, zhvilluar në datat 2 dhe 3 Dhjetor 2021, i cili u organizua me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe Shkollës Kombëtare Franceze të Administratës (ENA).


Për këtë periudhë monitorimi, nga informacioni i raportuar dhe analizuar raporti ndërmjet numrit të elementëve të ndryshuara në planet vjetore të prokurimit dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit është 16.1%, ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2021 është 20% (trend zbritës). Ky tregues performance është arritur në masën 100% për këtë periudhë.

Ky tregues shërben për matjen e performancës së autoriteteve kontraktore në planifikimin e fondeve buxhetore, duke pasur parasysh që ndryshimi i shpeshtë i regjistrit të parashikimeve është një tregues për planifikim jo të mirë nga ana e tyre. Të dhënat për këtë tregues nxirren nga Sistemi Elektronik i Prokurimit (SPE) dhe publikohen në analizën vjetore të APP në link-un: <http://ëëë.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/>.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	35%
	2020	20%
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	5% nga viti referues
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>100%</b>
	2022	20%
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	20%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve, paraqitet si në grafikun më poshtë:



Grafiku me të dhëna kumulative:



#### A.2.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.b** për vitin 2021 është: **ulja në më pak se 10% e raportit të numrit total të procedurave me negocim të dhëna pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës krahasuar me numrin total të procedurave të dhëna krahasuar me vitin e mëparshëm.**

Për vitet 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën më pak se 10% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Gjatë vitit 2020, përqindja e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara është 8.3%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.2.2	Mekanizma për përmirësimin e zbatimit të kontratave
A.2.2.1	Hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës)
A.2.2.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës (trajnime, vizita studimore, etj).

Për *janar-dhjetor 2021*, hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës është finalizuar, dhe publikuar nga APP formulari standard për planin e zbatimit të kontratës dhe formulari standard për zbatimin e kontratës.

APP në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit 162/2020 dhe të miratimit të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Tiranë, nga data 25 Maj deri më 16 Qershor 2021, ka organizuar 12 sesione informuese virtuale për Autoritetet dhe Entet Kontraktore, me qëllim njohjen e tyre me kuadrin e ri ligjor dhe risitë e sjella prej tij. Në këto 12 sesione të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, rezultoi se janë trajnuar 404 persona nga 203 institucione të ndryshme qendrore, vendore dhe të pavarura. Po ashtu, APP në bashkëpunim me ASPA ka nisur procesin e trajnimit sipas moduleve dhe fushave tematike të dakorduara, për Autoritetet dhe Entet Kontraktore. Gjatë muajit korrik 2021, janë organizuar 5 sesione trajnimiti tre-ditore.

Për këtë periudhë monitorimi, përqindja e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara është 3.4%. Në këto kushte, vlerësohet se ky tregues performance është arritur në masën 100%.

APP ka raportuar shpenzimin e 100% të buxhetit të parashikuar për këtë masë.

Ky tregues shërben për matjen e shkallës së transparencës në procedurat e prokurimit dhe minimizimin e riskut për korrupsion duke qenë se procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për nga natyra e saj është një procedurë jo-transparente duke pasur parasysh që nuk publikohet njoftim kontrate dhe, si e tillë, krijon premisa për abuzim nga ana e autoriteteve kontraktore. Këto procedura kanë vijuar një trend rënës që prej vitit 2018, duke adresuar rekomandimet nga raportet monitoruese të institucioneve ndërkombëtare dhe gjatë vitit 2021 kanë




shënuar numrin më të ulët që nga viti 2010 Të dhënat për këtë tregues nxirren nga Sistemi Elektronik i Prokurimit (SPE) dhe publikohen në analizën vjetore të APP në link-un: <http://www.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/>.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	31.80%
	2018	N/A
	2019	15%
	2020	10%
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	10% nga viti referues
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	100%
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	2023	100%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Grafiku me të dhënat kumulative:



### A.2.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.c** për vitin 2021 është: **ulja në 10% ulja e numrit të kontratave të ndryshuara gjatë vitit** krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2022, dhe 2023, vlera e synuar është ruajtja në masën 10% e këtij raporti me qëllim krijimin e stabilitetit në këtë tregues.

Gjatë vitit 2020, përqindja e kontratave të ndryshuara gjatë vitit është 1.9%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

A.2.3	Mekanizma për përmirësimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike
A.2.3.1	Hartimi dhe publikimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga APP në lidhje me përmbajtjen e dokumentave të tenderit të përgatitura nga autoritetet/entet kontraktore me qëllim përmirësimin e tyre (Nr. i rekomandimeve të nxjerra)
A.2.3.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme (trajnime, vizita studimore, etj)

Për *janar-dhjetor 2021*, APP ka nxjerrë 2 rekomandime në lidhje me përmirësimin e mekanizmave të dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, janë forcuar kapacitetet e punonjësve të APP, përmes sesioneve informuese dhe trajnuese për kuadrin e ri ligjor, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me ASPA. Po ashtu, stafi i APP ka marrë pjesë në ëorkshope të ndryshme online dhe në vend të organizuara

nga institucione ndërkombëtare. APP ka raportuar shpenzimin e 100% të buxhetit të parashikuar. Trajnimet e zhvilluara në bashkëpunim me ASPA janë pa kosto. Po ashtu dhe ëorkshopet janë organizuar dhe mundësuar nga organizatat ndërkombëtare dhe nuk kanë patur kosto për APP. Një nga ëorkshopet që vlen për tu përmendur ishte trajnimi me temë “Zbulimi i mashtrimit në tenderat publike”, zhvilluar në datat 2 dhe 3 Dhjetor 2021, i cili u organizua me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe Shkollës Kombëtare Franceze të Administratës (ENA).


Për këtë periudhë monitorimi, numri i kontratave të ndryshuara gjatë vitit është 0.8 % ndërkohë që vlera e synuar për vitin 2021 është 10%. Duke qenë se ky indikator ka trend zbritës, konstatohet se treguesi është arritur në masën 100%, për vitin 2021.

Të dhënat për këtë tregues nxirren nga Sistemi Elektronik i Prokurimit (SPE) dhe nga rastet e evidentuara nga APP, dhe publikohen në analizën vjetore të APP në link-un: <http://www.app.gov.al/rreth-nesh/analizat-vjetore/>.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	21.20%
	2018	N/A
	2019	15%
	2020	10% (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	10%
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	10%
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	10%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Grafiku me të dhënat kumulative:



#### Niveli i realizimit të objektivit A.2.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR A. 2 = \frac{TP A.2.a (100\%) + TP A.2.b (100\%) + TP A.2.c (100\%)}{3 TP} \times 100\% = 100\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.2 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (56 në 110 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia e Prokurimit Publik për monitorimin zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit A.2**

Në drejtim të realizimit të aktiviteteve dhe masave, risku qëndron në miratimin me vonesë të ligjit bazë i cili do të prodhojë edhe aktet e ardhshme nënligjore. Ky objektivi ka mundësi të ulët risku dhe ndikim të mesëm të tij.

### **A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike**

Për këtë objektivi është përcaktuar 1 tregues performace:

*A.3: Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike*

Plani i veprimit për Objektivin A.3 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.3** për vitin 2021 është: 670 shërbime elektronike. Për vitin 2022 vlera e synuar është 720 shërbime elektronike, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është 750 shërbime elektronike.

Gjatë vitit 2020, numri total i shërbimeve elektronike arriti në 1021 shërbime elektronike, nga 602 që ishte vlera e synuar për këtë vit, duke e realizuar me 419 më shumë.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masa (1) si më poshtë.

A.3.1	Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike
A.3.1.1	Nr. shërbimesh elektronike të shtuara; (2020-602 shërbime; 2021-670 shërbime; 2022-720 shërbime e 2023-750 shërbime)
A.3.1.2	Përcaktim i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues
A.3.1.3	Kryerje e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve
A.3.1.4	Kryerje e zhvillimeve teknike për të konsumuar eëbservice-t përkatëse të e-sistemeve

A.3.1.5	Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania.
A.3.1.6	Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet).

Përmes kryerjes së aktiviteteve të parashikuara AKSHI ka realizuar dhe vënë në funksion të plotë, gjatë kësaj periudhe monitorimi 1212 shërbime elektronike, nga 670 që ishte vlera e synuar për vitin 2021, duke arritur më 642 shërbime më shumë se objektivi vjetor dhe 266 shërbime elektronike më shumë krahasuar me vitin 2020.

Për *janar-dhjetor 2021*, numri i shërbimeve elektronike të shtuara sipas treguesit është tejkaluar me 80%. Përcaktimi i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues është realizuar në nivelin 100%. Kryerja e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve është realizuar në nivelin 100%. Kryerja e zhvillimeve teknike për të konsumuar eëbservice-t përkatëse të e-sistemeve është realizuar në nivelin 100%. Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania është realizuar në nivelin 100%. Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet), është realizuar në nivelin 100%.

Në vitin 2021, AKSHI ka facilituar përgjigjet përmes platformës e-albania për **12.8 milion aplikime** për shërbimet publike dhe **2.3 milion përdorues të regjistruar** në *e-Albania*. Në këtë mënyrë digjitalizimi i shërbimeve publike ka bërë të mundur reduktimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe burokracisë në marrjen e shërbimeve; reduktimin e kohës së marrjes së shërbimeve; reduktimin e kostos së marrjes së shërbimeve; rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe shmangien e kontaktit fizik me punonjësit e administratës si dhe rritjen e besimit të qytetarëve dhe biznesit. Shërbimet e ofruara lidhen kryesisht me shërbimet elektronike në gjendjen civile, turizëm, kulturë dhe art, financa dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punët e jashtme, etj.


Nga informacioni i raportuar dhe analizuar (mbështetur në masat dhe aktivitetet për zbatim) për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë masë (si më lart), me këtë numër shërbimesh elektronike në funksion të plotë ka ndikuar drejtpërdrejtë në mënyrën e realizimit të treguesit. Ky tregues performance është realizuar në masën 180% (1212 shërbime elektronike nga 670 që është vlera e synuar për vitin 2021)


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	527
	2018	N/A

	2019	582, rritur me 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2018
	2020	602, rritur më 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 141%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	670, rritur më 68 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2020
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 180%
	2022	720, rritur më 50 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2021
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	750, rritur më 30 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2022

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:





### Niveli i realizimit të objektivit A.3.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 **është 180%**.

Shkalla e realizimit të objektivit A.3 për këtë periudhë raportimi është **tejkalluar** (111 dhe më lart e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për kohëzgjatjen e gjithë vitit 2021.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.3

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objekti.

### A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

A.4: *Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve*

Plani i veprimit për Objektivin A.4 për vitet 2020-2023 parashikon 12 aktivitete dhe 5 masa.



Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.4** për vitin 2021 është: *trendi rritës i numrit të numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve*, krahasuar me vitin e mëparshëm. Për vitet 2022 dhe 2023, vlera e synuar është po e njëjta.

Përveç numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, ky tregues përmban dhe një nën-tregues performance që është *raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, të cilat janë dërguar nëpërmjet portaleve online, krahasuar me numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve*.

Gjatë vitit 2020 janë kryer 75 hetime për korrupsion të iniciuara nga denoncimet e qytetarëve, nga 112 hetime, e cila ishte vlera e synuar.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (12) dhe masat (5) si më poshtë.

A. 4.1	Mekanizma për ngritjen/vënien në funksion të sistemit për ndjekjen/ monitorimin e hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve
A.4.1.1	Ngritja e njësisë qendrore për hetimin e krimit ekonomik financiar, me 20 oficerë të përzgjedhur nga studentët e ekselencës, të cilët do trajnohen në Akademinë e Sigurisë
A.4.1.2	Ngritja e një sektori të posaçëm për gjetjen/ hetimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria e korrupsionit, në përshtatje me standartet Europiane të AROS
A.4.1.3	Rishikimi i procedurave standarte të punës bazuar në ristrukturimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit.
A. 4.2	Ndërveprim funksional dhe përmirësim bashkëpunimi të strukturave të Policisë së Shtetit që hetojnë korrupsionin, në portalin <a href="http://www.shqiperiaqeduam.al">www.shqiperiaqeduam.al</a>
A.4.2.1	Marrëveshje bashkëpunimi PSH-ADB
A.4.2.2	Nr. i rasteve të aksesit të PSh në platformë;
A.4.3	Forcim bashkëpunimi PSH- SHÇBA për hetimin e subjekteve të përfshira në korrupsion
A.4.3.1	Ngritja e grupeve të përbashkëta institucionale të punës PSh - SHÇBA; Nr. i rasteve të hetimeve të përbashkëta
A.4.3.2	Nr. i subjekteve të dërguara për procedime penale për veprën penale të korrupsionit nga hetimet përbashkëta.
A.4.4	Kapacitete të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH
A.4.4.1	Trajnime të kryera (shefa të sektorëve në DVP dhe specialistëve kundër korrupsionit në DPP)
A.4.4.2	Nr. i personave të trajnuar, 20 persona/vit

A.4.4.3	Trajnime të specialistëve për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policorë Tiranë, me trajnues nga strukturat e Prokurorisë dhe Gjykatës, 126 persona/vit. (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.4.5	Monitorim proaktiv dhe i vazhdueshëm i medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, pritja dhe zgjidhja në kohë ankesave/rasteve/informacioneve të denoncuara publikisht për krimin e korrupsionit
A.4.5.1	Forcimi i kapaciteteve të strukturave teknike të PSH dhe SHÇBA për monitorimin/gjurmimin e rasteve
A.4.5.2	Nr. i personave/staf i përfshirë në këto grupe për monitorimin e rasteve të denoncuara për prirje për korrupsion

Për *janar-dhjetor 2021*, është ngritur njësi hetimore për krimin ekonomik e financiar në Drejtorinë Qendrore Hetimore, brenda Departamentit të Policisë Kriminale, me 50 oficerë në organike. Deri në fund të vitit 2021, njësi është e plotësuar me 28 oficerë hetimi. Ngritja e një sektori të posaçëm për gjetjen/hetimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria e korrupsionit, në përshtatje me standartet Europiane të ARO-s është ende në proces.

Lidhur me rishikimin e procedurave standarde të punës bazuar në ristrukturimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, gjatë vitit 2021, janë miratuar me urdhrin nr.576, datë 18.06.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Procedurat standarte për hetimin pasuror dhe identifikimin e aseteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale”, për të gjitha veprat subjekt i ligjit Nr.10192, përfshirë korrupsionin dhe krimet në detyrë.

Lidhur me ngritjen e grupeve të përbashkëta institucionale të punës PSh – SHÇBA, gjatë vitit 2021, PSH ka hetuar 1 (një) rast i përbashkët me SHÇBA, i finalizuar në DVP Korçë. Janë arrestuar 5 shtetas, 2 prej të cilëve janë punonjës policie. 3 raste të tjera janë në hetim nga SPAK.

Në vitin 2021, SHÇBA ka kryer monitorimin dhe gjurmimin e rasteve nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Çeshtjes - Moduli i Ankesave/Moduli i Hetimit Procedural Penal. SHÇBA administron gjithashtu një linjë të gjelbër 0800 90 90. Pranë kësaj linje ka marrë 5713 telefonata, ku: 2039 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së dhe nëpërmjet strukturave të Shërbimit në nivel qendror dhe vendor si dhe strukturave vendore të policisë, është kontaktuar menjëherë telefonuesi duke i dhënë zgjidhje problemit të ngritur; 2758 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA-së dhe shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitohen ankesën e tyre; 902 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA-së.

Sa i takon administrimit të Ankesave, në nivel qendror dhe vendor janë administruar 1694 ankesa të ardhura pranë Shërbimit, nga të gjitha portat e komunikimit të vëna në dispozicion të tyre. Nga hetimet administrative ka rezultuar se në 59 raste për 105 punonjës policie, për shkeljet e

evidentuara është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit.

Në funksion të kapacitete të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH, janë zhvilluar 22 trajnime me 220 përfitues nga të cilët 45 janë femra.

Policia e Shtetit ka zhvilluar 1 trajnim në datë 24 Shtator 2021, në Akademinë e Sigurisë me temë: “Përcaktimi i rezultateve të garave sportive. Korrupsioni pasiv i funksionarëve të shtetit, hetimi proaktiv i veprës penale të fshehjes së pasurisë dhe financimi i terrorizmit”, në të cilin ka patur 20 përfitues, prej të cilëve 1 femër.

Lidhur me monitorimin proaktiv dhe të vazhdueshëm të medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, pritjen dhe zgjidhjen në kohë të ankesave/rasteve/informacioneve të denoncuar publikisht për krimin e korrupsionit, janë kryer trajnime të përbashkëta për konfliktim e interesit dhe abuzimet në detyrë. Gjithashtu, për 2 raste janë nisur hetime bazuar në emisionet investigative televizive të “Stop” dhe “Fiks Fare”. Gjatë vitit 2021 është marrë akses në regjistrat e llogarive bankare dhe pronarëve përfitues, i cili administrohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Taimeve.



Gjatë vitit 2021, rezultojnë gjithashtu 110 vepra penale, të cilat janë gjeneruar si rezultat i kallëzimeve nga qytetarët, të bëra në Drejtorinë Vendore të Policisë, raste këto që janë referuar në prokuroritë e rretheve gjyqësore. Nga këto vepra penale 3 referime, janë raste të inicuar nga media investigative. Gjithsej, në fushën e korrupsionit dhe krimeve në detyrë, janë implikuar 154 autorë, nga të cilët 8 janë arrestuar dhe 146 janë proceduar në gjendje të lirë. Duke qenë se objektivi për vitin 2021 është trend rritës në lidhje me 2020 dhe për vitin 2021 janë kryer 35 procedime penale më shumë se viti 2020, treguesi i performancës është arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	678
	2018	N/A
	2019	5% rritur, në lidhje me 2018
	2020	5 % rritur, në lidhje me 2019 (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	trend rritës në lidhje me 2020
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	35 procedime penale me shumë se 2020. Treguesi është arritur në masën 100 %
		trend rritës në lidhje me 2021
	2022	

<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	trend rritës në lidhje me 2022
-------------------------------	------	--------------------------------

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



#### Niveli i realizimit të objektivit A.4.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021, është 100 %.*

Shkalla e realizimit të objektivit A.4 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86 në 110 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit A.4**

Risku për realizueshmërinë e këtij objektivit ka mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të mesëm të tij, kjo për shkak se gjatë vitit 2021 për çështjet penale të fushës së korrupsionit nuk janë ngritur grupe të përbashkëta për çështjet potenciale po trajtohen çështjet me risk. Nga ana e strukturave të policisë është hartuar dhe zbatuar një plan kalendar për takime e analiza të përbashkëta me prokuroritë e rretheve gjyqësorë dhe strukturat përkatëse në drejtoritë vendore të policisë, mbi bazën e të cilave do të bëhet edhe analiza e riskut për çështjet penale të korrupsionit dhe pastrimit potencial të parave.

### ***A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.5.a: Bërja funksionale e sistemit online për deklarimin e pasurive deri në vitin 2020.<sup>21</sup>*

*A.5.b: Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve*

Plani i veprimit për Objektivin A.5 parashikon 8 Aktivitete dhe 7 Masa.

#### **A.5.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.a** për vitin 2021 është: ***deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve që kanë detyrimin për të deklaruar***. Për vitin 2022 vlera e synuar është ***forcimi i kapaciteteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit elektronik të pasurive dhe interesave privatë përmes trajnimit***. Për vitin 2023 vlera e synuar është ***kryerja e analizës së performancës së sistemit elektronik të deklarimit pasurive dhe interesave***.

---

<sup>21</sup> Për shkak se passaporta e treguesve është hartuar dhe miratuar në vitin 2018 ky indikator është i fokusuar tek ngritja e sistemit të deklarimit online. Me zgjatjen e afatit të SNKK deri në vitin 2023, me VKM nr. 516/2020, pas vitit 2020 fokusi i indikatorit, ashtu dhe i masave dhe aktiviteteve, përqendrohen tek ***përdorimi me efektivitet i sistemit online për deklarimin e pasurive***.

Gjatë vitit 2020, vlera e synuar nuk është arritur, pasi është nënshkruar vetëm 1 memorandum mirëkuptimi me Prokurorinë e Përgjithshme, nga një total prej 17, që ishte vlera e synuar për këtë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (4) si më poshtë.

A. 5.1	Deklarimi i pasurisë nga subjektet e ligjit (deklaruesit dhe personat e lidhur me të) përmes sistemit online
A.5.1.1	80% e subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim nëpërmjet sistemit elektronik, e kryejnë atë.
A. 5.2	Mirëmbajtja e sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe interesave private
A.5.2.1	Sistemi elektronik në gjendje funksionale (mirëmbajtje për çdo vit)
A. 5.3	Forcimi i kapaciteteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit të pasurive nëpërmjet trajnimit
A.5.3.1	Plani dhe materialet e trajnimit të përfunduara.
A.5.3.2	400 përdoruesve të trajnuar në nivel qendror dhe vendor (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A. 5.4	Analizimi i funksionimit të sistemit të deklarimit të pasurive dhe interesave private
A.5.4.1	Termet e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe konsultuar

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për t'u zbatuar me fillimin e vitit 2021.

Për *janar-dhjetor 2021*, sistemi elektronik i deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDS) është zhvilluar për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me asistencën financiare dhe teknike të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në lidhje me pjesën e programimit të sistemit (software) dhe nga “Instrumenti Horizontal për Perëndimin Ballkani dhe Turqia” e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës për sigurimin e pajisjeve.

Gjatë vitit 2021, u bë pilotimi i sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave. Problematikat dhe gjetjet që kanë rezultuar gjatë pilotimit, i janë përcjellë kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e sistemit, me qëllim zgjidhjen e tyre.

Gjithashtu, janë hartuar dhe miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe formularët e deklarimit për qëllime të përdorimit të sistemit EACIDS. Në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikuara në nenet 4/2, 21 dhe 42/2 të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe zyrtarëve të caktuar publikë”, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, ILDKPKI ka hartuar dhe miratuar aktet e nevojshme nënligjore

dhe formularët e deklaramit. Kështu, Inspektori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 925 dhe urdhrin nr. 926, datë 29.10.2021 ka miratuar përkatësisht formularët e deklaramit të interesave private në sistemin elektronik EACIDS. Ndërsa mënyra e plotësimit të deklaratave dhe afatet përkatëse të deklaramit janë miratuar me udhëzim të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 1.11.2021. Sipas këtij akti nënligjor, të gjitha subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarohen përmes sistemit elektronik EACIDS duke filluar nga data 1 janar 2022. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e këtyre formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklaramit elektronik EACIDS. <https://www.ildkpk.al/akte-nenligjore/>

Me mbështetjen e Këshillit të Europës u zhvilluan seanca trajnimi me Autoritetet Përgjegjëse për përdorimin e sistemit. Në total, u trajnuan 300 përfaqësues të Autoriteteve Përgjegjëse. Trajnimet e zhvilluara kishin për synim të rrisin kapacitetet e përfaqësuesve të autoriteteve publike që janë përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklaramit të interesave privatë nga secili deklarues dhe personat e lidhur. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për t'i prezantuar pjesëmarrësve sistemin elektronik dhe modulet kryesore të tij si dhe për të ofruar informacione teknike me synim lehtësimin e procesit të deklaramit online përmes sistemit elektronik të deklaratave të pasurisë dhe konfliktit të interesit.

Përsa më sipër, subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarojnë pasuritë dhe konfliktin e interesit, përmes sistemit elektronik EACIDS duke filluar nga data 1 janar 2022.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar (mbështetur në masat dhe aktivitetet për zbatim) për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, mbi përdorimin e sistemit të deklaramit *online*, të pasurive, rezulton se tregues është realizuar në masën 50%, pasi nuk ka pasur deklarim online të pasurive dhe interesave të zyrtarëve, por janë kryer të gjitha veprimet e fazës përgatitore që regjistri të jetë funksional gjatë vitit pasardhës.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	678
	2018	N/A
	2019	Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e sistemit
	2020	Nënshkrimi i 15 memorandumeve të bashkëpunimit nga ILDKPKI (treguesi është arritur në masën 6%)
	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>Deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve</b>
		50%

<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	
	2022	Forcimi i kapaciteteve të përdoruesve të sistemit nëpërmjet trajnimit
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Analizimi i funksionimit të sistemit

Realizueshmëria e këtij treguesi në vite paraqitet si në tabelën më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë 2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës.</li> <li>- Projektimi i sistemit dhe përgatitja e dokumentacionit.</li> <li>- Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastrukturës</li> </ul>	Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar
Vlera e synuar 2019 rritje 5%	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/ funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit</li> <li>- Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi</li> <li>- Testimi i integruar dhe dorëzimi</li> <li>- Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit</li> <li>- Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit.</li> </ul>	Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar
Vlera e synuar 2020 rritje 5%	Memorandume Mirëkuptimi të nënshkuara ndërmjet ILDKPKI dhe 17 institucioneve. <sup>22</sup>	Vlera e synuar nuk është arritur. Memorandum i nënshkuar vetëm me 1 institucion nga 17. <sup>23</sup>
Vlera e synuar 2021	Deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve	Është krijuar gjithë infrastruktura e nevojshme. Subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarohen përmes sistemit

<sup>22</sup> Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme Detare, ATRAKO, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Banka e Shqipërisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, SPAK, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

<sup>23</sup> Prokuroria e Përgjithshme



		elektronik EACIDS duke filluar nga data 1 janar 2022.
--	--	---

### A.5.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.b** për vitin 2021 është: realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme (të kryera në ILDKPKI), mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme. Për vitin 2022 vlera e synuar është realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme, mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme.

Gjatë vitit 2020, janë përfunduar 9 raporte sipas afateve ligjore, teksa vlera e synuar ishte 85% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

A. 5.5	Monitorimi i ushtrimit të funksioneve nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sinjalizimin
A. 5.5.1	Termet e referencës të hartuara (faza I) Monitorimi i kryer për 166 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik (faza II) Raporti vlerësues i hartuar me rekomandimet e dhëna për njësitë përgjegjëse në sektorin publik mbi zbatimin e ligjit të sinjalizimit (faza III)
A. 5.6	Analizim gjithëpërfshirës mbi zbatueshmërinë e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
A.5.6.1	Termet e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe shpërndarë, me palët e interesuara
A. 5.7	Organizimi i sesioneve konsultuese dhe hartimi i ndryshimeve në ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
A. 5.7.1	Rekomandime të hartuara bazuar mbi gjetjet e vlerësimit (I) Ndryshime ligjore të hartuara bazuar mbi rekomandimet e hartuara të vlerësimit (II) 3 sesione konsultuese mbi ndryshimet ligjore të hartuara me palët e interesuara (III)

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht kanë filluar në tremujorin e katërt të vitit 2021.

Gjatë janar - dhjetor 2021, ka patur 11 raste të sinjalizimeve të jashtme të regjistruara pranë ILDKPKI. Për të gjitha rastet (100%), ka filluar apo është finalizuar hetimi administrativ në përputhje me afatet që parashikon ligji nr.60/2016.

Lidhur me monitorimin e ushtrimit të funksioneve nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sinjalizimin, me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, nr.658, datë 27.09.2021, gjatë periudhës raportuese, u ushtrua kontroll në 192 Njësi Përgjegjëse të Sinjalizimit të Brendshëm në Autoritetet Publike (*166 objektivi i parashikuar për vitin 2021*). Programit i kontrollit përfshiu verifikimin për ngritjen dhe funksionimin e NJP, verifikimin e hartimit dhe miratimit të rregulloreve të posaçme për procedurën e shqyrtimit dhe hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit sipas ligjit, kontrollin e punës së bërë nga NJP për njohjen dhe zbatimin e ligjit 60/2016 dhe kontrollin e përgatitjes së regjistrimit të regjistrimit të rasteve të sinjalizimit dhe regjistrimin e rasteve të mbrojtjes nga hakmarrja.

ILDKPKI, në kuadër të përmbushjes së rolit të saj parandalues si edhe në përmbushje të detyrimeve ligjore, përgjatë periudhës raportuese, ka vijuar të ketë kontakte të ngushta me njësitë përgjegjëse me qëllim rritjen e nivelit të njohjes dhe zbatimit të ligjit. Kështu, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), gjatë periudhës 24 qershor – 2 korrik 2021 ka kryer disa sesione trajnimi me njësitë përgjegjëse të sektorit privat për ngritjen e kapaciteteve mbi dispozitat e ligjit, mekanizmat e vendosur për raportimin e akteve dhe praktikave të dyshuara korrupsioni, si dhe mbrojtjen që ligji ofron për sinjalizuesit. Këto aktivitete u organizuan me mbështetjen e pranisë së OSBE-së në Shqipëri. Programi i trajnimit është realizuar gjatë 7 aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve, duke synuar njësitë përgjegjëse në subjektet private të koordinuara me ILDKPKI. Në total, janë trajnuar 220 anëtarë të njësive përgjegjëse në sektorin privat.

Në përfundim të seancave të trajnimit, me mbështetjen edhe të OSBE, po punohet për publikimin e një udhëzuesi me pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta që kanë rezultuar nga këto seanca trajnime, por edhe seancat e mëparshme të trajnimit. Udhëzuesi, i cili do t’ju shërbejë njësive përgjegjëse të sektorit privat që kanë detyrim zbatimit të ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, përmban pyetje dhe përgjigje të ndryshme në lidhje me; ligjin dhe konceptet e tij, rolin e sinjalizuesve dhe të njësive përgjegjëse, mekanizmat e sinjalizimit, procedurat dhe politikat e brendshme që duhet të adoptojnë kompanitë, mënyrën e raportimit pranë ILDKPKI dhe afatin kohor të raportimit, si mund të mbrohen në mënyrë efektive sinjalizuesit dhe cilat janë garancitë ligjore.

Me mbështetjen e Këshillit të Europës u zhvilluan seanca trajnimi me Autoritetet Përgjegjëse për përdorimin e sistemit. Në total, u trajnuan 282 përfaqësues të Autoriteteve Përgjegjëse në periudhën tetor – dhjetor 2021. Gjithashtu, janë hartuar dhe miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe formularët e deklaramit për qëllime dhe udhëzuesit përkatës për deklarimin online dhe funksionimin e sistemit EACIDS.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:


<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	161
	2018	N/A
	2019	80% e sinjalizimeve të jashtme të regjistruara përfundohen brenda afatit ligjor
	2020	85% e sinjalizimeve (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	100% e sinjalizimeve
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Vlerësim gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Konsultimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	-	
Vlera e synuar 2018	70% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. Pa të dhëna se sa ka qënë numri i raporteve të të përfunduara brenda afatit
Vlera e synuar 2019	80% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. Pa të dhëna. Pa të dhëna se sa ka qënë numri i raporteve të të përfunduara brenda afatit
Vlera e synuar 2020	85% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor	Raportuar 100%. 9 raporte të përfunduara sipas afateve ligjore.
Vlera e synuar 2021	Realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme (të kryera në ILDKPKI), mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme.	11 raste të sinjalizimeve të jashtme të regjistruara pranë ILDKPKI. Për të gjitha rastet (100%), ka

		filluar apo është finalizuar hetimi administrativ në përputhje me afatet që parashikon ligji nr.60/2016.
--	--	--

Vlerat e synuara të këtij treguesi janë raportuar të realizuar 100%, brenda afatit ligjor, për të gjitha rastet e sinjalizimit të jashtëm, të ardhura pranë ILDKPKI.



### Niveli i realizimit të objektivit A.5.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **75%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR A.5 = \frac{TP A.5.a (50\%) + TP A.5.b (100\%)}{2 TP} \times 100\% = 75\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.5 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (51 në 85 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për

monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklarimit elektronik EACIDS. <https://www.ildkpk.al/akte-nenligjore/>.

### **Risqet për realizimin e Objektivit A.5**

Përsa i përket kapacitetit të autoriteteve përgjegjëse për përfitimin e njohurive në lidhje me përdorimin e sistemit dhe transmetimin e njohurive të subjektet deklaruese, ka mundësi "të mesme" të riskut dhe ndikim "të lartë" në arritjen e objektivit.

Përsa i përket numrit të ulët të sinjalizimeve të jashtme pranë ILDKPKI ka mundësi "të mesme" të riskut dhe ndikim "të mesëm" në arritjen e objektivit.

### **A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike**

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*A.6.a: Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuar nga auditorët e jashtëm.*

*A.6.b: Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor.*

*A.6.c: Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA.<sup>24</sup>*

Plani i veprimit për Objektivin A.6 parashikon 11 Aktivitete dhe 5 Masa.

#### **A.6.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.a** për vitin 2021 është: **pranimi** nga KQZ i 80% të raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera. Për vitin 2022 vlera e synuar është **pranimi** nga KQZ i 100% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera. Për vitin 2023 vlera e synuar është **pranimi** nga KQZ i 100% e raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte pranimi nga KQZ i 80% të raporteve të auditit të certifikuar nga auditorë të jashtëm për partitë parlamentare dhe trend rritës për partitë e tjera. Ky tregues performance u realizua në masën 45%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

---

<sup>24</sup> ACFA (Anti Corruption Framework Assessment) është projekti i financuar nga Bashkimi European që u zbatua në periudhën 2014-2015.

A. 6.1	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i modelit standard për raportimin financiar për vitin kalendarik; Forcim i kapaciteteve për financierët e partive, strukturën e posaçme në KQZ, audituesit ligjorë.
A. 6.1.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar (në përputhje me ndryshimet e reformës legislative)
A. 6.1.2	Seanca trajnimi të kryera (I) Seanca trajnimi të kryera për modelin e raportimit financiar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.6.3	Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara; Forcim/zhvillim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara
A. 6.3.1	Modeli standard i miratuar/i rishikuar
A. 6.3.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
A.6.4	Përditësim i vazhdueshëm i udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar (në përputhje me ndryshimet mundshme ligjore); Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara
A. 6.4.1	Udhëzimet e përditësuara të raportimit financiar
A. 6.4.2	Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati.

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë vitit 2021, u realizua auditimi i 75 raporteve financiare të vitit kalendarik 2020. Vetëm 10 prej tyre janë të certifikuara nga audituesit ligjorë. Linku i publikimit të të gjithë raporteve gjendet në <http://kqz.gov.al/raportet-e-auditimit-financiar-per-fondet-vjetore-2018/>.


Është ndryshuar dhe është miratuar formati i raportimit të monitoruesve dhe audituesve në përputhje me ndryshimet ligjore dhe janë trajnuar në total 64 persona, monitorues (32 femra dhe 32 meshkuj) dhe 19 auditues ligjor në bashkëpunim me NDI dhe zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë.

Gjithashtu janë përditësuar/ndryshuar/shtuar udhëzimet në lidhje me raportimin financiar, në përputhje me ndryshimet ligjore dhe janë kryer seanca trajnimi online për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	61% (11 nga 18)
	2018	N/A
	2019	75% e raporteve të auditimit
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	2020	80% e raporteve të auditimit (treguesi është arritur në masën 45%)
	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>80% e raporteve të auditimit</b>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 40%
	2022	100% e raporteve të auditimit
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	100% e raporteve të auditimit

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Siç tregojnë të dhënat e grafikut, realizueshmëria e këtij treguesi në vite ka qenë me e ulët se vlerat e synuara.



### A.6.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.b** për vitin 2021 është: **rritja në masën 50% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike**. Për vitin 2022 vlera e synuar është rritja në masën 70% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike. Për vitin 2023 vlera e synuar është rritja në masën 100% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar të shkeljeve financiare nga partitë politike (që do të thote se çdo shkelje financiare e evidentuar do të shoqërohet me sanksion).

Gjatë vitit 2020, KQZ konstatoi 36 raste të shkeljes së rregullave të financimit dhe 20 partive politike iu vendosën sanksione. Vlera e synuar e këtij treguesi u realizua me 154%, pasi kjo shifër përbën 55% të sanksioneve të dhëna, nga 30% që ishte vlera e synuar.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

A. 6.2	Ngritja e kapaciteteve profesionale për personat përgjegjës që kontrollojnë financimin e partive politike; Forcimi i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ
A. 6.2.1	Trajnime të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
A.6.2.2	Tryeza pune/seminare për stafin e KQZ.

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjeter).



Për janar-dhjetor 2021, janë zhvilluar seanca trajnimi për staf të KQZ, (online), në total me 8 pjesëmarrës (6 femra dhe 2 meshkuj), në bashkëpunim me NDI në lidhje me procedurat e verifikimit dhe kontrollit paraprak të raporteve të dorëzuara pas zgjedhjeve. Janë zhvilluar gjithashtu tryeza pune dhe seminare në bashkëpunim me NDI dhe me zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë.


Gjithashtu është miratuar vendimi nr.430 datë 21.07.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me sanksionet në lidhje me dorëzimin e raporteve financiare vjetore për partitë politike të cilat nuk kanë dorëzuar raporte ose/dhe i kanë dorëzuar jashtë afatit ligjor. Nga 131 parti politike të rregjistruara, 110 prej tyre janë subjekt i sanksionimit për shkak të shkeljes së detyrimeve që parashikon Kodi Zgjedhor duke tejkaluar vlerën e synuar të periudhës prej 50% në masën 83.9%.

([http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Vendim\\_nr-430\\_-date-210722\\_Dorezimi-i-raporteve-vjetore-financiare-per-vitin-kalendarik-2020-Final.pdf](http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Vendim_nr-430_-date-210722_Dorezimi-i-raporteve-vjetore-financiare-per-vitin-kalendarik-2020-Final.pdf))

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	38%
	2018	N/A
	2019	25% e sanksioneve
	2020	30% e sanksioneve (treguesi është arritur në masën 155%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>50% e sanksioneve</b>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	70% e sanksioneve
		100% e sanksioneve
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### A.6.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.c** për vitin 2021 është: **mbajtja** në 5 e raporteve financiare vjetore të partive politike. për vitet 2022 dhe 2023 vlera është po e njëjta.

Për vitin 2020 vlera e synuar e treguesit ishte rritja në 5 e numrit total të raporteve financiare vjetore dhe raporteve financiare të fushatës dhe raportet përfundimtare të auditimit të 5 partive më të mëdha politike, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

A.6.5	Përditësim i vazhdueshëm i metodologjisë së kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike; Forcimi i kapaciteteve për strukturën e posaçme në KQZ, dhe gjithë palët e interesuara në lidhje me këtë metodologji (seanca trajnshmesh të programuara)
A.6.5.1	Metodologji e përmirësuar/ e përditësuar
A.6.5.2	Nr. i personave të trajnuar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
A.6.5.3	Raportet e kontrollit të financave të partive politike të publikuar/ raporte të KQZ të publikuar.

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për janar - dhjetor 2021, KQZ ka realizuar auditimin e raporteve financiare të fushatës dhe të vitit kalendarik. Vlera e synuar ishte 5 parti, ndërsa vlera e arritur është 10 raporte auditimi.


Është përditësuar/ndryshuar metodologjia e të dhënave për kontrollin e verifikimin e financave të subjekteve politike zgjedhore. Stafi i sektorit të kontrollit financiar ka kryer trajnime në lidhje me verifikimin paraprak dhe kontrollin e raporteve financiare. Janë publikuar raportet financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020.

Realizimi i masave të këtij treguesi për periudhën raportuese është i plotë me 100% të aktiviteteve.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	5
	2018	N/A
	2019	5
	2020	5 (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	5
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	100%
	2022	5
	2023	5

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



## Niveli i realizimit të objektivit A.6.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është 80%.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR A.6 = \frac{TP A.6.a (40\%) + TP A.6.b (100\%) + TP A.6.c (100\%)}{3 TP} \times 100\% = 80\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.6 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86 deri në 110 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e periudhës janar - dhjetor 2021. Dorëzimi i raporteve financiare për vitin 2020 aksesohet në linkun: [http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Vendim\\_nr-430\\_-date-210722\\_Dorezimi-i-raporteve-vjetore-financiare-per-vitin-kalendarik-2020-Final.pdf](http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Vendim_nr-430_-date-210722_Dorezimi-i-raporteve-vjetore-financiare-per-vitin-kalendarik-2020-Final.pdf)

Formati i ndryshuar i raportimit të monitoruesve dhe audituesve gjendet në link: <http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Formati-i-Raportimit-te-Monitoruesit-te-fushates-zgjedhore.pdf>

[http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/4\\_Format-i-auditimit-per-fushaten-zgjedhore.pdf](http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/10/4_Format-i-auditimit-per-fushaten-zgjedhore.pdf)

### Risqet për realizimin e Objektivit A.6

Risku i realizimit të objektivit për forcimin e regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike ka mundësi të mesme risku dhe ndikim të mesëm të tij në lidhje me vendimmarrjen politike. Kurse për ngritjen e kapaciteteve profesionale për personat përgjegjës që kontrollojnë financimin e partive politike; forcimin e kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, ka mundësi të mesme risku dhe ndikim të lartë të tij në lidhje me kapacitetet profesionale të personave përgjegjës për financat e partive politike. Gjithashtu ekziston një mundësi e mesme risku dhe ndikim i mesëm i tij për kapacitetet profesionale të stafit teknik të KQZ, të rekrutuar rishtazi.

### *A.7 Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 4 tregues performance:

*A.7.a: Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike.*

*A.7.b: Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar*

*A.7.c: Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare*

*A.7.d: Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë referuar sinjalizimeve të pranuar*

Plani i veprimit për Objektivin A.7 parashikon 12 Aktivitete dhe 4 Masa.

### **A.7.a**

*Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike.*

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.a** për vitin 2021 është trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës. Vlera e synuar për vitet 2022 e 2023 është po e njëjta.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte trend rritës përkundrejt vlerës bazë të 2015. Gjatë kësaj periudhe, 99.4% e rekomandimeve nga auditimet e brendshme të nxjerra nga MFE, janë pranuar nga institucionet. Gjithashtu, rekomandimet e nxjerra nga auditimet e brendshme, të implementuara/zbatuara nga institucionet, janë në masën 65%.

Raportimi i plotë për këtë tregues performance është bërë në maj 2021 dhe të përfshira në raportin 6-mujor të monitorimit të SNKK, miratuar me vendim nr.27, datë 25.10.2021, të GTA. Vlerat e raportuara nga MFE në këtë raportim vjetor të vitit 2021 janë:

**Nën-treguesi a.1:** Rekomandimet e nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të pranuar nga institucionet.

*Objektivat për tu arritur në 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë:* Trend rritës Viti 2020 – 99.4% e rekomandimeve të pranuar.

Numri i rekomandimeve të prodhuara nga auditorët e brendshëm dhe të pranuar nga institucionet.

**Nën-tregues a.2:** Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të implementuara/zbatuara nga insitucionet

*Objektivat për tu arritur në 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë:* Trend rritës Viti 2020 - 53% e rekomandimeve të zbatuara.

Numri i rekomandimeve të prodhuara nga auditorët e brendshëm të implementuara nga institucionet.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masa (1) si më poshtë.

A. 7.1	Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve të vijueshme profesionale (TVP) të organizuara çdo vit, ku përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit dhe kryerja e vlerësimeve të jashtme të cilësisë (VJC), të cilat fokusohen tek vlerësimi i performances së veprimtarisë audituese dhe tek rekomandimet e dhëna për përmirësimet e nevojshme në aktivitetin e auditit të brendshëm
A. 7.1.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi dhe miratimi i programit të TVP (II) Përgatitja e materialeve të trajnimit (III) Zbatimi i programit të TVP dhe 100% e auditit të brendshëm të punësuar dhe të certifikuar në sektorin publik (IV) 15 vlerësime të jashtme të cilësisë/vit.
A. 7.1.2	Hartimi i udhëzuesit për audituesit e brendshëm në auditimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.
A.7.1.3	Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi prezantimin e udhëzuesit në auditimin e mashtrimit financiar dhe kontrollit. Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi etikën dhe integritetin.
A.7.1.4	Kryerja e auditimeve të brendshme pilot dhe vizitë studimore mbi etikën dhe integritetin.

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për *janar-dhjetor 2021*, janë kryer vlerësimet e jashtme të cilësisë në referim vlerësimit të performances së veprimtarisë audituese, sipas programit vjetor i Trajnimeve të Vijueshme Profesionale (VJC), të miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr.345, datë 31.12.20. Kështu, në këtë vit janë realizuar 25 VJC në Njësitë e Auditimit të Brendshëm, që funksionojnë në njesitë publike. Përkatësisht, vlerësime janë kryer në: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Mjeksësisë i Tiranës, Ujësjellës Kanalizime Vlorë, Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Spitalin Rajonal Gjirokastër, Qendra Spitalore Berat, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ALBCONTROL, Agjencia Kombëtare e Kadastrës, Bashkia Kavajë, Bashkia Kolonjë, Bashkia Dibër, Bashkia Shkodër, Bashkia Lezhë, Kuvendi, Radio Televizioni Shqiptar, OST sha, Posta Shqipatre sha, Bashkia Librazhd, Bashkia Dropull, KLGJ, Universiteti Mjeksësisë, Bashkia Roskovec, Bashkia Patos. Gjatë këtyre vlerësimeve janë evidentuar mangësitë dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Në muajin Maj 2021, u finalizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik “Raporti mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2020”. Në këtë raport është analizuar niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm për vitin 2020. Gjatë vitit 2020, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë dhënë 7940 rekomandime dhe janë pranuar nga subjektet e audituara 7889 rekomandime ose 99.4% e tyre. Gjatë vitit 2020, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë pranuar nga subjektet e audituara 7889 rekomandime dhe janë zbatuar 4177 rekomandime ose 53% e tyre.

Viti	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të pranuar dhe zbatuara
2016	7629	5183
2017	8341	4625
2018	7897	4501
2019	8294	4941
2020	7889	4177
2021 <sup>25</sup>	-	-

**Nën-treguesi a.1:** Rekomandimet e nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të pranuar nga institucionet. Për vitin 2020 ka një trend rritës me 99.4% e rekomandimeve të pranuar.

**Nën-tregues a.2<sup>26</sup>:** Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të implementuara/zbatuara nga insitucionet. Për vitin 2020 ka një trend rritës me 53% e rekomandimeve të zbatuara.

Duke qenë se raportimi i plotë për këtë tregues performance bëhet në maj 2022, për periudhën aktuale të monitorimit nuk arrihet një vlerë konkrete matjeve dhe raportimi.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:


<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	60 %
	2020	trend rritës përkundrejt vlerës bazë të 2015
	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës
		Nuk mund të matet aktualisht!

<sup>25</sup> Këto të dhëna analizohen nga Raportet Vjetore të Auditimit të Brendshëm të cilat sipas përcaktimeve ligjore duhet të konsolidohen në Maj të vitit pasardhës. Pra, ky tregues për vitin 2021 do të raportohet në Maj të vitit 2022.


<sup>26</sup> Raporti për vitin 2021 përfundon në Maj 2022.

<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	
	2022	trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Siç vihet re nga grafiku, prej vitit 2016 e në vijim, deri në vitin 2020, rekomandimet e auditimit të brendshëm të pranuar dhe të zbatuara kanë ardhur në rënie.





## A.7.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.b** për vitin 2021 është: **rritja në masën 10%**.  
Vlera e synuar për vitet 2022 e 2023 është po e njëjta.

Për vitin 2020 vlera e synuar e treguesit ishte rritje në masën 10 %. Gjatë kësaj periudhe, pranë strukturës së Drejtorisë së Inspektimit janë adresuar 9 sinjalizime nga strukturat audituese, referuar gjetjeve/parregullsive të konstatuara gjatë misioneve të auditimit, krahasur me 8 sinjalizime gjatë vitit 2019.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masa (1) si më poshtë.

A. 7.2	Ndërgjegjësim me qëllim informimin e drejtuesve të njësive të auditit të brendshëm mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar publik
A. 7.2.1	Takim me drejtues të DAB të institucioneve, 2 seminare/vit
A.7.2.2	Përfaqësuesit e njësive DAB të institucioneve informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar public
A.7.2.3	Takime të kryera

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë *janar-dhjetor 2021*, në kuadër të ndërgjegjësimit me qëllim informimin e drejtuesve të njësive të auditit të brendshëm mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar publik, janë realizuar 2 takime me përfaqësues të DAB të institucioneve qendrore, gjatë të cilave janë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit si dhe mbi raste konkrete të përcjella në DIFP/MFE.

Përfaqësuesit e njësive DAB janë informuar mbi mundësitë e bashkëpunimit si dhe është vijuar me bashkëpunime konkrete audit-inspektim të përcjella në MFE.


Gjatë periudhës së monitorimit, pranë strukturës së Drejtorisë së Inspektimit janë adresuar 3 raste nga struktura të auditit të brendshëm dhe për këtë periudhë, treguesi është realizuar në masën 30%, kryesisht për arsye të mosaksesimit të dokumentacionit të plotë në subjekte jashtë programit të auditimit, apo për raste të dyshimeve për parregullsi të cilat mund të përbëjnë elementë të veprave penale dhe për të cilat nevojitet hetim i mëtejshëm, janë përcjellë pranë inspektimit financiar publik për hetim të mëtejshëm. Ky numër është relativisht më i ulët së viti paraardhës dhe duke qenë se këto raste janë një nga burimet kryesore që mund të shërbejnë si bazë për fillimin e inspektimit financiar publik, kjo do të ndikojë në numrin total të inspektimeve të kryera. Për

shkak të situatës globale të pandemisë Covid-19, u veshitirësua puna në terren për rrjedhojë u ul dhe numri i sinjalizimeve.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	5
	2020	Rritje me 10% (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritje me 10%
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 30%
	2022	Rritje me 10%
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritje me 10%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### A.7.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.c** për vitin 2021 është: 5% nga viti referues (2019), vlera e synuar për vitin 2022 është 10% nga viti referues (2019) dhe vlera e syuar për vitin 2023 është 15% nga viti referues (2019). Për vitin 2020 vlera e synuar ishte **3%** nga viti referues (2019).

Për vitin 2020 janë shqyrtuar 85% e sinjalizimeve të adresuara pranë strukturës së DIFP.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masa (1) si më poshtë.

A.7.3	Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit
A.7.3.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë, lidhur me trajtimin e parregullsive financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) (III)
A.7.3.2	Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj. *Trajnimet kryhen për çdo vit të zbatimit të PV
A.7.3.3	Kryerja e vizitave studimore dhe trajnimeve mbi etikën dhe integritetin (aktivitet që fillon në vitin 2021)
A.7.3.4	Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.)

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjektor).

Për *janar-dhjetor 2021*, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit, u hartua programi i trajnimit dhe janë zhvilluar 4 trajnime me inspektorët financiarë publik mbi rastet e keqmenaxhimit, shpërdorimit të detyrës, konceptet bazike të inspektimit, trajtimi i provave, etj, me 64 inspektorë të trajnuar, 42 femra dhe 22 meshkuj. Për shkak të situatës së pandemisë Covid-19, janë trajnuar online inspektorët financiarë publikë të jashtëm, mbi kodin e etikës dhe parimet themelore përfshirë integritetin.


Për periudhën raportuese ka patur vetëm 1 referim në prokurori, pasi shkeljet e konstatuara përbënin veprë penale. Duke qenë se vlera për vitin 2021 është 5% rritje nga viti referues (2019),

vit në të cilin ka patur 2 referime në Prokurori, atëherë konkludohet se vlera për vitin 2021 është arritur në masën 47.6 % (2+2x0.05).

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	2 referime
	2020	3% nga viti referues (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>5% nga viti referues</b>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>47.6%</b>
	2022	10% nga viti referues
	2023	10% nga viti referues
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>		

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



#### A.7.d

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.d** për vitin 2021 është: për **85% të sinjalizimeve** (që plotësojnë kriteret e ligjit) brenda vitit raportues, **të jenë iniciuar inspektime**. Vlera e synuar

për vitin 2022 është për 90% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteret e ligjit), të jenë iniciuar inspektime dhe vlera e syuar për vitin 2023 është për 95% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteret e ligjit), të jenë iniciuar inspektime.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte për 80% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteret e ligjit), brenda vitit raportues të jenë iniciuar inspektime. Për vitin 2020, për 85% të sinjalizimeve të cilat plotësonin kriteret e parashikuara në ligjin e inspektimit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë iniciuar inspektime financiare publike brenda vitit raportues. Megjithatë në raportimin e kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk evidentohet një numër konkret i inspektimeve të kryera për vitin 2020, i cili do të bënte të mundur vlerësimin kumulativ të inspektimeve në 3 vite.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masa (2) si më poshtë.

A.7.3	Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit
A.7.3.1	Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë, lidhur me trajtimin e parregullsive financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) (III)
A.7.3.2	Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj.
A.7.3.3	Kryerja e vizitave studimore dhe seminareve mbi etikën dhe integritetin
A.7.3.4	Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.)
A.7.4	Veprimtari informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit
A.7.4.1	Informacion i përditësuar në faqen zyrtare mbi DIFP (I) Deklarata të bëra publike (II) Menu informacioni në ëeb (III)

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë janar-dhjetor 2021, në kuadër të veprimtarive informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit, nga ana e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, është pasqyruar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, publikimi i


përmbledhjeve ekzekutive dhe rezultateve të inspektimeve të kryera, raporte të veprimtarisë, etj, në masën 100%. Në faqen zyrtare të MFE gjendet një menu informacioni mbi funksionet e DIFP, së bashku me publikimin e përmbledhjeve ekzekutive dhe rezultateve të inspektimevetë kryera, raporteve të veprimtarisë, etj.

Për vitin 2021, ka pasur 5 sinjalizime të cilat plotesonin kriteret, dhe për të cilat janë inicuar inspektimeve financiare nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, evidentohet fakti që gjatë këtij viti në kuadër të veprimtarive informuese e sensibilizuese, me qëllim ndërjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit, nga ana e kësaj Drejtorie, bërë publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, publikimi i përmbledhjeve ekzekutive dhe rezultateve të inspektimeve të kryera, raporte të veprimtarisë, etj. në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	70%
	2020	80% e sinjalizimeve
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	85% e sinjalizimeve
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	90% e sinjalizimeve
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	95% e sinjalizimeve

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### Niveli i realizimit të objektivit A.7.

Niveli i realizimit të Objektivit A.7 *Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është 59.2%.

$$NR A.7 = \frac{TP A.7.a (-\%) + TP A.7.b (30\%) + TP A.7.c (47.6\%) + TP A.7.d (100\%)}{4 TP} \times 100\% = 59.2\% \quad ^{27}$$

Duke llogaritur vlerën e tre treguesve të performancës, shkalla e realizimit të objektivit A.7 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (51 në 80 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.7

Risku i realizimit të këtij objektivit është i mesëm, për shkak të çështjeve që lidhen me komunikimin dhe informimin si dhe proceset operacionale dhe sistemin e menaxhimit të të dhënave.

<sup>27</sup> Ibid footnote 5.

## A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

Për këtë objektivi është përcaktuar 1 tregues performance: A.8: Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion.

Plani i veprimit për Objektivin A.8 parashikon 10 Aktivitete dhe 7 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.8** për vitin 2021 është: *mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD*. Për vitin 2022 vlera e synuar është *mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë)*. Për vitin 2023 vlera e synuar është *të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku*.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte udhëzime të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore); Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit; Është vendosur një plan veprimi ndër-institucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut; Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të testohen dhe zbatuara në 10 institucione publike (qendrore)/ministri.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (7) si më poshtë.

A. 8.1	Dokumenta strategjike të hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës (analiza e riskut për prirjet ndaj korrupsionit)
A. 8.1.1	Udhëzues/metodologjia mbi vlerësimin e riskut të integritetit në qeverisjen qendrore, i hartuar dhe i miratuar
A.8.2	Forcim i kapaciteteve të stafit të MD mbi procesin e vlerësimit të riskut të integritetit për këtë institucion
A. 8.2.1	Trajnim i stafit mbi identifikimin e risqeve të integritetit /Takime pune mbi identifikimin e proceseve të punës që janë të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit (faza I) Identifikim i risqeve të integritetit sipas proceseve të punës (faza II) Analizim dhe vlerësim i intensitetit të risqeve të identifikuar (faza III) Trajtimi i risqeve prioritare dhe atyre të moderuara si edhe hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në MD (faza IV)
A.8.3	Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet e varësisë së MD sipas modelit të zhvilluar në MD (Udhëzuesit)
A. 8.3.1	Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj institucioneve të varësisë të MD, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i udhëzuesit
A. 8.3.2	Vlerësimi i riskut në institucionet e varësisë të MD, i hartuar dhe i miratuar
A.8.4	Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe varësitë e tyre, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen qendrore (udhëzuesi)



A.8.4.1	Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj ministrive të linjës, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i Udhëzuesit ministrive;
A.8.4.2	Vlerësimi i riskut në nga ministrinë, i hartuar dhe i miratuar
A.8.4.3	Vlerësimi i riskut në nga ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë, i hartuar dhe i miratuar
A.8.5	Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore
A.8.5.1	Nr. i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit (I) Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve (II) Nr. i rasteve të referuara në prokurori (III)
A.8.6	Raportimi i rasteve të masave disiplinore, administrative e kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit në administratë
A.8.6.1	Nr. i rasteve/zyrtarëve të gjetur në shkelje për praktika korruptive.
A.8.7	Transparencë e rritur e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për rastet e kontrolleve të bëra nga TFA
A.8.7.1	Nr. i komunikimeve (deklarata, konferenca, njoftime për shtyp) online të KKK për rastet e kontrolleve të TFA

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej vitit 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjeter).

Gjatë *janar-dhjetor 2021*, të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë ngritur grupet e punës për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit, është kryer vlerësimi i riskut të integritetit, dhe është kryer hartimi dhe parashikimi i masave dhe iniciativave përmirësuese të performancës së institucioneve me konsolidimin dhe miratimin e planeve institucionale të integritetit.

Është zhvilluar 1 trajnim (online) për stafin e drejtorisë antikorrupsion nga ekspertë të DBE në Tiranë, në datën 11.02.2021 për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit. Janë zhvilluar takime nga MD për të gjithë anëtarët e grupeve të punës panë varësive të MD, në 12 janar 2021 (online) dhe në datat 22.04.2021; 27.05.2021; 24.06.2021 në DPB.

Është prezantuar Manuali për Vlerësimin e Riskut të integritetit në takimin e datës 14 tetor 2021, midis MD dhe Asistencës Teknike e DBE me të gjitha institucionet e varësisë së MD. Manuali mund të gjendet në link: <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/GUIDA-VLERESIMIT-RISKUT-AL.pdf>

Nën drejtimin dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, janë kryer 3 takime, në datat 12.01.2021; 11.2.2021 dhe 12.4.2021, takime për hartimin e Planit të Integritetit<sup>28</sup>. Procesi i vlerësimit të riskut

<sup>28</sup> Për më shumë referohu tek aktiviteti A.9.2.1.

të integritetit pranë secilit institucion varësive, është kryer përgjatë vitit 2021, procesi është mentoruar ngushtësisht nga MD.

Informacione më të detajuara mbi kontrole dhe inspektime për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore dhe varësi të tyre mund të konsultohen në aneksin I të këtij raporti monitorimi.

Në vitin 2021, është riformatuar struktura përgjegjëse antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë. Me miratimin e VKM Nr.618, datë 20.10.2021, është krijuar Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit nën drejtimin e Ministrit të Drejtësisë, i cili ka për detyrë të mbledhë, analizojë koordinojë, verifikojë dhe të kryejë hetimin administrativ të rasteve korruptive. Bazuar në kreun VII, neni 3 i këtij VKM, TFA është shfuqizuar si strukturë me ngritjen e këtij rrjeti. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi është ngritur Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, e cila ndër të tjera, kryen edhe koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Kjo drejtori ka forcuar rolin e saj në qasjen ndëshkuese përmes rrjetit të Koordinatorëve të shtrirë në 44 institucione publike në vend. Në funksion të adresimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit, struktura përgjegjëse kryen hetime të thelluara administrative për rastet në shqyrtim dhe në momentin që konstaton shkelje ligjore, referon çështje në prokurori si dhe merr masat e nevojshme administrative.

Në përfundim të hetimeve administrativ të rasteve të korrupsionit, Ministri i Drejtësisë/KKK ka zhvilluar 4 komunikime publike në formën e deklaratave për shtyp, në datat 9 dhe 16 nëntor dhe në datat 1 e 28 dhjetor 2021, ku janë bërë publike veprimet ligjore të KKK, i cili ka vepruar në mënyrë proaktive duke kryer kallëzime penale për raste konkrete pranë SPAK. Linket e publikimeve janë:

<https://www.facebook.com/manjaulsi/posts/307411301395275>

<https://www.facebook.com/manjaulsi/posts/289864186483320>

<https://www.facebook.com/ediramaal/videos/464633205081484>

<https://www.facebook.com/manjaulsi/videos/1193717161116686/>

Për këtë periudhë monitorimi rezulton se treguesi i performancës është arritur në masën 100%, pasi mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut janë testuar dhe janë zbatuar në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, duke konkluduar me miratimin e planeve të integritetit në të 12 këto institucione.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A

	2019	Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri.
	2020	Udhëzime të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore); - Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit; Eshtë miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut 65 - Është vendosur një plan veprimi ndërinstitucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut; - Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të testohen në 2020 dhe janë zbatuar në 10 institucione publike qendrore/ministri (treguesi është arritur në masën 50%)
Vlera e synuar/ Targeti	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë)
Vlera e synuar/ Targeti	2023	Të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	- Mungesa e kuadrit për kryerjen e vlerësimit sistematik të rrezikut të integritetit/korrupsionit	
Vlera e synuar 2018	- Eshtë hartuar dhe miratuar udhëzimi/manuali për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në institucionet publike si pjesë e planit të integritetit.	Vlera e synuar nuk është arritur.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është hartuar një program trajnimi lidhur me zbatimin e manualit.</li> <li>- Po zbatohet një plan veprimi ndër institucional për kryerjen e vlerësimeve të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit.</li> </ul>	
Vlera e synuar 2019	- Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2020	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzime të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore);</li> <li>- Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit;</li> <li>- Është vendosur një plan veprimi ndërinstitutional për kryerjen e vlerësimeve të riskut;</li> <li>- Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të të testohen 2020 dhe zbatuara në 10 institucione publike qendrore/ministri</li> </ul>	<p>Është miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike.</p> <p>Është hartuar programi i trajnimit për zbatimin e manualit dhe kryerjen e vlerësimit të riskut, për të filluar nga zbatimi në vitin në vijim (2021)</p> <p>Plan veprimi ndërinstitutional për kryerjen e vlerësimeve të riskut rezulton ende i papërfunduar (në proces).</p> <p>Por nuk realizuar produkti i 4-rt i treguesit.</p>
Vlera e synuar 2021	Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD	100%

#### Niveli i realizimit të objektivit A.8

Niveli i realizimit të Objektivit A.8 *Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **100%**.

Shkalla e realizimit të objektivit A.8 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (51-85 përqind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e mbledhur nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit A.8**

Mungesa e kapaciteteve për të kryer vlerësimet e riskut evidentohet si një risk potencial në vijueshmërinë e realizimit të objektivit A.8.

### **A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publik**

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance: Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë.

Plani i veprimit për Objektivin A.9 parashikon 3 Aktivitete dhe 3 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.9** për vitin 2021 është: **të gjitha varësitë e MD miratuar dhe publikuar një plan integriteti**. Për vitin 2022 vlera e synuar të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuar dhe publikuar një plan integriteti. Për vitin 2023 vlera e synuar të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuar dhe publikuar një plan integriteti.

Për vitin 2020, ku vlera e synuar ishte një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë, është miratuar udhëzuesi për hartimin e planit të integritetit, publikuar në linkun <https://www.drejtësia.gov.al/epcontent/uploads/2020/10/Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-eDrejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023.pdf>

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

A.9.2	Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësitë e MD
A. 9.2.1	Takime informuese/ndërgjegjësuere për punonjësit e varësive të MD mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Nr. i Planeve të Integritetit të hartuara dhe të miratuara nga institucionet e varësisë së MD

A.9.3	Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet qendrore (ministritë)
A. 9.4.1	Takime informuese/ndërgjegjësuere për punonjësit e institucioneve të varësive mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Dokumenti Plan Integriteti i hartuar dhe miratuar
A.9.5	Dokumente strategjike të hartuara përmes një procesi gjithëpërfshirës/metodologjia-udhëzuesi për vlerësimin e zbatimit të masave
A.9.5.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të vlerësimit të PI; ngritja e një strukture të raportit të vlerësimit

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej 2020 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Në *janar - dhjetor 2021*, Ministria e Drejtësisë ka kryer procesin e koordinimit dhe të asistencës teknike për të gjitha institucionet e varësisë së saj. Janë mbajtur takime në datat 12.01.2021; 11.02.2021; dhe datat 12.04.2021; 02.06.2021, 14.10.2021 mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit me qëllim hartimin e planit të integritetit, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve të varësisë.

Gjatë kësaj periudhe raportimi është përfunduar së hartuari, miratuari dhe publikuari një manual për hartimin e planeve të integritetit, i cili mund të aksesohet në link: <https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>. Ky është një dokument lehtësues për të gjithë autoritetet në ushtrimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e PI. Ky Manuali është prezantuar në takimin e datës 14 tetor 2021, midis MD dhe Asistencës Teknike të DBE me të gjitha institucionet e varësisë së MD.

Gjithashtu, në funksion të objektivit vjetor të këtij treguesi performance, janë zhvilluar trajnime për stafin e drejtorisë antikorrupsion lidhur me procesin e vlerësimit të riskut të integritetit. Në datat 25 dhe 26 shkurt 2021 është zhvilluar një trajnim për njohjen e praktikave më të mira antikorrupsion me koncepte kryesore: transparenca, e drejta e informimit, monitorimi i implementimit të të strategjisë AK, vlerësimi i riskut të integritetit dhe hartimi i Planeve të Integritetit.

Në dhjetor 2021, janë miratuar Planet e Integritetit në 12 institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht: ATP, miratuar me Urdhërin Nr. 64, datë 14.5.2021; DPSHP, miratuar me Urdhërin Nr.139, datë 13.12.2021; ASHSGJ miratuar me Urdhërin Nr. 68 datë 13.12.2021; KSHB miratuar me Urdhërin Nr. 20/1 datë 20.12.2021 5.DNJF, miratuar me Urdhërin Nr. 180, datë 22.12.2021; DNJF, miratuar me Urdhërin Nr. 180, datë 22.12.2021; QPKMR, miratuar me Urdhërin Nr. 16 datë 13.12.2021; DPP miratuar me Urdhërin Nr. 2509, datë 23.12.2021; QBZ, miratuar me Urdhërin Nr.56, datë 24.12.2021; DSHKBB, miratuar me Urdhërin Nr. 20 datë

15.12.2021; IML miratuar me Urdhërin Nr. 693/1, datë 24.12.2021; AKF miratuar me Urdhërin Nr.2, datë 31.12.2021 dhe DPB miratuar me Urdhërin Nr. 1401/1 date 23.12.2021.

Për këtë periudhë, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se ai është arritur plotësisht, në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	10 ministri kanë miratuar dhe publikuar planin e integritetit
	2020	Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë. (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Të gjitha varësitë e MD miratuan dhe publikuan një plan integriteti
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuan dhe publikuan një plan integriteti
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuan dhe publikuan një plan integriteti

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesa e kuadrit për hartimin e planeve të integritetit.	
Vlera e synuar 2018	Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2019	10 ministri kanë miratuar dhe publikuar planin e integritetit	Vlera e synuar nuk është arritur.

Vlera e synuar 2020	Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë.	Është miratuar udhëzuesi për hartimin e planit të integritetit.
Vlera e synuar 2021	Të gjitha varësitë e MD miratuan dhe publikuan një plan integriteti	Vlera e synuar është arritur. 12 institucionet e varësisë së MD kanë miratuar një plan integriteti me urdhër të brendshëm të titullarit të institucionit.

### Niveli i realizimit të objektivit A.9

Niveli i realizimit të Objektivit A.9 *Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **100%**.

Shkalla e realizimit të objektivit A.9 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e mbledhur nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2021. Në vijim gjenden linket e publikimit të planeve të Integritetit të institucioneve të varësive:

<https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>

### Risqet për realizimin e Objektivit A.9

Mungesa e kapaciteteve për të kryer vlerësimet e riskutevidentohet si një risk potencial në vijueshmërinë e realizimit të objektivit A.9.

### *A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

*A.10: Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike (Çdo vit).*

Plani i veprimit për Objektivin A.10 parashikon 2 Aktivitete dhe 2 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.10** për vitin 2021 është: *statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë*



(nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.

Vlerat e synuara për vitet 2022 e 2023 janë po të njëjtat.

- A) Numrin e hetimeve të nisura
- B) Numri i kallëzimeve të kërkuara nga Prokuroria
  - 1) Numrin e kërkesave për sekuestrim
- C) Numri i dënimeve
  - 1) Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim
  - 2) Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim
- D) Të dhënat për administrimin e pasurive:
  - 1) Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim
  - 2) Vlera e pasurive të konfiskuara nën administrim
  - 3) Vlera e realizuar nga shitja e pasurive të konfiskuara
  - 4) Numri i pasurive të kthyera pronarit
  - 5) Numri i pasurive të shkatërruara
  - 6) Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave mbi korrupsionin; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor, të prodhuara dhe të botuara çdo vit. Ky tregues performance është i realizuar.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

A. 10.1	Mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore mbi korrupsionin
A. 10.1.1	Informacion statistikor i prodhuar mbi korrupsionin (raport 6- mujor/vjetor) *Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024
A.10.2	Mbledhja dhe harmonizimi i të dhënave statistikore për asetet e konfiskuara dhe sekuestruara me vendim gjyqate për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe përcjellja pranë Komisionit Evropian
A. 10.2.1	Informacion statistikor i prodhuar lidhur në veprat penale të korrupsionit dhe të krimin të organizuar, sipas parashikimeve në Kodin Penal *Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë janar-dhjetor 2021, janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2020.

Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara, për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e dytë, vjetore 2020. Këto të dhëna janë botuar dhe publikuar në “Vjetarin Statistikor 2020” në linkun <https://www.drejtesia.gov.al/dokumenta/statistika/>

Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara si dhe të dhënat për vlerat e sekuestruara, për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021. Koordinimi dhe plotësimi i tabelave të *track record's* për Korrupsionin, për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetor 2020, si dhe Janar-Qershor 2021. Poashtu janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2020.

Janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 si dhe të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2020. Rezulton se janë dënuar 270 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 87 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin (për vitin 2020). Poashtu rezulton se janë dënuar 493 persona nga Gjykatat e Shkallës së Parë (me vendim të formës së prerë) dhe 354 persona nga Gjykatat e Apelit për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar (për vitin 2020). <https://www.drejtesia.gov.al/dokumenta/statistika/>

Janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara, si dhe vlerat e sekuestruara, për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Është realizuar koordinimi dhe plotësimi i tabelave të *track record's* për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për gjashtëmujorin e dytë dhe vjetore 2020, si dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Për vitin 2021 janë hartuar 3 raporte statistikore (6 mujori II 2020/Vjetore 2020/6 m I 2021), publikuar në Vjetarin Statistikor. Kështu, treguesi i performancës është arritur në masën 100%.

Kostoja e realizimit të kësaj masë është e mbuluar nga buxheti i shtetit.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	1
	2018	N/A
	2019	Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke

		<p>përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.</p>
	2020	<p>Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit (treguesi është arritur në masën 100%)</p>
Vlera e synuar/ Targeti	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<p>Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit</p>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	<p>Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C,</p>

		D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Statistikat e prodhuara nuk përmbajnë të dhëna të plota në pëputhje me Udhëzimet e Financial Action Task Force (FATF)	
Vlera e synuar 2018	Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit	Vlera e synuar është arritur.
Vlera e synuar 2019	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë në to: A. Numrin e hetimeve të nisura B. Numrin e kallëzimeve/aktakuzave të kërkuara nga Prokuroria 1. Numrin e kërkesave për sekuestrim C. Numri i dënimeve 1. Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim 2. Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim D. Të dhënat për administrimin e pasurive: 1. Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim	Vlera e synuar është arritur
Vlera e synuar 2020	Raportimi i statistikave duke përfshirë në to: A. Numrin e hetimeve të nisura B. Numrin e kallëzimeve/aktakuzave të kërkuara nga Prokuroria 1. Numrin e kërkesave për sekuestrim C. Numri i dënimeve 1. Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim 2. Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim D. Të dhënat për administrimin e pasurive: 1. Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim	Vlera e synuar është arritur

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Vlera e pasurive të konfiskuara nën administrim</li> <li>3. Vlera e realizuar nga shitja e pasurive të konfiskuara</li> <li>4. Numri i pasurive të kthyer pronarit</li> <li>5. Numri i pasurive të shkatërruara</li> <li>6. Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes</li> </ol>	
Vlera e synuar 2021	Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.	Vlera e synuar është arritur

### Niveli i realizimit të objektivit A.10

Niveli i realizimit të Objektivit A.10 *Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është 100%.*

Shkalla e realizimit të objektivit A.10 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

#### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2021. <https://www.drejtesia.gov.al/dokumenta/statistika/>

#### Risqet për realizimin e Objektivit A.10

Risku i realizimit të këtij objektiv ka mundësi “të ulët” të ndodhjes dhe ndikim “të ulët” në arritjen e objektivit. Risqet lidhen kryesisht me afatin e përpunimit të të dhënave statistikore nga struktura ëergjegjese, pasi afati nuk korrespondon me afatin e raportimit të indikatorit.

### A.11 Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore

Për këtë objektiv jnaë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.11.a: Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore antikorrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit)*

*A.11.b: Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore antikorupsion*

Plani i veprimit për Objektivin A.11 parashikon 3 Aktivitete dhe 3 Masa.

**A.11.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11** për vitin 2021 është: **10 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut**. Për vitin 2022 vlera e synuar është **40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut**. Për vitin 2023 vlera e synuar është **61 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut**.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte **6 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut**, ky tregues është arritur në vlerën 16.6%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

A. 11.1	Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot)
A. 11.1.1	Takime informuese të realizuara me titullarë të bashkive/me stafet e bashkive dhe finalizim i modelit të dokumentit
A.11.2	Përgatitja e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe dërgimi i tyre për miratim pranë këshillave bashkiake
A. 11.2.1	Takime teknike konsultative të realizuara (faza I) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2020 (faza II) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2021 (faza III) 40 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2022 (faza IV) të gjitha (61) bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2023

Për *janar-dhjetor 2021*, në funksion të parashikimeve të masës A.11.1, janë organizuar disa takime:

Takim konsultues me grupin e punës dhe stafin e Bashkisë Pogradec për të konsultuar draftin e parë të Planit të Integritetit; 9 dhjetor 2021 - Takim konsultues me Grupin e Punës dhe stafin e Bashkisë Berat, për të konsultuar draftin e parë të Planit të Integritetit; 9 dhjetor 2021 - Takim konsultues me grupin e punës dhe stafin e Bashkisë Belsh për të konsultuar draftin e parë të Planit të Integritetit; 10 dhjetor 2021 - Takim konsultues me grupin e punës dhe stafin e Bashkisë Përmet për të konsultuar draftin e parë të Planit të Integritetit; 15 dhjetor 2021 – Takim konsultues me grupin e punës dhe stafin e Bashkisë Lezhë për të konsultuar draftin e parë të Planit të Integritetit; 15 dhjetor 2021 – Fillimi i procesit në bashkinë Kavajë. Takimi dhe trajnimi me grupin e punës

për metodologjinë e vlerësimit të riskut. Fokus grupe sipas 7 fushave funksionale të bashkisë me stafin; 16-17 dhjetor 2021 - Fillimi i procesit në bashkinë Himarë. Takimi dhe trajnimi me grupin e punës për metodologjinë e vlerësimit të riskut. Fokus grupe sipas 7 fushave funksionale të bashkisë me stafin; 22-23 dhjetor 2021 - Fillimi i procesit në bashkinë Maliq. Takimi dhe trajnimi me grupin e punës për metodologjinë e vlerësimit të riskut. Fokus grupe sipas 7 fushave funksionale të bashkisë me stafin.

Gjithashtu, gjatë muajit dhjetor janë finalizuar Planet e Integritetit të 6 bashkive, të cilat më pas do të miratohen në Këshillin Bashkiak. Këto bashki janë: Tiranë, Pogradec, Berat, Përmet, Belsh, Shijak. Ndërkohë janë zhvilluar 25 takime për ngritjen e grupeve të punës në 12 bashki.

Për masën A.11.2 raportohet se, nga 10 bashki, vetëm bashkia Durrës e ka miratuar Planin e Integritetit në mbledhjen e datës 28.10.2021 të Këshillit Bashkiak. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe pasojave të ardhura nga tërmeti, kanë vonuar realizimin e masave në zbatim të Planit të Veprimit të SNKK. Gjatë vitit 2021, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë vazhduar konsultimet mbi zbatimin e objektivave, evidentimin e risqeve dhe zbatimin e masave. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore/Ministria e Brendshme kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me bashkitë dhe IDM (zbatuese e projektit STAR 2).

Gjatë vitit 2021, IDM ka vazhduar takimet me 5 njësi të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë duke implementuar planet e integritetit. Me fillimin e programit Star III dhe shpalljen e thirrjes, 14 bashki kanë shprehur interesin për t'u bërë pjesë në marrëveshje. Ato janë Bashkia Belsh, Berat, Bulqizë, Has, Himarë, Kavajë, Kukës, Lezhë, Maliq, Përmet, Pogradec, Pukë, Shijak dhe Tiranë. Pas finalizimit të intervistave me fokus-grupet dhe gjatë muajve në vazhdim, IDM dhe me pjesëmarrjen e specialistëve të AMVV, ka punuar për draftimin e Planeve të Integritetit në 6 bashki: Tiranë, Pogradec, Shijak, Lezhë, Përmet, Berat, Kukës, Bulqizë, Belsh.

Në bashkinë Tiranë, pas finalizimit të draftit të parë të Planit të Integritetit, u organizua një takim konsultues final me grupin e punës.

Në Bashkinë Pogradec dhe të Lezhës janë dërguar draftet e para të Planit për rishikim nga grupet e punës. Pas rishikimit, do të organizohen takimet konsultuese me qëllim finalizimin e draftit.

Pas finalizimit të drafteve dhe reflektimit të rekomandimeve, planet do të dërgohen në Këshillat Bashkiakë për miratim.

Gjithashtu, janë zhvilluar forume diskutimi on-line "*Nga strategjia në veprim: Plani i integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe sfidat në zbatimin e masave të veprimit*", organizuar në bashkëpunim me IDM.

Për këtë periudhë, nga informacioni i raportuar dhe analizuar (mbështetur në masat dhe aktivitetet për zbatim) për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi rezulton të jetë arritur në masën 10%, pasi vetëm 1 bashki e ka miratuar Planin e Integritetit, krahasimisht me 10 të tilla, si target e synuar për vitin 2021.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	AMVV-ja dërgon udhëzuesin, për të gjitha bashkitë.
	2020	6 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut (treguesi është arritur në masën 16.6%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	10 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 10%
	2022	40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	61 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve, paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Institucionet e qeverisjes vendore nuk kanë kryer vlerësim sistematik të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe nuk kanë plane të integritetit	
Vlera e synuar 2018	Ministria e Brendshme iu përcjell të gjitha Bashkive udhëzuesin për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimit të planeve të integritetit.	Vlera e synuar nuk është arritur.
Vlera e synuar 2019	Ministria e Brendshme kryen veprimtari informuese aktive me të gjitha Bashkitë udhëzuesin për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit dhe hartimin e planeve të integritetit.  5 Bashki hartojnë dhe miratojnë Plane të Integritetit	4 Bashki hartuan dhe miratuan Plane të Integritetit me metodologji alternative.



Vlera e synuar 2020	6 Bashki hartojnë dhe miratojnë Plane të Integritetit.	1 Bashki ka hartuar dhe miratuar Plan të Integritetit.
Vlera e synuar 2021	10 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut	1 Bashki ka miratuar Planin e Integritetit.

### A.11.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11.b** për vitin 2021 është: 10 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Për vitin 2022 vlera e synuar është 40 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit. Për vitin 2023 vlera e synuar është 61 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte 6 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit. Për këtë periudhë raportimi nuk është arritur vlera e synuar e këtij treguesi me një masë dhe aktivitet të pazbatuar dhe 0% vlerë e synuar e arritur.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

A. 11.3	Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me strategjinë antikorrupsion; Inkurajimi i bashkive të tjera për vitet në vijim
A. 11.3.1	Fushata informimi për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit/total 6 bashki për vitin 2020/total 10 bashki për vitin 2021/total 40 bashki për vitin 2022/total 61 bashki për vitin 2023

Për periudhën e monitorimit *janar-dhjetor 2021*, raportohet se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore/MB ka inkurajuar bashkitë që të përfshijnë në buxhet një zë specifik për implementimin e Planit të Integritetit. Si rrjedhojë 4 bashki kanë parashikuar një buxhet për implementimin e tyre (Bashkia Patos me VKB nr.71 datë 14.12.2021; Bashkia Mallakastër, me VKB nr. 58 datë 20.12.2021; Bashkia Mat me VKB nr. 30 datë 17.12.2021 dhe Bashkia Gjirokastër me VKB nr.107 datë 24.12.2021)

Janë realizuar fushata informimi për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e masave konkrete të planeve të integritetit, sipas parashikimeve që jep plani i veprimit antikorrupsion, në 6 bashki dhe është në proces për 14 bashki me fillimin e mbështetjes nga partneri i AMVV, për këtë angazhim.

Për këtë periudhë, nga informacioni i raportuar dhe analizuar (mbështetur në masat dhe aktivitetet për zbatim) për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi rezulton të jetë arritur vlera 40%, pasi nga 10 bashki që duhet të alokonin 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit, aktualisht 4 bashki e kanë realizuar këtë target.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	N/A
	2020	6 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	10 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 40%
	2022	40 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	61 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Institucionet e qeverisjes vendore nuk alokojnë fonde për zbatimin e planit të integritetit	
Vlera e synuar 2018	-	-
Vlera e synuar 2019	-	-
Vlera e synuar 2020	6 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit	Nuk ka të dhëna
Vlera e synuar 2020	10 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit	Treguesi është arritur në masën 40%

#### **Niveli i realizimit të objektivit A.11.**

Niveli i realizimit të *Objektivit A.11. Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **25%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR A. 11 = \frac{TP A11.a (10\%)+ TP A.11.b (40\%)}{2 TP} \times 100\% = 25\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.11 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0-30 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në Ministrinë e Brendshme për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar-dhjetor 2021.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.11

Risku i realizimit të këtij objektivit është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin si dhe me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ. Pra ka mundësi të lartë risku dhe ndikim të mesëm të tij.

### *Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit (Qasja A)*

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 11 objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të treguesve të performancës dhe pjestuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është 94.01%<sup>29</sup>.

Objektivi	Realizueshmëria
A.1. Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	115%
A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	100%

<sup>29</sup> Ibid footnote 5.

A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	180%
A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	100%
A.5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	75%
A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	80%
A.7. Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	59.2% <sup>30</sup>
A.8. Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	100%
A.9. Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	100%
A.10. Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	100%
A.11. Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	25%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit, e cila është në masën 94.01% tregon për një rezultat të mirë përgjatë vitit 2021. Kjo vlerë përbën gjithashtu edhe arritjen më të lartë krahasimisht me atë të qasjes ndëshkuese B dhe qasjes ndërgjegjësuere C. Megjithatë vihet se re se kjo vlerë është arritur si pasojë e tejkalimit të madh (të shprehur në %) për objektivin A.1 e A.3, e për pasojë nuk duhet të qendrojë jashtë vëmendjes niveli i ulët ose i mesëm i realizimit në disa objektiva të rëndësishëm si: Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore; Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave apo përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut. Për këtë shkak është i nevojshëm që gjatë vitit të ri të vijim të priorizohen përpjekjet e institucioneve përgjegjëse, sidomos në ato tregues performance që kanë patur një realizim të dobët, të cilat kanë ndikuar në mënyrë direkte në realizueshmërinë jo të mirë të të gjithë objektivit. Sjellim këtu si shembull treguesin e performancës A.6.a, A.11.a dhe A.11.b.

### ***Qasja Ndëshkuese - Përmbledhje për arritjet në ndëshkimin e korrupsionit***

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndëshkuese SNKK** ka për qëllim që institucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore.

<sup>30</sup> Ibid footnote 5.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara <sup>31</sup>	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b> <sup>32</sup>
Ndëshkuese	Masa	22	11	7	4
	Aktivitete	31	18	6	7

Rezulton se nga 22 masa e 31 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-dhjetor 2021, për Qasjen B (Ndëshkuese), janë zbatuar 11 masa/17 aktivitete prej tyre, 7 masa/6 aktivitete janë ende në proces zbatimi dhe 4 masa/8 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa B.1.2; B.1.3; B.1.4; B.2.4, dhe aktivitete B.1.2.1; B.1.2.2; B.1.4.1; B.1.6.1; B.2.3.1, B.2.4.1 dhe B.2.4.2).

Nga 9 treguesit e performances për qasjen parandaluese (B), është arritur vlera e synuar për 1 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 2 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 6 tregues performance.

Qasja Ndëshkuese	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht <sup>33</sup>	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht <sup>34</sup>	Vlera e synuar nuk është e realizuar <sup>35</sup>
	9	2	1	6


<sup>31</sup> Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>32</sup> Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

<sup>33</sup> Që është realizuar në shkallën 100 për qind

<sup>34</sup> Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>35</sup> Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna



**B.1 Përmirësimi i efijcencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit.**

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*B.1.a: Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)*

*B.1.b: Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit*

*B.1.c: Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit*

Plani i veprimit për Objektivin B.1 parashikon 20 Aktivitete dhe 13 Masa.

B. 1.1	Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, këtyre të fundit dhe gjyqësorit
B.1.1.1	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) PP, Prokurori e Posaçme, Komisioni i Policisë Gjyqësore
B.1.1.2	Kryerja e trajnimit/Nr. i personave të trajnuar; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.2	Monitorimi dhe raportimi i të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet
B.1.2.1	Formati i raportimit statistikor dhe procesi i mbledhjes së të dhënave i krijuar
B.1.2.2	Raportimi periodik i kryer
B. 1.3	Forcimi i kapaciteteve në logjistikë dhe burime njerëzore i strukturave të hetimit të korrupsionit dhe krimi ekonomik
B.1.3.1	Numri i stafit të rekrutuar, pajisur me mjetet/kushtet e nevojshme të punës dhe trajnuar

B. 1.4	Rritja e përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në procedimet për vepra penale në fushën e korrupsionit për rezultate më efektive në luftën kundër tij
B.1.4.1	Nr. i rasteve të aplikimit të neneve 221, 294/a, 294/b të K.Pr.P.
B. 1.6	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit
B.1.6.2	Kryerja e trajnimit/grupet e trajnimit (25 persona/grup) - total nr. i personave të trajnuar, 126 persona/vit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 1.7	Kryerja e trajnimeve për rritjen e nivelit profesional të efektivëve të angazhuar për të dokumentuar veprat penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimeve në detyrë (PSH/OPGJ në strukturën kundër korrupsionit)
B.1.7.1	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim dhe hartimi i programit trajnimit
B.1.7.2	Kryerja e trajnimit; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 1.9	Mekanizma specifike për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e asetëve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni
B.1.9.1.	Ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore
B.1.9.2	Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.34/2019 (janar-dhjetor 2020)
B.1.9.3	Krijimi i regjistrit elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë të kenë akses në të Portali i AAPSK/e-shërbime
B. 1.10	Rritja e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare
B.1.10.1	Module trajnimi të hartuara (I) Seanca trajnimi të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.11	Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të AAPSK në fushën e administrimit të shoqërive të sekuestruara dhe të konfiskuara
B.1.11.1	Trajnime të kryera për stafin (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)
B. 1.12	Rritja e kapacitetit hetimor nëpërmjet forcimit të strukturës së hetimit dhe shfrytëzimit të instrumentave ligjorë që shërbëjnë për përmbushjen e veprimtarisë si në aspektin procedural penal dhe të veprimtarisë inteligjente
B.1.12.1	Nr. i rasteve zbuluara të dyshuara për kryerje apo implikim në veprimtari të kundërligjshme të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA (I) Nr. referimesh (II) Nr. punonjësish të proceduar (III) Nr. punonjësish të arrestuar/ndaluar si dhe nr. operacionesh të kryera (IV)
B. 1.13	Rritja e numrit dhe cilësisë së hetimeve proaktive, për punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA
B.1.13.1	Numri i hetimeve proaktive të finalizuara me dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë së kundërligjshme të kryer nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit, për këtë objektiv nuk janë qartësisht të ndara sipas tre treguesve të objektivit. Për këtë arsye zbatimi i aktiviteteve dhe realizimi masave është analizuar në mënyrë të agreguar për të tre treguesit, ndërsa vlerësimi për secilin tregues është kryer sipas vlerës së synuar për 2021.

### **B.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.a** për vitin 2021 është: *rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës.*

Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po *rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion, krahasuar me vitin paraardhës.*

Gjatë vitit 2020 vlera e synuar ishte *rritja me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës.* E përkthyer në shifra, duke u nisur nga vlera bazë e vitit 2017 (kur ishin dërguara në gjykatë 813 raste dhe akuzuar 974 individë), për vitin 2020 vlera e arritur ishte 360 procedime të dërguar në gjykatë dhe 533 të pandehur të dërguar në gjykatë. Rritja me 5% nuk është realizuar, pra vlera e synuar e treguesit nuk është arritur.

Për janar - dhjetor 2021, në SPAK numri i procedimeve të hetuara gjithsej është 255 procedime me 129 persona në hetim. Janë bashkuar 11 procedime dhe pas këtij procesi rezulton të jenë hetuar gjithsej 244 procedime me 129 persona në hetim.

Përsa i përket numrit të procedimeve të regjistruara për herë të parë në vitin 2021, këto janë 123 procedime me 56 persona në hetim.

Ndërkohë, gjatë vitit 2021 rezulton se janë përfunduar gjithsej 90 procedime penale me 80 persona dhe konkretisht janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 25 procedime penale me 53 të pandehur. Janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim 21 procedime penale me 8 persona në hetim. Janë transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 35 procedime penale me 19 persona në hetim. Janë pezulluar 9 procedime penal dhe mbeten ende në hetim 153 procedime penale me 48 persona në hetim.

Prokurorët pranë SPAK i janë nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas tematikave të përcaktuara nga to në perputhje me aktivitetin e SPAK; prokurorët janë trajnuar tipas tematikave specifike edhe nga organizatat e huaja si EURALIUS dhe OPDAT.

Në organikën e Prokurorisë së Posaçme për vitin 2021 janë parashikuar 84 punonjës, 81 prej tyre janë të rekrutuar. Nga këta 20 pozicione janë parashikuar për prokurorë dhe deri në fund të dhjetor 2021 janë emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë 15 prokurorë. Stafit administrati pranë SPAK, ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga DSIK dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

SHÇBA raporton se gjatë vitit 2021, janë referuar pranë organit të Prokurorisë 224 referime penale për 329 subjekte, të cilat sipas nivelit të drejtimit, ndahen në: 88 punonjës policie i nivelit të parë drejtues, 223 punonjës policie të nivelit zbatues, 10 punonjës civil (administrativ), 3 efektivë të



Gardës, 5 PMNZSH dhe 61 shtetas. Buxheti i shpenzuar për aktivitetet e në funksion të kësaj mase është në masën 100 % ose 232,431 lekë.

Lidhur me numrin e hetimeve proaktive të finalizuara me dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA, rezulton se strukturat e Hetimit të Shërbimit në nivel vendor apo qendror në interes të dokumentit të ngjarjeve që kanë ndodhur si në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, PMNZSH-në, etj. kanë realizuar dhe veprime me iniciativë, ku kanë kryer arrestime/ndalime në flagrancë për 30 punonjës të strukturave dhe 32 shtetas. Në këto veprime në asnjë rast nuk është evidentuar paligjshmëri gjatë vleftësime të masave të sigurimit nga prokuroria dhe gjykatat.

Gjithashtu në kuadër të hetimeve proaktive të ndjekura nga strukturat e hetimit të ShÇBA, nën drejtimin e prokurorit, janë zbatuar vendime të gjykatave për masat e sigurimit personal për 100 persona nga të cilët 69 subjekte të shërbimit dhe 31 shtetas. Sipas masave të sigurimit personal të caktuara, evidentojmë këtë ndarje:

1. Masa e sigurimit personal “arrest në burg” caktuar për 53 persona nga të cilët: 9 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 17 punonjës policie të nivelit zbatues dhe 27 shtetas.
2. Masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” caktuar për 3 persona nga të cilët: 1 punonjës policie i nivelit të parë drejtues dhe 2 punonjës policie të nivelit zbatues.
3. Masa e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” caktuar për 17 persona nga të cilët 2 punonjës policie i nivelit të parë drejtues, 11 punonjës policie të nivelit zbatues dhe 4 shtetas.
4. Masa e sigurimit personal “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, caktuar për 27 persona, nga të cilët 10 punonjës policie të nivelit të parë drejtues dhe 17 punonjës policie të nivelit zbatues.

Policia e Shtetit raporton se gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 22 trajnime me 220 përfitues nga të cilët 45 janë femra, me këto tema: -“Pastrimi i Parave dhe Hetimi Financiar e Pasuror”, zhvilluar online nga Projekti PAMECA V dhe Prokuroria e Përgjithshme, me 23 përfitues meshkuj; -“Veprat penale që lidhen me detyrën”. Zhvilluar online nga Projekti PAMECA V dhe Prokuroria e Përgjithshme, me 23 përfitues meshkuj; -“Përdorimi i programit “i2 Analyst's Notebook”, zhvilluar në ambientet e Labratorit të Teknologjisë dhe Informacionit nga Projekti PAMECA V me 7 përfitues meshkuj; -Hetimi pasuror sipas Ligjit nr. 10192, datë, 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, zhvilluar në Ambientet e Drejtorisë Hetimore Qendrore, Tiranë

nga Drejtoria Hetimore Qendrore, në Departamentin e Policisë Kriminale, me 22 përfitues meshkuj; -“Trajnim i avancuar i hetimit financiar”, zhvilluar në Hotel “Rogner” Tiranë nga GIZ me mbështetjen e kompanisë angleze OPTIMA, me 4 përfitues meshkuj; -“Praktikat më të mira të hetimit financiar dhe menaxhimit të hetimeve paralele. Zhvillimi profesional i stafit në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike e financiare”, zhvilluar online nga Ambasada Britanike nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, me 26 përfitues meshkuj; -“Efektiviteti i hetimeve dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave”, zhvilluar Online nga Këshilli i Europës, me 2 përfitues meshkuj; -“Lufta kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik”, zhvilluar online nga Shkolla Ndërkombëtare e Forumit të Lartë për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar », Cazerta, me 1 përfitues mashkull; - Kursi “OSINT për Njësitë e Hetimit Financiar” Organizuar nga platforma Zoom nga Sekretariati i OSBE-se/Departamenti për Kërcënimet Transnacionale, në Vjene”, me 6 përfitues meshkuj; -“Principet ndërkombëtare për riciklimin dhe financimin e terrorizmit”, zhvilluar online nga Shkolla e Policisë Ekonomike Financiare (Guadia di Finanza) Romë, Itali, me 2 përfitues meshkuj; -“Hetimi pasuror, gjurmimi i pasurive në bashkëpunim me institucione të tjera për evidentimin e pasurive”, me 20 përfitues nga të cilët, 7 femra; -“Përcaktimi i rezultateve të garave sportive. Korrupsioni pasiv i funksionarëve të shtetit, hetimi proaktiv i veprës penale të fshehjes së pasurisë dhe financimi i terrorizmit”, me 20 përfitues, nga të cilat 1 femër; -“Hetimi financiar kombëtar në hetimet ndërkombëtare. Hetimi i krimeve kompjuterike. Gjurmimi i aseteve kriminale dhe sekuestrimi i tyre”, me 20 përfitues nga të cilët 3 Femra; - “Qarkullimi i parave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, evazioni fiskal dhe krimi kibernetik”, me 18 pjesmarrës/përfitues, nga të cilët 3 femra; “Principet ndërkombëtare për riciklimin dhe financimin e terrorizmit”, me 2 përfitues nga të cilët 1 femër; -“Metodat ekonomike e financiare për luftën kundër pasurive të organizatave kriminale”, me 2 përfitues, nga të cilët 1 femër; - “Hetimi financiar kombëtar në hetimet ndërkombëtare. Hetimi i krimeve kompjuterike, gjurmimi i aseteve kriminale dhe sekuestrimi i tyre”, me 15 përfitues, nga të cilët 3 femra; Seminar me temë “Krimet financiare, informacioni kriminal dhe hetimet” me 1 përfitues/pjesmarrës femër; - Takimi rajonal për COE në Bukuresht – “Zhvillimi i udhëzuesit për kapjen e kriptomonedhave dhe ushtrime praktike për sekuestrimin e aktiviteteve virtuale”, me 3 pjesmarrës/përfitues, që të 3 meshkuj; - Seminar “Trajnimi mbi analizën dhe klasifikimin e monedhave Euro”, me përfitues 8 persona, nga të cilët 3 Femra, 21- Kurs trajnimi – “Praktika e investigimeve financiare”, zhvilluar në Kroaci, me 4 përfitues nga të cilët 4 meshkuj; - Kurs trajnimi me temë: “Praktika e investigimit të korrupsionit në institucionet publike”, zhvilluar në Kroaci, me pjesmarrjen e 4 përfituesve, nga të cilët 1 femër.

Në funksion të masës B.1.7, që lidhet me kryerjen e trajnimeve për rritjen e nivelit profesional të efektivëve të angazhuar për të dokumentuar veprat penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimeve në detyrë (PSH/OPGJ në strukturën kundër korrupsionit), janë kryer 7 trajnime, me temë: “Hetimi pasuror sipas ligjit Nr.10192”, me 22 përfitues; “Veprat penale që lidhen me detyrën” me 23 përfitues; “Hetimi pasuror, gjurmimi i pasurive në bashkëpunim me institucione të tjera për evidentimin e pasurive”.Me 20 përfitues, nga të cilat 7 femra; “Përcaktimi i rezultateve të garave

sportive. Korrupsioni pasiv i funksionareve te shtetit, hetimi proaktiv i vepres penale te fshehjes se pasurisë dhe financimi i terrorizmit”, me 20 përfitues nga të cilat 1 femer; “Hetimi financiar kombëtar ne hetimet nderkombetare.Hetimi i krimeve kopmpjuterike.Gjurmimi i aseteve kriminale dhe sekuestrimi i tyre” Me 20 përfitues nga te cilat 3 Femra; Hetimi financiar kombëtar ne hetimet nderkombetare.Hetimi i krimeve kopmpjuterike.Gjurmimi i aseteve kriminale dhe sekuestrimi i tyre” Me 15 përfitues nga te cilat 3 Femra; Metodatat ekonomike e financiare për luftën kundër pasurive të organizatave kriminale, 2 përfitues, nga të cilët 1 femër.

Regjistrimi online i pasurive të dhëna me qira dhe pasurive në proces administrimi, AAPSK raporton ekzistencën e një regjistri, i cili po përditësohet gjatë aktivitetit të këtij institucioni në mënyrë periodike, por i duhet dhënë akses i aksesit edhe institucioneve të tjera në këtë regjistrë. Mbi rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare, AAPSK raporton se gjatë vitit 2021, janë kryer 5 module trajnimi me 10 seanca në total, ku janë trajnuar 10 femra dhe 12 meshkuj. Për këto aktivitete nuk është përdorur buxhet, pasi kostot janë mbuluar nga donatorët, GIZ Albania, Këshilli i Europës dhe OSCE.

Sa i takon rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të AAPSK në fushën e administrimit të shoqërive të sekuestruara dhe të konfiskuara, janë kryer dy trajnime në total gjatë vitit 2021, në të cilat janë trajnuar 5 femra dhe 6 meshkuj. Edhe për këto aktivitete nuk është përdorur buxhet nga institucioni, pasi kostot financiare janë mbuluar nga ASHK dhe BAMIN.

Sa i takon vlerës së synuar për vitin 2021, nga të dhënat e raportuara nga SPAK, gjithsej janë 244 procedime për korrupsion me 129 persona në hetim. Rritja me 5% e numrit të kallëzimeve për korrupsion, krahasuar me vitin paraardhës nuk është arritur, kështu që vlera e treguesit nuk është realizuar.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	Raste të dërguara në gjykatë: 813 Individët e akuzuar: 974 dhe 0,24 % e rasteve 0,62% e të akuzuarve
	2018	N/A
	2019	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë
	2020	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë 84(treguesi është arritur në masën 0%)


<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	0%
	2022	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë.

Për nëntreguesin “B.1.a.1: Raporti i procedimeve për “korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion”, rezulton se SPAK ka dërguar për gjykim 5 raste që lidhen me korrupsionin e kryer nga funksionarë të nivelit të lartë (ish funksionarë të sistemit gjyqësor dhe të zgjedhur në pushtetin vendor), dhe ky nëntregues nuk është arritur.

Realizueshmëria e këtij treguesi në 3 vitet e matura paraqitet në grafikun më poshtë.



Nëntreguesi “B.1.a.1: Raporti i procedimeve për “korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion:



### B.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.b** për vitin 2021 është: **rritja me 5% e numrit të kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin, krahasuar me vitin paraardhës.**

Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 5% e numrit të kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin, krahasuar me vitin paraardhës.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte publikimi i të dhënave mbi rastet e kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin pas krijimit të mekanizmit për prodhimin në mënyrë të ndarë të këtyre të dhënave, kjo vlerë nuk është arritur.

Ky tregues ka në përbërje dhe nëntreguesin rritje e raportit të kërkesave për sekuestrim në rastet e “korrupsionit në nivel të lartë” mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit. Vlera e synuar për këtë nëntregues për vitin 2021 është 5% rritje krahasuar me vitin paraardhës. Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Për janar – dhjetor 2021, masa për monitorimin dhe raportimin e të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet vijnë nga Raporti Vjetor i SPAK.

Janë krijuar seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave dhe krimin ekonomik në 7 prokurori të juridiksionit të përgjithshëm me përbërje drejtues seksioni dhe prokurorë dhe në 15 prokuroritë e tjera u caktua një prokuror për ndjekjen e këtyre çështjeve. Janë gjithsej, 41 prokurorë

të ngarkuar me ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe krimit ekonomik. Gjatë vitit 2021 janë regjistruar 46 procedime dërguar në gjykatë me 29 persona të pandehur.

Në zbatim të masës rritje e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare janë kryer 4 module trajnimi, 9 seanca në total dhe janë trajnuar 9 femra dhe 10 meshkuj.

Për janar – dhjetor 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vepruar në 3 drejtime kryesore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale:

Në zbatim të ligjit 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, janë paraqitur 14 kërkesa për sekuestrimin e pasurive. Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, “Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike”, janë paraqitur në gjykatë 25 kërkesa për sekuestrim pasurie. Në zbatim të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë kërkuar në 4 raste sekuestrim në proces penal dhe në 1 rast, sekuestrimi është vendosur nga vetë prokurorët e posaçëm. Kështu, në total për vitin 2021 janë regjistruar 44 kërkesa për sekuestrim<sup>36</sup>, çka përbën një rritje në krahasim me numrin e kërkesave krahasuar me vitin paraardhës 2020. Të dhënat statistikore të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë, pas takimit të Komitetit Koordinator, zhvilluar në datën 13 prill 2022, me qëllim reflektimin e tyre në treguesit e performancës dhe përditësimin e statistikave në funksion të raportit vjetor të monitorimit.

Në vijim treguesi i performancës B.1.b, përbëhet edhe nga nëntreguesi *B.1.b.1: Raporti i kërkesave për sekuestrim në rastet e “korrupsionit në nivel të lartë” mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit*. Nga të dhënat e raportuara nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk rezulton një numër kërkesash për sekuestrim për rastet e “korrupsionit në nivel të lartë” dhe një numër total i kërkesave për sekuestrim vetëm për rastet e korrupsionit. Në këto kushte, nëntreguesi i performancës B.1.b.1, nuk mund të matet në funksion të arritjes së një konkluzioni përfundimtar si raport mes dy vlerave.

Duke mbajtur parasysh se vlera e treguesit të performancës B.1.b është 100%, ndërsa vlera e nëntreguesit B.1.b.1 është 0%, targeti i arritur për këtë tregues është 50%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A


<sup>36</sup> Për vepra penale të lidhura me korrupsionin dhe jo vetëm, duke përfshirë edhe vepra të tjera penale për të cilat është kompetente Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

	2019	Sistemi i raportimit do të jetë funksional dhe të dhënat do të raportohen. Në vitin 2019 do të arrihet rritja e kërkesave për sekuestrim me 5 % krahasuar me vitin 2018; do të sigurohet raportim periodik gjatë viteve në vijim.
	2020	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	50%
	2022	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit.

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesë të dhëna për kërkesat për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit	
Vlera e synuar 2018	Ndërtimi i mekanizmit raportues (dhe përditësimi i statistikave të harmonizuara) me qëllim përfshirjen e të dhënave të reja	Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 6/2018 miratoi formatin statistikor për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në lidhje me konfiskimet.
Vlera e synuar 2019	Të dhëna të publikuara në raporte 2 vjeçare	Sistemi i raportimit u bë funksional dhe të dhënat raportuan në statistikat 6 mujore dhe vjetore. Asnjë kërkesë për sekuestrim të pasurive në rastet e korrupsionit nuk u paraqit në vitin 2019.

Vlera e synuar 2020	5% rritje krahasuar me bazën e 2019	Asnjë kërkesë për sekuestrim të pasurive në rastet e korrupsionit nuk u paraqit në vitin 2020
Vlera e synuar 2021	Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit	-



### B.1.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.c** për vitin 2021 është: **rritja me 5% e vlerës së aseteve të sekuestruara (për të cilat krimi fillestar është korrupsioni), krahasuar me bazën e vitit 2020.**

Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 5% e vlerës së aseteve të sekuestruara për rastet e korrupsionit, krahasuar me vitin paraardhës.

Gjithashtu vlera të synuara parashikohen: krijimi i regjistrit elektronik për mbajtjen dhe raportimin e pasurive të sekuestruara gjatë vitit 2021; menaxhimi i pasurive të sekuestruara përmes sistemit elektronik gjatë vitit 2022; dhe kryerja e vlerësimit të nevojave për përmirësimin e sistemit gjatë vitit 2023.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Kjo vlerë nuk u arrit.



Për këtë periudhë raportimi, *janar – dhjetor 2021*, në zbatim të aktivitetit për regjistrin online të pasurive të dhëna me qira dhe pasurive në proces administrimi, regjistri është në proces përditësimi nga AAPSK.

Në zbatim të masës për rritjen e kapacitetit hetimor të institucioneve ligjzbatuese, SHÇBA raporton se gjatë vitit 2021, janë referuar pranë organit të Prokurorisë 224 referime penale për 329 subjekte, të cilat sipas nivelit të drejtimit, ndahen në: 88 punonjës policie i nivelit të parë drejtues, 223 punonjës policie të nivelit zbatues, 10 punonjës civil (administrativ), 3 efektivë të Gardës, 5 PMNZSH dhe 61 shtetas.

Lidhur me numrin e hetimeve proaktive të finalizuara me dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së SHÇBA, rezultojnë se strukturat e Hetimit të Shërbimit në nivel vendor apo qendror në interes të dokumentit të ngjarjeve që kanë ndodhur si në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, PMNZSH-në, etj kanë realizuar dhe veprime me iniciativë, ku kanë kryer arrestime/ndalime në flagrancë për 30 punonjës të strukturave dhe 32 shtetas. Në këto veprime në asnjë rast nuk është evidentuar paligjshmëri gjatë vlerësimit të masave të sigurimit nga prokuroria dhe gjykatat.

Për këtë periudhë raportimi është ndërtuar regjistri elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara. Regjistri është funksional në 90 % dhe institucionet janë në fazën e aksesimit të tij. Realizimi i këtij treguesi lidhet me procese dhe rezultate të pritshme në rritje në lidhje me sekuestrim të pasurive për raste të korrupsionit. AAPSK, gjatë vitit 2021, ka administruar pasuri të sekuestruara nga veprat penale të korrupsionit, në vlerat 2,577,828,976.00 lekë. Krahasuar me vlerën bazë të 2020 ky tregues performance është arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Sistemi i raportimit do të jetë funksional dhe të dhënat do të raportohen si dhe do të vëzhgohen dhe analizohen të gjitha kontratat e mëparshme të pasurisë si dhe analiza e çdo lloj kontakti të pasurisë me personat e tretë; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm.
	2020	Është parashikuar ngritja e grupit të punës për ndërtimin e akteve nënligjore në referencë të ligjit nr. 34 datë 17.06.2019; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm

		(treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Është parashikuar të krijohet regjistri elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë në qasjen e informacionit të tij; 5% rritje e asteteve të sekuestruara krahasuar me vitin e mëparshëm.
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	100%
	2022	Është parashikuar fuqizimi dhe vijimi i përdorimit të mjeteve elektronike që mundësojnë transparencë në administratën shtetërore, në sistemet e drejtësisë, në menaxhimin e integruar të informacionit të pasurive në administrim; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Vlerësim i nevojave për përmirësim të masave kundër korrupsionit; 5%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Mungesë të dhëna për vlerën aseteve të sekuestruara në rastet e korrupsionit	
Vlera e synuar 2018	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të AAPSK për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e vlerave të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të brendshëm të AAPSK nuk u realizua.
Vlera e synuar 2019	Të dhëna të publikuara në raporte gjashtë mujore të AAPSK (të dhënat përmbajnë vlera mbi të ardhurave të sekuestruara në rastet e korrupsionit)	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit u realizua. Të dhënat u publikuan në raporte gjashtë mujore të AAPSK.

		Të dhënat nuk përmbajnë vlera mbi të ardhurave të sekuestruara në rastet e korrupsionit
Vlera e synuar 2020	5% rritje krahasuar me bazën e 2019	Gjatë vitit 2020 nuk ka patur asete të sekuestruara për krime të lidhura me korrupsionin
Vlera e synuar 2021	Është parashikuar të krijohet regjistri elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë në qasjen e informacionit të tij; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	Gjatë 2021 është ndërtuar regjistri elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

### Niveli i realizimit të objektivit B.1

Niveli i realizimit të *Objektivit B.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **0%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR B. 1 = \frac{TP B.1.a (0\%) + TP B.1.b (50\%) + TP B.1.c (100\%)}{3 TP} \times 100\% = 50\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.1 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31 deri në 50 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për monitorimin e e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

### Risqet për realizimin e Objektivit B.1

Risku i realizimit të këtij objekti është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi si dhe me çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ, ky risk ka një mundësi të lartë të ndodhjes dhe ndikim të mesëm të tij.

## ***B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit.***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*B.2.a: Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara*

*B.2.b: Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë*

Plani i veprimit për Objektivin B.2 parashikon 15 Aktivitete dhe 8 Masa.

### **B.2.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.2.a** për vitin 2021 është **rritja me 3% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara në krahasuar me vitin paraardhës**. Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po rritja me 3% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara, në krahasuar me vitin paraardhës.

Për vitin 2020 raporti i numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara ishte 46%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (14) dhe masat (7) si më poshtë.

B. 2.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit/rishikimi i marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucioneve të ngarkuara në luftën kundër korrupsionit
B.2.1.1	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara/ rishikuara (masë e raportueshme në TM IV të çdo viti)
B. 2.2	Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve
B. 2.2.1	Numri i databazave të aksesuara
B. 2.3	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional të punës ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese (dogana, tatime, policia ushtarake, etj) me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.3.1	Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës
B.2.3.2	Hartimi i plani punës/plani veprimi me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.3.3	Udhëzime dhe procedura standarde të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese
B.2.3.4	Adresimi i mbivendosjeve dhe / ose boshllëqeve në mandatet institucionale, hetimet e dyfishta ose të njëkohshëm, etj

B. 2.4	Hartimi i procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK me fokus hetimin e korrupsionit
B.2.4.1	Ngritja e grupit të punës
B.2.4.2	Hartimi i draftit të procedurave të bashkëpunimit dhe miratimi i tyre
B. 2.5	Forcimi bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës
B.2.5.1	Hartimi i një kalendari takimesh pune dhe takime të kryera
B. 2.6	Organizimi i seminareve/ëorkshope të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese
B.2.6.1	Analiza shkencore (I) Informacioni dhe përpunimi i të dhënave (II) Tematika specifike të trajtuara (III) Kurrikula/materialet e trajnimit të hartuara

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që janë kryer gjatë vitit 2021.

Për *janar-dhjetor 2021*, është raportuar nga institucionet përgjegjëse realizimi i masës forcimi i bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës është raportuar zbatimi i saj përmes realizimit të 253 takime dhe analizave të përbashkëta me Prokurorinë dhe agjenci të tjera ligjzbatuese. Në shkurt të 2021 është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektiveve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Hartimi i planit të punës/plani veprimi me fokus hetimin e korrupsionit është zbatuar pjesërisht dhe është programuar në Programin Vjetor të Punës për Departamentin e Policisë Kriminale për vitin 2021 Nr.182 Prot. data 15.02.2021 miratur nga DPPSH.

Sa i takon udhëzimeve dhe procedurave standarde të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese është zbatuar pjesërisht, pasi institucionet përgjegjëse janë në proces hartimi të këtyre akteve.

Sa i takon adresimit të mbivendosjeve dhe/ose boshllëqeve në mandatet institucionale, hetimet e dyfishta ose të njëkohshëm, institucioni përgjegjës nuk ka raportuar.

Lidhur me masën që përcakton forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional të punës ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese (dogana, tatime, policia ushtarake, etj) me fokus hetimin e korrupsionit, nuk janë ngritur grupe të përbashkëta pune. Megjithatë është programuar Programi Vjetor i Punës për Departamentin e Policisë Kriminale për vitin 2021, me Nr.182 Prot., datë 15.02.2021, miratur nga DPPSH. Është inicuar hartimi i procedurave të hetimit të krimit ekonomik e finciar në kuadrin e projektit IPA, gjithashtu është inicuar rishikimi dhe hartimi i procedurave dhe standarteve për oficerët e policisë gjyqësore në polici për hetimin e veprave penale në fushën

e korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Në kuadër të adresimit të mbivendosjeve, konstatohet se nuk ka pasur raste hetimesh për korrupsion të mbivendosura. Policia e Shtetit mundësinë e mbivendosjes së çështjeve e ka eliminuar nëpërmjet vënies në përdorim të Sistemit të menaxhimit të çështjes. Çdo referim penal hidhet në këtë sistem dhe çdo çështje merr numër unik të posaçëm.

Sa i takon masës B.2.4, lidhur me hartimin e procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK me fokus hetimin e korrupsionit masa vijon të raportohet në proces.

Masa B.2.5 lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës, Policia e Shtetit shpjegon se për çdo hetim për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve në detyrë janë zhvilluar analiza të përbashkëta me SPAK dhe prokuroritë e rretheve. Analizat janë bërë në nivel qendror dhe vendor, sipas rasteve. Janë zhvilluar takime të përbashkëta me strukturat e hetimit tatimor dhe SHISH.

Gjatë vitit 2021, Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar ka aplikuar kalendar takimesh me prokuroritë e rretheve/vendore për veprat penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave, në bashkëpunim me drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore dhe DPPP.

Masa B.2.6 lidhur me organizimin e seminareve/ëorkshope të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese është zbatuar, pasi Drejtoria për Krimet Ekonomike e Financiare ka organizuar 2 seminare/ëorkshpe të përbashkëta me 5 përfitues nga policia dhe 3 aktivitete trajnim me pjesëmarrje aktive:

- Seminar "Mbi webinarin prezantues për sistemin "ProfID" - organizuar online nga PCC SEE dhe Policia Kombëtare e Francës, me 3 përfitues.
- "Konferencën ndërkombëtare për pronësinë përfituese Organizuar online nga Këshilli i Europës", me 2 përfitues.
- Takimi rajonal për COE në Bukuresht "Zhvillimi i udhëzuesit për kapjen e kriptomonedhave dhe ushtrime praktike për sekuestrimin e akktivitetëve virtuale", me 3 pjesëmarrës/përfitues që të 3 meshkuj.
- Kurs trajnimi – "Praktika e investigimeve financiare", zhvilluar në Kroaci, me 4 përfitues nga të cilët 4 meshkuj.
- Kurs trajnimi me temë: "Praktika e investigimit të korrupsionit në institucionet publike", zhvilluar në Kroaci, me pjesëmarrjen e 4 përfituesve, nga të cilët 1 femër.


Për realizimin e masave të këtij treguesi nuk janë parashikuar kosto shtesë.

Realizimi i këtij treguesi lidhet me procese dhe rezultate të pritshme në rritje në lidhje me numrin procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara. Për këtë periudhë nuk janë raportuar ende të dhëna ndaj edhe treguesi nuk rezulton të jetë arritur. Ky raport mbetet kritik për efektivitetin e hetimeve penale mbi korrupsionin dhe duhen ndërmarrë hapa për ta adresuar.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	64%
	2020	Rritje me 3 % (treguesi është arritur në masën 100%)
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	Rritje me 3 %
	2021 (targeti i arritur)	0%
	2022	Rritje me 3 %
Vlera e synuar/Targeti	2023	Rritje me 3 %

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### B.2.b

Vlera e synuar për treguesin e performancës B.2.b për vitin 2021 është: **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 18 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 7 baza të dhënash shtesë**. Për vitin 2022 vlera e synuar është **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 20 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 9 baza të dhënash shtesë**. Për vitin 2023 vlera e synuar është **realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 22 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 11 baza të dhënash shtesë**.

Gjatë vitit 2020 vlera e synuar ishte realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 16 baza të dhënash në total dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 5 baza të dhënash shtesë. Për këtë periudhë raportimi. Prokuroria shtoi aksesin në 1 bazë të dhënash dhe gjithashtu Policia e Shtetit aksesoi vetëm 1 databazë, duke çuar në total numrin e databazave të aksesuara për vitin 2020, në 11. Megjithatë objektivi për vitin 2020 nuk u arrit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë:

B. 2.2	Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve
B.2.2.1	Numri i databazave të aksesuara

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që kryhen duke filluar që duke filluar që nga fillimi i vitit 2021 e në vijim.

Për *janar - dhjetor 2021*, Policia e Shtetit, ka marrë akses në 9 databaza të tjera të dhënash, konkretisht: Regjistri i Gjendjes Civile; Regjistri i lejeve të drejtimit; Regjistri i Institutit të Sigurimeve Shoqërore; Regjistri i QKB; Regjistri i automjeteve; Sistemi TIMS; Regjistri mbi Aplikimet në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve; Regjistri i Aplikimeve të bëra në Zyrën e Punësimit dhe Regjistri i të Dhënave Spitalore. Policia e Shtetit ka akses në 21 databaza të dhënash gjithësej, duke kaluar kështu objektivin me 18 databaza, të përcaktuar si target për vitin 2021.

Për strukturat e hetimit në Policinë e Shtetit është krijuar një bazë të dhënash e integruar e quajtur “DEEPSEE”, në të cilën janë integruar 44 baza të dhënash dhe është siguruar akses. Përveç këtyre bazave të të dhënave, strukturave të hetimit iu është siguruar akses edhe në Sistemin multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pasuritë e paluajtshme. Hipoteka ose Sistemi multifunksional i ASHK, përfshin bazën e të dhënave të digjitalizuara të Kadastrës, ku është përfshirë edhe regjistri i ALUIZNI-t, për ndërtimet (pasuritë e paluajtshme) në proces legalizimi.

Policia e Shtetit përgjatë vitit 2021, ka marrë akses nga institucionet e tjera dhe konsultohet elektornikisht edhe në Regjistrin kombëtar të llogarive bankare dhe Regjistri mbi Trafikun Detar.

Gjithashtu është krijuar së fundmi në QKB edhe Regjistri i Pronarëve Përfitues, në zbatim të ligjit Ligjit nr. 112/2020 ‘Për regjistrin e pronarëve përfitues’, ku Policia e Shtetit ka marrë të drejtën e aksesit dhe është në proces implemtimi.

Sistemet e të dhënave ku i është dhënë akses Policisë së Shtetit gjatë vitit 2021 janë: Leje Qendrimi; Uniforma ime; OFL; Poliscan LMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik mbi Ekzaminimet Balistike të Policisë Shkencore; SMARTDEC, Kamerat e Kufirit të Gjelbër; Kamera ANPR me Kosovën;



Policia e Shtetit ka nevojë për akses edhe në regjistrat e tjerë, për të cilat nevojiten rregullime ligjore si Regjistri i Abonentëve telefonikë fiks dhe mobile; Regjistrat e RTV, RAD, të DPPP; Regjistrat e personave të dënuar dhe Regjistrin e Posaçëm për çdo njoftim apo referim të veprave penale në fushën zgjedhor.

Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme raporton se gjatë *janar - dhjetor 2021* ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave menaxhimi i informacionit të sistemit penitenciar”. Kjo databazë është e aksesueshme tashmë nga prokurorët dhe OPGJ. I është dërguar kërkesë DPT për akses në regjistrin qendror të llogarive bankare. I është dërguar QKB lista e personave që autorizohen nga prokuroria për të patur akses në regjistrin e pronarëve përfitues dhe aktualisht Prokuroria e Përgjithshme është në pritje të realizimit të aksesit. Po ky institucion ka ridërguar kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë për akses në bazat e të dhënave “Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor” dhe “Baza e të dhënave Shtetërore të Shërbimit Notal Shqiptar, Regjistri Notal Shqiptar”.


Për këtë periudhë monitorimi, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, me këtë numër bazash të të dhënave të aksesuara, rezulton se treguesi është i realizuar në masën 100% (20 databaza të aksesuara nga 18 që përcaktohen si objektiv për vitin 2021).

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	Policia ka akses në 10 baza të Dhënash. Prokuroria ka akses në 8 baza të dhënash.
	2018	N/A
	2019	Policia ka akses në 14 baza të dhënash; akses në 3 databaza për prokurorinë
	2020	Policia ka akses në 16 baza të dhënash; akses në 5 databaza për prokurorinë (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Policia ka akses në 18 baza të dhënash; akses në 7 databaza për prokurorinë
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Policia ka akses në 20 baza të dhënash; akses në 9 databaza për prokurorinë

<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Policia ka akses në 22 baza të dhënash; akses në 11 databaza për prokurorinë
-------------------------------	------	--

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### Niveli i realizimit të objektivit B.2

Niveli i realizimit të *Objektivit B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **50%**.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR B. 2 = \frac{TP B.2.a (0\%) + TP B.2.b (100\%)}{2 TP} \times 100\% = 50\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.2 për këtë periudhë raportimi **mjaftueshëm** (0 deri në 50 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2021.

## Risqet për realizimin e Objektivit B2

Risku i realizimit të këtij objektivi është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me organizimin dhe bashkëpunimin si dhe me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ. Pra ka mundësi të lartë rrishtje dhe ndikim të mesëm të tij.

### **B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar**

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*B.3.a: Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare*

*B.3.b: Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Aseteve/Pasurive (ZRA)*

Plani i veprimit për Objektivin B.3 parashikon 4 Aktivitete dhe 4 Masa.

#### **B.3.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.3.a** për vitin 2021 është: *Publikimi dhe dorëzimi i një raporti rishikimi ndaj politikëbërësit*

Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është *hartimi i një raporti të tillë vjetor për secilin nga vitet*. Ky tregues synon vlerësimin konstant të akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë dhe konsolidimin e praktikave dhe kapaciteteve.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte hartimi, publikimi dhe i vënia në dispozicion për politikëbërësit e një raporti vlerësimi mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

B. 3.1	Raport mbi vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimet institucionale për ngritjen e ZRA
B.3.1.1	Grup pune për raportin e vlerësimit (faza I) Institucionet (pjesë e grupit të punës) fillojnë procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit (faza II) Hartimi i kalendarit të punës (faza III) Draft/dokument vlerësimi dhe rekomandime të dhëna (faza IV) Dokument final mbi rishikimin e kuadrit ligjor të fushës, për ngritjen e ZRA (faza V)

Gjatë periudhës *janar-dhjetor 2021*, me urdhërin Nr.49, datë 28.05.2021, të Kryeministrit është ngritur grupi ndërinstucional i punës për hartimin e një raporti dhe kryerjen e vlerësimit të kuadrit ligjor dhe rekomandimeve instucionale për ngritjen e zyrës së rikuperimit të asetëve. Grupi i punës kryesohet nga Zëvendës Ministri i Drejtësisë, dhe ka përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përfaqësues nga Prokuria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme dhe ekspertë

të fushës së sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Në zbatim të urdhërit të kryeministrit, grupi i punës ka hartuar një draft dokument të vlerësimit të kuadrit rregullator të përgjithshëm, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse. Janë zhvilluar 5 takime pune në datat 14 e 30 qershor dhe 14, 16 e 30 korrik 2021. Është hartuar një plan pune për grupin e punës dhe është kryer një analizë ligjore e cila pasqyron modelet e funksionimit të ARO në shumicën e vendeve të rajonit dhe Europës. Janë konsultuar propozimet me ekspertë të Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian pranë MD/KKKK. Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, analizën e thelluar të nevojshme për t'u kryer në mbështetje të hartimit të raportit të vlerësimit të kuadrit ligjor dhe institucional për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Janë zhvilluar gjithashtu takime dhe produkte periodike (research, takime, papers, komunikime, etj) që prej kohës kur është ngritur grupi i punës deri në fund të vitit 2021. Treguesi për vitin 2021 është realizuar në masën 50%, pasi e gjithë puna përgatitore e bërë është në funksion të hapit të rradhës: Finalizimi i vendimmarrjes për strukturën e ZRA mbetet në proces.

Ky tregues synon të përmirësojë hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, siç përcaktohet nga Paketa e Instrumenteve numër për Rregullimin më të Mirë të Bashkimit Evropian.<sup>37</sup>

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit
	2020	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 50%
	2022	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësi
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësi

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

<sup>37</sup> [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/file\\_import/better-regulation-toolbox-4\\_en\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/file_import/better-regulation-toolbox-4_en_0.pdf)

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	0	
Vlera e synuar 2018	1	0
Vlera e synuar 2019	1	0
Vlera e synuar 2020	1	0
Vlera e synuar 2020	1	50%

### B.3.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.3.b** për vitin 2021 është realizimi i kornizës për funksionimin e ZRA dhe lista e përpiluar e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. Për vitin 2022 vlera e synuar është bërja funksionale e ZRA dhe njoftimi i Komisionit të BE për ngritjen e ZRA. Për vitin 2023 vlera e synuar është caktimi i prokurorëve të specializuar të kushtuar vetëm gjurmimit dhe rikuperimit të pasurive.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte hartimi i bazës ligjore për ZRA dhe identifikimi i institucionit ku do të vendoset. Ky tregues nuk është arritur për vitin 2020 dhe është zhvendosur për vitin 2021.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

B. 3.2	Baza ligjore mbi ZRA (institucioni pritës dhe procedurat standarde të veprimit) të hartuara nga institucioni propozues
B.3.2.1	Kuadri ligjor dhe nënligjor i zhvilluar dhe miratuar (I) Vendimmarrja për strukturën e ZRA (ku do të jetë ky institucion i ri/ si do të ngrihet/ varësia funksionale e tij/ përcaktimi i buxhetit) (II)

Nuk është realizuar ende e gjithë korniza ligjore për gritjen e ZRA dhe të jetë përpiluar e publikuar lista e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. Në këto kushte treguesi për vitin 2021 nuk është realizuar. Hapi i radhës është finalizimi i vendimarrjes për ZRA.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Përzgjedhja einstitucionit ku do të ngrihet ZRPja (me vendim qeverie). Zhvillimi i 22 SoP-ve bazë.
	2020	Baza ligjore për ngritjen e ZRA i identifikuar dhe mbështetës (treguesi është arritur në masën 0%)

<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Korniza ligjore për ngritjen e ZRA i realizuar/Eshtë përpiluar dhe publikuar lista e duhur e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi.
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	0%
	2022	ZRP-ja është funksionale. Njoftimi i Komisionit të BE-së për ngritjen e ZRP-së
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Prokurorët e specializuar i janë kushtuar vetëm gjurmimit të pasurive dhe rikuperimit.

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në tabelën më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Zyra për Rikuperimin e Pasurive në përputhje me Vendimin i Këshillit Evropian 2007/845/JHA mungon	
Vlera e synuar 2018	Vlerësim i kuadrit ligjor dhe identifikimi i strukturës institucionale për ngritjen e ZRP	Vlerësim për ngritjen e ZRP nuk është kryer.
Vlera e synuar 2019	- Përzgjedhja e institucionit ku do të vendoset ZRP - Miratimi i Procedurave Standarte	Përzgjedhja e institucionit ku do të vendoset ZRP nuk është bërë.
Vlera e synuar 2020	- ZRP është funksionale. - Njoftimi i Komisionit të BE për ngritjen e ZRP	ZRP nuk është funksionale
Vlera e synuar 2021	- Korniza ligjore për ngritjen e ZRA i realizuar/Eshtë përpiluar dhe publikuar lista e duhur e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi.	E përealizuar

Ky tregues është i lidhur pjesërisht me treguesin B.3.a sa i takon realizimit të një vlerësimi të kuadrit ligjor dhe identifikimit të strukturës institucionale për ngritjen e ZRA.

### ***Niveli i realizimit të objektivit B.3***

Niveli i realizimit të *Objektivit B.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 **është 25%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR B. 3 = \frac{TP B.3.a (50\%)+ TP B.3.b (0\%)}{2 TP} \times 100\% = 25\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit B.3 për këtë periudhë raportimi **është dobët** (nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion (sekretariat teknik) i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, përgjegjës për të koordinuar punën e grupit ndërinstitutional të përsë për ZRA (eng.ARO) të ngritur me urdhër të Kryeministrit, nr. 49, datë 28.5.2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit B.3**

Risku i realizimit të këtij objekti është i mesëm për shkak të rreziqeve të lidhura me organizimin, funksionimin dhe hartimin e bazës ligjore të nevojshme për ngritjen e zyrës, pra ka mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të lartë të tij.

### ***B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*B.4.a: Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit.*

*B.4.b: Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.*

Plani i veprimit për Objektivin B.4 parashikon 5 Aktivitete dhe 4 Masa.

#### **B.4.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.4.a** për vitin 2021 është: **rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëprshëm.**

Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është **po rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëprshëm.**

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte gjithashtu rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëparshëm. Ky tregues është nuk arritur për këtë vit.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

B. 4.1	Forcim bashkëpunimi policor kombëtar dhe ndërkombëtar
B.4.1.1	Shkëmbimi i informacionit si edhe hetime të koordinuara e të përbashkëta mes agjencive
B.4.1.2	Konferenca të përbashkëta me agjencitë homologe për shkëmbim eksperience në hetimet e përbashkëta.

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 muaj.

Për *janar- dhjetor 2021*, Policia e Shtetit ka shkëmbyer 569 praktika me Interpolin nga të cilat 403 me sektorin e Krimit Ekonomik dhe Financiar dhe 166 nga Sektori për Pastrimin e Parave dhe Aseteve Kriminale, sipas kësaj ndarjeje: 200 praktika me Europolin, nga të cilat 116 nga Sektori për Krimin Ekonomik e Financiar dhe 84 nga Sektori për Pastrimin e Parave; 284 praktika me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, nga të cilat 213 nga Sektori për Krimin Ekonomik e Financiar dhe 71 nga Sektori për Pastrimin e Parave; 45 praktika me rrjetin CARIN trajtuar nga sektori për pastrimin e Parave dhe Aseteve Kriminale.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	103
	2018	N/A
	2019	Përditësimi i procesit të monitorimit të brendshëm për të marrë të dhëna të detajuara të grumbulluara dhe të zbërthyer. Publikimi i të dhënave; Rritja prej 5% në raport me vitin 2018
	2020	Rritje prej 5% në raport me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 0%)
	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritje prej 5% në raport me vitin 2020




<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Rritje prej 5% në raport me vitin 2021
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritje prej 5% në raport me vitin 2021

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



Siç e tregon grafiku më poshtë, edhe ky tregues është realizuar me vlera të ndara çdo vit.



Në total, Policia e Shtetit ka shkëmbyer më shumë informacione krahasuar me vitin 2020, kështu që rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer, është realizuar. Vlera e treguesit të performancës gjatë vitit 2021, është arritur në masën 100%.

Siç shihet nga të dhënat, sasia dominuese e të dhënave të shkëmbyera është me Interpol dhe Europol. Ka një rritje në vite të informacioneve të shkëmbyera me CARIN (Camden Asset Recovery Inter-agency Network - Rrjeti ndër-agjensor i Gjetjes së Aseteve Camden), i cili fokusohet në gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të krijuara përmes krimit ekonomik, përfshirë korrupsionin.

Siç shihet nga të dhënat, sasia dominuese e të dhënave të shkëmbyera është me Interpol dhe Europol. Ka një rritje në vite të informacioneve të shkëmbyera me CARIN (Camden Asset Recovery Inter-agency Network - Rrjeti Ndëragjensor i Gjetjes së Aseteve Camden), i cili fokusohet në gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të krijuara përmes krimit ekonomik, përfshirë korrupsionin.

#### **B.4.b**

Vlera e synuar për treguesin e performancës **B.4.b** për vitin 2021 është: *kryerja e 5 operacioneve të përbashkëta të Policisë, të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, ku Shqipëria merr pjesë aktivisht*. Për vitet 2022 dhe 2023 vlera e synuar është trend rritës krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për vitin 2020 vlera e synuar ishte kryerja e 5 operacioneve të përbashkëta të Policisë, të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, ku Shqipëria merr pjesë aktivisht. Gjatë vitit 2020, Policia e Shtetit ka kryer dhe ka marrë pjesë në 3 operacione të përbashkëta me Europol ose Interpol, në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, nga 5 që ishte vlera e synuar për këtë periudhë raportuese.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

B. 4.2	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si EUROPOL, CEPOL, INTERPOL, CARIN, BAMIN, UNDC, OSBE
B.4.2.1	Trajnime të kryera me kolegë të agjencive homologe (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj).
B. 4.3	Ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit
B.4.3.1	Nr. i skuadrave të ngritura
B. 4.4	Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare
B.4.4.1	Nr. i aktiviteteve trajnuese dhe nr. i takimeve të kryera dhe nr. i pjesëmarrësve; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor.

Për *janar - dhjetor 2021*, janë zhvilluar 22 trajnime me 220 përfitues nga të cilët 45 janë femra<sup>38</sup>. Nuk janë ngritur skuadra të përbashkëta hetimore për hetimin e veprave penale në fushën e krimit financiar dhe ekonomik. Megjithatë janë kryer disa operacione Policore, të cilat listohen si vijon: *Operacionin policor "NOMADA"*, nga Njësia për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiket, në kuadër të Proçedimit Penal nr.583/2020 me SPAK, në bashkëpunim me homologët Spanjollë dhe EUROPOL, gjatë të cilit u arrestuan në 10 shtetas në Spanjë, 1 shqiptar, 1 algerian dhe 8 shtetas spanjollë. Veprat penale të konsumuara janë "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave" dhe "Pastrimit të produkteve të veprës penale", të parashikuar nga nenet 298, 189 dhe 287, të Kodit Penal; *Operacionin Policor ndërkombëtar "SHPIRTI"*, i finalizuar më datë 02.07.2021, nga Njësia për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiket, pranë Drejtorisë Hetimore, në bashkëpunim me Antimafian Italiane, SPAK dhe me koordinimin e EUROJUST, në Hagë-Hollandë, për veprat penale "Trafikim i narkotikëve" kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, "Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", "Kultivim i narkotikëve", "Shpërdorimi i

<sup>38</sup> Temat janë cituar më sipër, së bashku me numrin e aktiviteteve trajnuese, numrin e takimeve të kryera dhe numrin e pjesëmarrësve, femra dhe meshkuj.

detyrës”. Në kuadër të këtij operacioni janë kryer arrestime në Shqipëri, Itali, Mali i Zi dhe Spanjë. Me Vendimin Penal nr. 45, datë 30.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ana e Policisë së Shtetit, janë ekzekutuar masat e sigurisë, arrest me burg për 14 shtetas. Gjithashtu janë ekzekutuar masat e sigurisë, “Arrest në shtëpi”, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” për Prokurorinë e Rrethit Vlorë për 4 shtetas. Në kuadër të këtij procedimi në total janë lëshuar 38 urdhër-arreste, prej të cilëve 18 të arrestuar në këtë operacion, 10 shpallur në kërkim dhe 10 të arrestuar më herët në kuadër të operacioneve “Shefi” dhe “Kulmi”, finalizuar në vitet 2018-2020. Janë sekuestruar 2 armë zjarri pistoleta (“TT” dhe “Bereta”) si dhe 60 mijë euro cash. Bazat e grupit kriminal të goditur janë Vlora, Kavaja, Tepelena, Skrapari, Lazarati dhe Tirana. Në vijim të operacionit policor “SHPIRTI” është zbatuar vendimi i Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku shtetasve A.M dhe J.M u janë sekuestruar 23 pasuri në total: 13 të paluajtshme, 5 të luajtshme dhe 5 aktivitete tregëtare, të cilat ende nuk janë vlerësuar; *Operacioni ndërkombëtar “LIPAS”*, në bashkëpunim me homologët norvegjezë, i finalizuar më datë 20.10.2021 nga Drejtoria Hetimore, në funksion të procedimit penal nr. 132/2019, për veprat penale të “Trafikim i narkotikëve” kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Prodhim shitje e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Krijimi i grupit të strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/1, 283/a/1, 28/4, 287, 333/a dhe 334 të K.P. Gjatë këtij operacioni u ekzekutuan 2 masa sigurie “Arrest në burg” dhe “Arrest në shtëpi”, për 2 subjekte, si dhe u kryen kontrole banese për 5 subjekte ku janë sekuestruar dokumenta, telefona, 1 makinë, me cilësinë e provës materiale; *4. Operacioni policor “DETROID”*, nga Njësia për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiket, pranë Drejtorisë Hetimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, zyrën e Interpolit, Njësia Hetimore “Jointshield” që funksionon në bashkëpunim DSS dhe OSI dhe me zyrën e DEA-s Athinë. Gjatë këtij operacioni u kap dhe arrestua një shtetas amerikan i përfshirë në veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve me qëllim fillimin e procedurave te ekstradimit drejt SHBA-së, sepse Gjykata e Michiganit/ Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendimin e datës 09.06.2021 i ka vendosur këtij shtetasi, masën e sigurisë “Arrest në burg” për veprat penale “Trafikimi i lëndëve narkotike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”; *Operacionin policor “PERËNDIMI”*, kryer nga Njësia për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiket, në Drejtorinë Hetimore, në bashkëpunim me homologët italianë dhe Drejtorinë e Forcës së Posaçme, Njësinë FAST, DKM, në kuadër të procedimit penal në ndjekje me SPAK, gjatë të cilit u arrestua në flagrancë 1 shtetas, i cili me automjetin e tij tip “Chrysler” me targë AB633CX, ka tentuar të trafikoj 27 pako me lëndë narkotike të mbështjella me natriban, me peshë me peshë 14 kilogram e 174 gram, e cila e bllokua në cilësinë e provës materiale. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Shkodër. Nenet 283/a dhe 287 të K.P; *Operacionin policore “DVOJNIK”* realizuar në muajin Korrik 2021 nga strukturat e Drejtorisë për Krimet Ekonomike dhe Financiare në Departamentin e Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me strukturat e Interpol Tiranë dhe autoritetet policore të Maqedonisë së Veriut. Gjatë këtij operacioni

nga të dy palët janë identifikuar rreth 150 shtetas shqiptarë të pajisur me dokumenta identifikimi/pasaporta të falsifikuara të Maqedonisë së Veriut. Për 27 shtetasit shqiptarë të identifikuar e pajisur me pasaporta të falsifikuara janë referuar materialet ne prokurorine pranë Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë dhe vazhdojnë hetimet për dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale, për veprat penale të parashikuara nga nenet 189 e 25 të Kodit Penal; *Operacioni policor "PËRFUNDIMI"*, finalizuar më datë 04.06.2021, nga Njësia "C" për Hetimin e Krimit Kompjuterik në Drejtorinë Hetimore të Policisë Shtetit, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe me autoritetet gjyqësore gjermane, gjatë të cilit është bërë e mundur identifikimi dhe arrestimi i autorit të veprës penale "Mashtrimi kompjuterik", parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal, i cili ishte shtetasi rumun, banues në Gjermani, të cilit iu dokumentua se kishte shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 426.577,84 euro, nëpërmjet këtij mashtrimi kompjuterik, aktivitet i nisur që prej vitit 2003; *Operacioni policor "GJURMA"*, finalizuar më datë 22.09.2021, nga Njësia "C", Hetimi i krimeve kibernetike, në Drejtorinë Hetimore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pas një hetimi të nisur në vitin 2021 nga autoritetet ligjzbatuese Turke, Njësia hetimit të krimeve kibernetike regjistroi 1 procedim penal dhe pas kryerjes së hetimeve dhe ndjekjen penale të disa shtetasve për veprat penale të "Përkrahja e autorit të krimit" dhe "Mashtrimin Kompjuterik", sipas neneve 302 dhe 143/b/2 të Kodit penal. Pas kryerjes, Njësia "C" Hetimi i krimit kibernetik ka arrestuar 1 shtetas; *Operacioni policor i koduar "KOMUNIKIMI"*, i finalizuar më datë 24.12.2021, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e mashtrimeve kompiuterike, realizuar nga Njësia "C" Hetimi Krimit Kibernetik në Drejtorinë Hetimore dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i 38 shtetasve si dhe u proceduan në gjendje të lirë 24 shtetas të tjerë. Njësia "C" Hetimi i Krimit Komiuterik ka në ndjekje 8 procedime të përbashkëta, konkretisht: 2 proçedime penale në ndjekje me autoritetet policore spanjolle; 1 proçedim penal është në ndjekje në bashkëpunim me autoritetet policore angleze; 1 proçedim penal është në ndjekje në bashkëpunim me autoritetet policore austriake dhe spanjolle; 1 proçedim penal është në ndjekje në bashkëpunim me autoritet policore Amerikane, Homeland; 2 procedime penale në ndjekje me autoritetet policore Italiane; 1 procedim penal në ndjekje me autoritetet policore Gjermane.


Në konkluzion, arrihet në përfundimin se objektivi për vitin 2021 nuk është arritur, pasi megjithë operacionet e zbatuara, nuk janë kryer 5 operacione të përbashkëta të Policisë, të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	2
	2018	N/A
	2019	4

	2020	5 (treguesi është arritur në masën 60%)
Vlera e synuar/ Targeti	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Trend rritës
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	0%
	2022	Trend rritës
Vlera e synuar/ Targeti	2023	Trend rritës

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



#### Niveli i realizimit të objektivit B.4

Niveli i realizimit të *Objektivit B.4 Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **50%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR B. 4 = \frac{TP B.4.a (100\%) + TP B.4.b (0\%)}{2 TP} \times 100\% = 50\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.4 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31 në 50 përqind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit për monitorimin e vitit 2021.

### Risqet për realizimin e Objektivit B.4

Risku i realizimit të këtij objektiv është i mesëm për shkak të rreziqeve të lidhura me partnerët e jashtëm si dhe rreziqe që lidhen me planifikimin dhe sistemet e tjera mbështetëse.

### *Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit (Qasja B)*

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit është 43.75%.

Objektivi	Realizueshmëria
B.1. Përmirësimi i efijencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	50%
B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit	50%
B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	25%
B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.	50%

Përtej nivelit të ulët të realizimit në masën 43.75%, qasja ndëshkuese ndaj korrupsionit, paraqet njëkohësisht disa sfida që duhen adresuar nga organet ligjzbatuese. Nga monitorimi i Planit të Veprimit për gjithë vitin 2021, është vënë re se objektivi i përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit, ka nevojë të trajtohet më tej duke marrë masa konkrete në zbatim të arritjes së vlerave të parashikuara. Në qasjen ndëshkuese të korrupsionit, luan padyshim një rol themelor sekuestrimi i asteve për vepra penale të lidhura me korrupsionin dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare midis agjencive kryesore të zbatimit të ligjit si Policia e Shtetit, Europol e Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik. Në funksion të analizës tërësore të qasjes ndëshkuese, nevojiten gjithashtu të dhëna të detajuara mbi numrin përfundimtar vjetor të çështjeve të trajtuara mbi korrupsionin dhe numrin e personave të hetuar nga SPAK dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore. Analiza e risqeve për objektivin B.1, për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm e që kanë të bëjnë me komunikimin, informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional, kapacitetet administrative dhe mjedisin rregullativ, do duhej të kategorizohej më mirë, në mënyrë që ky tregues performance të mund të rishikohej në të ardhmen, jo vetëm për ta vendosur atë mbi baza që i afrohen më tepër realitetit të sotëm, por nga ana tjetër për të adresuar sidomos ato çështje apo risqe që e pamundësojnë arritjen e objektivit.

### ***Qasja Ndërgjegjësuere - Përmbledhje për arritjet në ndërgjegjësimin mbi korrupsionin***

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndërgjegjësuere SNKK** synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativat e parandalimit të korrupsionit, edukimin e publikut dhe ndërmarrjen e aktiviteteve me efekt ndërgjegjësimi.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara <sup>39</sup>	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b> <sup>40</sup>
Ndërgjegjësuere	Masa	9	5	3	1
	Aktivitete	22	11	4	7

<sup>39</sup> Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.


<sup>40</sup> Aktivitet "i përpunuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind



Rezultoni se nga 9 masa e 22 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-dhjetor 2021, për Qasjen C (Ndërgjegjësuere), janë zbatuar 5 masa/11 aktivitete, 3 masa/4 aktivitete janë ende në proces zbatimi dhe 1 masë/7 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa C.3.2 dhe aktivitete C.2.2.1; C.3.1.1; C.3.1.3, C.3.1.6; C.3.2.1 dhe C.3.2.2 dhe C.3.2.3).

Nga 7 treguesit e performancës për qasjen parandaluese (C), është arritur vlera e synuar për 3 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 0 tregues performance si edhe nuk është arritur<sup>41</sup> vlera e synuar për 4 tregues performance.

Qasja Ndërgjegjësuere	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht <sup>42</sup>	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht <sup>43</sup>	Vlera e synuar nuk është e realizuar <sup>44</sup>
	7	5	0	2



### ***C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

<sup>41</sup> Këtu është përfshirë edhe treguesi nuk mund të matet (A.7.a).

<sup>42</sup> Që është realizuar në shkallën 100 për qind

<sup>43</sup> Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

<sup>44</sup> Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna

*C.1.a: Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.*

*C.1.b: Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit.*

### **C.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.a** për vitin 2021 është: **zbatimi 100% i aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e dhe Komunikimit**. Për vitin 2022 vlera e synuar është **realizimi i vlerësimit dhe rishikimit të Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit**, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është **miratimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit**.

Gjatë vitit 2020, MD hartoi dhe finalizoi Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit dhe zbatoi 50% të aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e dhe Komunikimit.

Vlera e synuar për vitin 2021 është zbatimi i 100% i aktiviteteve të parashikuara.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

C.1.1	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit në zbatim të SNKK/vjetor, i hartuar
C.1.1.1	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 i hartuar nga grupi i punës/miratur nga MD
C.1.1.2	Plane vjetore Vizibiliteti dhe Komunikimi të rishikuara dhe miratuara (2021/2022/2023)
C.1.4	Transparence e shtuar në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të tij
C.1.4.1	Raporte periodike monitorimi të Planit të Veprimit/të Pasaportës së Treguesve (publikim i tyre) (raporte 3M/6M/vjetore)
C.1.4.2	Publikim/shpërndarje e e-buletine të dokumenteve të AK (raporte; monitorime etj.) në target grupe studentë/OSHC/forume biznesi

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit të zbatimit të planit të veprimit.

Gjatë janar – dhjetor 2021, Ministria e Drejtësisë në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka rishikuar Planin vjetor të vizibilitetit dhe komunikimit në fushën antikorrupsion. PK&V 2021 përmban në total 13 aktivitete për tu zhvilluar përgjatë vitit 2021, me fokus luftën kundër korrupsionit. Përmbajtja e tij është gjithëpërfshirëse dhe e targetuar kundrejt grupeve të ndryshme të interesit. Dokumenti është publikuar në faqen web të Ministrisë së Drejtësisë në

linkun <https://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Plani-i-Komunikimit-dhe-Vizibilitetit-2021.pdf>.

Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2021 Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka kryer aktivitetet:

- Takim informues: Zhvillimi i Planeve të Integritetit në Institucionet e Varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.
- Takime informuese: Promovimi dhe njohja me publikut me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion.
- Takim informues me organizata ndërkombëtare kundër korrupsionit, mbi rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.
- Takim informues: Marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Drejtësisë - Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë – Ambasadës Italiane Tiranë, për kurikulën antikorrupsion në shkollat e arsimit parauniversitar (finalizimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes MD-MASR-Ambasada Italiane në Tiranë).
- Fushatë ndërgjegjësimi: “Jep Alarmin”, sinjalizo për të luftuar korrupsionin! Në bashkëpunim me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI).
- Njoftime për shtyp, publikime të akteve dhe e-buletine Antikorrupsion.
- Në kuadër të javës së Integritetit (java e parë e muajit dhjetor 2021) u zhvilluan dy forume përkatësisht në datën 6 dhjetor me organizatat rinore, referuar ne linkun <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al/posts/457031142444358> dhe në datën 7 dhjetor me forumet e biznesit, me temë “Ngritja e urave të komunikimit dhe partneriteti me biznesin në luftën kundër korrupsionit”, referuar ne linkun <https://www.facebook.com/manjaulsi/posts/293836926086046>
- Promovimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, si një mekanizëm referimi për rastet e korrupsionit, një mekanizëm referimi për raste korrupsioni në 44 institucione (qendrore), një strukturë e dedikuar kundër korrupsionit. Është përzgjedhur kompania që do të zhvillojë ëëbin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, e cila ka përgatitur gjithashtu video të shkurtra për koordinatorët për secilin institucion dhe një video të gjatë informuese për rrjetin e koordinatorëve dhe rrjetin antikorrupsion<sup>45</sup>.

Gjatë muajit qershor 2021, Ministria e Drejtësisë ka publikuar për herë të parë një përmbledhje mujore të aktivitetëve në fushën antikorrupsion, në formën e një buletini mujor. Ky buletini publikohet rregullisht në faqen ëëb të Ministrisë së Drejtësisë, link: <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>.

---

<sup>45</sup> Për më shumë informacion rreth promovimit të rrjetit të koordinatorëve antikorrupsion, referohu tek treguesi i performancës C.1.b.

Gjatë kësaj periudhe, MD/KKK ka vijuar me transparencën e akteve dhe dokumenteve të fushës: janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë raportet e monitorimit, përkatësisht: Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar - Dhjetor 2020 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Mars 2021 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën Janar-Qershor 2021 (në gjuhën shqipe dhe angleze); Raporti i Monitorimit të SNKK-së, për periudhën korrik-shtator 2021 (në gjuhën shqipe dhe angleze). Publikimi i këtyre raporteve është paraprirë edhe nga publikimi për efekt konsultimi me publikun dhe grupet e interesuara edhe të drafteve të tyre, link: <http://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit>.

Publikimi i këtyre raporteve është paraprirë edhe nga publikimi për efekt konsultimi me publikun dhe grupet e interesuara edhe të drafteve të tyre, gjithashtu.

Gjithashtu ka vijuar rregullisht konsultimi i dokumenteve AK (raporte monitorimi dhe drafti i PV PQH (OGP) komponenti antikorrupsioni në rrjetin e organizatave në fushën antikorrupsion.

Netëork/forumi i OSHC për AK i krijuar për këtë qëllim është njoftuar rregullisht mbi akte dhe procese të ndjekura nga MD në kuadër të AK.

Për këtë periudhë, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë tregues, për krijimin e planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të SNKK dhe zbatimin e tyre, rezulton të jetë arritur në masën 100% për këtë periudhë (të gjitha aktivitetet e parashikuara për vitin 2021 në këtë plan janë realizuar)

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2018 finalizohet në 3 Mujorin 2 të vitit
	2019	- Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 108 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit
	2020	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Janë zbatuar 50% e detyrave të

		ndërgjegjësimin dhe komunikimin të parashikuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit 2019. (treguesi është arritur në masën 100%)
Vlera e synuar/ Targeti	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Zbatim i 100% i aktiviteteve të parashikuara
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit i vlerësuar dhe rishikuar
Vlera e synuar/ Targeti	2023	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit i vlerësuar dhe rishikuar

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

Ky tregues është realizuar plotësisht vetëm për vitin 2021.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit të SNKK mungon	
Vlera e synuar 2018	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2018 finalizohet në 3 Mujorin 2 të vitit.	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit nuk u realizua për vitin 2018
Vlera e synuar 2019	- Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 u realizua në 3 Mujorin 3 të vitit.
Vlera e synuar 2020	- Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit. - Janë zbatuar 50% e detyrave të ndërgjegjësimin dhe komunikimit të parashikuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit 2019.	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 u realizua në 3 Mujorin 1 të vitit
Vlera e synuar 2021	Zbatim i 100% i aktiviteteve të parashikuara	Treguesi është arritur në masën 100%

## C.1.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.b** për vitin 2021 është: *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit*, për vitin 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Gjatë vitit 2020, raporti i monitorimit përfshin një numër aktivitete të kryera dhe targeti është i realizuar 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (2) si më poshtë.

C.1.2	Instrumente ndërgjegjësuese dhe informuese kundër korrupsionit të zbatuara në vend
C.1.2.1	Ideimi, hartimi dhe miratimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese e informuese specifike; (aktivitete me mesazhe të qarta/të përshtatshme për femra dhe meshkuj; numri i aktiviteteve që adresojnë pasojat specifike të korrupsionit) - përgjatë viteve 2020/2021/2022/2023
C.1.2.2	Java e Integritetit 2020 (3- 11 shkurt 2020) - tryeza, forume AK, aktivitete sportive etj.
C.1.2.3	Tryezë për promovimin e planit të integritetit të MD , modeli i dokumentit për institucionet e qeverisjes qendrore në vend
C.1.3	Mekanizma me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të besimit të publikut në forcimin e luftës kundër korrupsionit
C.1.3.1	Botime të publikuara në kuadër të ndërgjegjësimit qytetar në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri: - Broshurë: SNKK (v.2020) - Broshurë: Hapat për të denoncuar korrupsionin në Shqipëri (v.2020)
C.1.3.2	Takime duke angazhuar të rinjtë (auditoret universitare) dhe komunitetet parauniversitare për njohjen e pasojave që vijnë nga korrupsioni, në fusha si arsim/shëndetësi/tatimedogana/prona/gender, (v.2020/2021/2022/2023)
C.1.3.3	Film Festival Antikorrupsion 2020
C.1.3.4	Organizimi e pjesëmarrja në evente mediatike mbi antikorrupsionin:/takime me gazetarët/konferenca/deklarata/e- KKK/MD TM II 2020 TM IV 2020 kosto administrative 15 buletine/njoftime etj.
C.1.3.5	Seminar/workshop për antikorrupsionin me grupe të interesuara/identifikuara nga SNKK (v.2020/2021/2022/2023)
C.1.3.6	Seminare për forcim kapacitetësh të vlerësimit të riskut të integritetit për stafin drejtorisë AK (kurikula AK)

C.1.3.7	Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (9 dhjetor) - aktivitet ndërgjegjësues në MD, aktivitet që kryhet për çdo vit të zbatimit të PV
C.1.4	Transparence e shtuar në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumentave të tjera shoqëruese të tij
C.1.4.1	Raporte periodike monitorimi të Planit të Veprimit/ të Pasaportës së Indikatorëve (publikim i tyre) (raporte 3M/6M/vjetore)
C.1.4.2	Publikim/shpërndarje e e-buletine të dokumenteve të AK (raporte; monitorime, etj) në target grupe studentë/OSHC/forume biznesi

Realizimi i masave (2) të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktiviteteve dhe eventeve ndërgjegjësuese të kryera çdo 3 muaj.

Gjatë *janar – dhjetor 2021*, MD ka kryer identifikimin/hartimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese në fushën AK, për vitin 2021 (referohu masës C.1.1). Aktivitetet janë në zhvilluar në fusha të ndryshme, me target grupe të tjerë nga aktivitetet e mëparshme dhe të hapura për publikun.

Është kryer promovimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, një mekanizëm referimi për raste korrupsioni në 17 institucione (qendrore), një strukturë e dedikuar kundër korrupsionit (fushatë ndërgjegjësimi 1). <https://www.drejtesia.gov.al/ministria-e-drejtetise-po-vijon-takimet-per-venien-ne-funksionalitet-te-plote-te-koordinatoreve-te-rrjetit-antikorrupsion/>  
<https://www.drejtesia.gov.al/prezantimi-i-koordinatorit-antikorrupsion-nga-zv-ministrja-pirdeni/>  
<https://www.drejtesia.gov.al/ministria-e-drejtetise-vijon-takimet-per-venien-ne-funksionalitet-te-plote-te-koordinatoreve-te-rrjetit-antikorrupsion/>

MD ka bashkëpunuar me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) me qëllim kryerjen e aktivitet ndërgjegjësues, me temën “Jep alarmin, sinjalizo për të luftuar korrupsionin”, në datë 10 qershor 2021. Link: <https://rai-see.org/all-events/ehistle-for-the-end-tirana-guerrilla-event/>.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, me asistencën teknike dhe financiare të DBE, është finalizuar projekti për ndërtimin e faqes së dedikuar [www.antikorrupsioni.gov.al](http://www.antikorrupsioni.gov.al) dhe ideimi dhe prodhimi i 17 video të shkurtra për koordinatoret e Rrjetit Antikorrupsion si dhe një video e gjatë informuese për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit.

MD ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi në datën 15 qershor 2021 me Ministrinë e Arsimit, dhe Rinisë dhe Ambasadën e Italisë në Shqipëri e shoqatën “Avviso Pubbico”. Me këtë marrëveshje palët synojnë të përcaktojnë një marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik. Është nënshkruar marrëveshja në datën 15/06/2021, referuar në linkun

<https://www.drejtesia.gov.al/fjala-e-mbajtur-eministres-gjonajne-takimin-per-nenshkrimin-emarrevshjesmidis-ministrise-drejtiseministrise-searsimit-sportitdhe-rinise-dheambasades-202-italiane-per-pilotimin-e-nje-projekt/>

Është hartuar një kalendar aktivitetesh për të zbatuar marrëveshjen e bashkëpunimit. Është kryer aktiviteti i parë lançues në datën 23 nëntor 2021, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadorit të Italisë në Shqipëri, i aksesueshëm në linkun <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=284733073663098&set=a.245995267536879&type=3>

MD ka zhvilluar një trajnim për Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, për njohje të praktikave më të mira, transparencës dhe të drejtës së informimit, monitorimit të strategjisë AK, vlerësimit të riskut dhe hartimit të PI, në datat 25 - 26.02.2021. Trajnimi është zhvilluar online nëpërmjet platformës zoom. Të pranishëm në takim ishin stafi teknik i Drejtorisë AK në MD dhe koordinatorë të Rrjetit AK. Janë bërë 2 ëorkshope ndërinstucionale me institucionet përgjegjëse të PV SNKK, në data 13 dhe 14 prill 2021, në ambjentet e MD. Gjithashtu është zhvilluar një cikël trajnimesh për pikat e kontaktit AK, (punonjës të administratës publike) nga asistenca teknike DBE së bashku me ASPA -n, në datat 18, 21, 29 qershor, 6 korrik, 26 tetor, 17 dhe 26 nëntor.

Është zhvilluar një takim dy ditor me temë “Menaxhimi i ankesave për rrjetin e koordinatorëve AK” në datat 17 dhe 18 maj 2021, në bashkëpunim me ANAC e Këshillin e Lartë të Magjistratëve.

Në datat 3 - 4.03.2021 është zhvilluar trajnim ToT nga ASPA në bashkëpunim me ekspertë të DBE, në fushën e vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit të PI. Në këtë trajnim/seminar morrën pjesë dy persona staf të Drejtorisë AK, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e vlerësimit të riskut të integritetit. Në datë 24.06.2021, në mjediset e DPB nga asistenca teknike e DBE me pjesëmarrjen edhe të MD, u mbajt një trajnim i dedikuar për grupin e punës përgjegjës për procesin e vlerësimit të riskut dhe hartimit të PI në DPB.

Është publikuar në faqen eeb të Ministrisë së Drejtësisë Metodologjia e Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore në linkun: <https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>

Për këtë periudhë monitorimi, nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi për këtë tregues, mbi fushatat e ndërgjegjësimit (vjetore) për luftën kundër korrupsionit me aktivitete të rishikuara, rezulton të jetë arritur në masën 100% MD ka rishikuar Planin vjetor të 2021 të vizibilitetit dhe komunikimit në fushën AK, për vitin 2021. Dokumenti është publikuar në eëbin e MD në linkun <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/Plani-i-Komunikimit-dhe-Vizibilitetit-2021-1.pdf>.

MD ka kryer 4 aktivitete ndërgjegjësuese për vitin 2021:



1.Në kuadër të javës së Integritetit (java e parë e muajit dhjetor 2021) u zhvilluan dy forume përkatësisht në datën 6 dhjetor me organizatat rinore dhe në datën 7 dhjetor me forumet e biznesit, me temë “Ngritja e urave të komunikimit dhe partneriteti me biznesin në luftën kundër korrupsionit”.

2.Promovimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, si një mekanizëm referimi për rastet e korrupsionit, një mekanizëm referimi për raste korrupsioni në 44 institucione (qendrore), një strukturë e dedikuar kundër korrupsionit.

3.MD së bashku me RAI ka kryer një aktivitet ndërgjegjësues, me temën “Jep alarmin, sinjalizo për të luftuar korrupsionin”, në datë 10 qershor 2021, në Tiranë me përfshirjen e publikut të gjerë.

4.Është zhvilluar një takim i nivelit të lartë me temë “*Sfidat dhe mundësitë në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e integritetit*” në datën 5 korrik 2021, i përbërë nga dy panele: Paneli i parë me pjesëmarrës: Ministrin e Drejtësisë, Z.Luigi Soreca, Z.Crin Bologna, Z.Arben Kraja, Znj.Aida Hajnaj dhe Znj.Clay Stiffler dhe Paneli i dytë me pjesëmarrës: Zëvendësministrin e Drejtësisë, Z.Fabrizio Bucci, Znj.Hane Juncher, Znj.Anca Jurma, dhe Znj.Desislava Gotskova.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Përmirësimi i mostolerimit të korrupsionit nga institucionet publike
	2020	Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit (treguesi është arritur në masën 100%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	Treguesi është arritur në masën 100%
	2022	Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit

<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit
-------------------------------	------	---

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

Tabela më poshtë tregon ecurinë e realizueshmërisë së këtij treguesi në tre vitet e matura. Realizueshmëria e këtij treguesi ka qënë e dobët në vitin e parë por është realizuar plotësisht në dy vitet e fundit.

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Fushatat e ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit nuk zbatohen në mnyrë të programuar	
Vlera e synuar 2018	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	0
Vlera e synuar 2019	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara
Vlera e synuar 2020	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara
Vlera e synuar 2021	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara për luftën kundër korrupsionit	4 fushata ndërgjegjësimi të zbatuara

### *Niveli i realizimit të Objektivit C.1*

Niveli i realizimit të Objektivit C.1 *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **100%**.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR C. 1 = \frac{TP C1.a (100\%) + TP C.1.b (100\%)}{2 TP} \times 100\% = 100\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.1 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-110 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit/ Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit C.1**

Risku i realizimit të këtij objekti është i ulët, ka mundësi të ulët të ndodhjes dhe ndikim të ulët të tij, pasi nuk paraqet risk evident.

### ***C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*C.2.a:* Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuar në platformën [www.shqipëriaqeduam.al](http://www.shqipëriaqeduam.al)

*C.2.b:* Numri i rasteve të korrupsionit nga denoncimet e qytetarëve në [www.shqipëriaqeduam.al](http://www.shqipëriaqeduam.al), të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare

Plani i Veprimit për Objektivin C.2 parashikon (4) Aktivitete dhe (3) Produkte/Masa.

#### **C.2.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.a** për vitin 2021 është: **rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm. Për vitin 2022 rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm, dhe për vitin 2023 vlera e synuar është rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.**

Vlera e synuar për vitin 2020 në treguesin e performancës ishte rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

C.2.1	Raportimi periodik i ADB mbi denoncimet e dorëzuara në portal
C.2.1.1	Raporti i prodhuar dhe i publikuar
C. 2.2	Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori
C.2.2.1	Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar
C.2.2.2	Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie)

Realizimi i masës të parashikuar kryhet përmes masave (2) dhe aktiviteteve të parashikuara që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të hartimit dhe publikimit të raportit vjetor në 3 mujorin e katërt të vitit (6M2).


Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, rregullisht (çdo javë) nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe zyrën e Kryeministrit.

Gjatë *janar - dhjetor 2021*, në platformën e bashkëqeverisjes [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al) janë adresuar një total prej 82,416 denoncimesh (ankesa për arsye administrative të llojeve të ndryshme) në nivel qendror, nga të cilat janë zgjidhur 44,665 çështje. Në nivel vendor janë përfunduar 17,685 denoncime dhe janë zgjidhur 6,819 denoncime. Gjatë vitit 2021, janë raportuar 7461 ankesa biznesi dhe janë zgjidhur 3211 çështje. Nga informacioni i analizuar rezulton se ka patur 52599 më shumë denoncime krahasuar me vitin 2020. Gjatë vitit 2021, nga një total prej 82,416 denoncimesh, janë referuar për trajtim 51 raste ankesash, pranë Drejtorisë Antikorrupsion në MD, çka përbën një rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm. Kështu objektivi për vitin 2021 është arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak
	2020	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 58%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	100%
	2022	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:



### C.2.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.b** për vitin 2021 është: **rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak**; për vitin 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Vlera e synuar për vitin 2020 ishte rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak. Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi (si më lart), me aktivitetin e kryer ka ndikuar drejtpërdrejtë në mënyrën e realizimit të treguesit, i cili nuk u arrit.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

C. 2.2	Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori
C.2.2.1	Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar
C.2.2.2	Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie)
C.2.3	Transparencë e rritur e ADB, specifikisht për rastet e denoncimeve kundër korrupsionit
C.2.3.1	Aktivitete informuese mbi mënyrën e funksionit të portalit për publikun (publikime/ ëeb/ njoftime)

Realizimi i masave së parashikuara (2) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktiviteteve.

*Gjatë janar - dhjetor 2021*, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, nuk referon raste në PSH/Prokurori, por i ka referuar ato pranë Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion në Ministrisë

së Drejtësisë, e cila pas kryerjes së hetimeve administrative dhe vlerësimit të bërë, i dërgon rastet në PSH/Prokurori. Në total gjatë vitit 2021, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka kryer 12 kallëzime penale për 4 institucione. Kjo përbën rritje me 40% në krahasim me vitin paraprak, çka përbën arritjen e vlerës së synuar në masën 100%, për vitin 2021.

Gjithashtu, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka pasur dinamikë të përhershme njoftimesh në webin e Kryeministrit edhe në web.zyrtar të shqiperiaqeduam.al. Në funksion të masës C.2.3, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar takime mes qytetarëve, Kryeministrit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ADB në qarqet Vlorë, Elbasan, Berat, Shkodër, Lezhë etj. Në këto takime është promovuar ligji i ri “Për bashkëqeverisjen”, dhe janë trajtuar tema që lidhen me denoncimin për raste korruptive dhe shërbimet online të ofruara në portalin e-albania (monitorimi dhe dhënia në afatin 24/72 orë të shërbimeve në sistemin SQDNE, si detyrë funksionale e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Metodologjia e treguesit të performancës parashikon se Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) duhet të ndjekë rastet e korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al) derisa ato raste të pushohen ose zgjidhen administrativisht nga institucionet e linjës, ose të përcillen në Policinë e Shtetit.

Duke mbajtur në konsideratë numrin e rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al), të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare dhe objektivin për të pasur një rritje prej 40% në krahasim me vitin 2020, konstatohet se kjo vlerë nuk është arritur për vitin 2021.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak
	2020	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 58%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	100%
	2022	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak

<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak
-------------------------------	------	---

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	Numri i rasteve të gjeneruara nga portali <a href="http://www.stopkorrupsionit.al">www.stopkorrupsionit.al</a>	
Vlera e synuar 2018	25% rritje	0
Vlera e synuar 2019	30% rritje	0
Vlera e synuar 2020	40% rritje	0
Vlera e synuar 2021	40% rritje	12

### ***Niveli i realizimit të Objektivit C.2***

Niveli i realizimit të *Objektivit C.2* “*Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit*”, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR C. 2 = \frac{TP1 C.2.a (100\%) + TP2 C.2.b(100\%)}{2TP} \times 100\% = 100\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.2 për këtë periudhë raportimi është shumë mirë (nga 68 në 110 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021.

### **Risqet për realizimin e Objektivit C.2**

Rreziku i arritjes së këtij objekti është i lartë për shkak të trajtimit të ankesave dhe denoncimeve që lidhen me veprat penale të korrupsionit dhe sfidës për të rritur besimin publik, me qëllim shtimin e përdorimit të mekanizmave për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit.

### **C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile**

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*C.3.a: Hartimi i një Programi Antikorrupsion nga AMSHC-ja*

*C.3.b: Raporti i projekteve të antikorrupsionit të financuar nga AMSHC*

*C.3.c: Alokimi i buxhetit në mbështetje të projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të*

Plani i Veprimit për Objektivin C.3 parashikon (9) Aktivitete dhe (2) Produkte/Masa.

#### **C.3.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.a** për vitin 2021 vlera e synuar është: *përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2020*; për vitin 2022 është *përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2021* dhe për vitin 2023 vlera e synuar është *përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2022*.

Për vitin 2020, nga informacioni i raportuar për moskryerje të asnjë aktiviteti dhe produkti të parashikuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, nuk është arritur vlera e synuar.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1.1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1.2	Pritja e aplikimeve 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)
C.3.1.3	Vlerësimi i aplikimeve
C.3.1.4	Shpallja e fituesve
C.3.1.5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1.6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.



Për periudhën e monitorimit, *janar-dhjetor 2021*, janë hatuar termat e referencës, janë pritur aplikime për projekte, të cilat janë vlerësuar dhe janë shpallur fituesit. Lista e projekteve fituese është publikuar në faqen zyrtare të AMShC. Projektet e identifikuar mbi luftën kundër korrupsionit, do të shfaqen në Planin e Antikorrupsionit në faqen zyrtare të AMShC së bashku me të dhënat e tyre, qëllimin, target- grupet etj. Aktiviteti C.3.1.6 është i pazbatuar për shkak se projekti vijon të implementohet.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi është realizuar, në vitin 2021, pasi AMShC ka vlerësuar aktivitetin për vitin 2020, duke hartuar një vlerësim mbi zbatimin e programit antikorrupsion, i cili është publikuar në faqen zyrtare të AMShC. <https://amshc.gov.al/thirrje-nr-14-per-projekte/>

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	N/A
	2018	N/A
	2019	Ngritja e programit antikorrupsion; Prodhimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të programit antikorrupsion
	2020	Është përfunduar vlerësimi mbi zbatimin vjetor të programit antikorrupsion të vitit 2019 (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2020
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	100%
	2022	Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2021
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2022

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet në tabelën më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	AMSHC nuk ka programi Anti-Korrupsion për të orientuar financimin e projekteve Anti-	

	Korrupsion zbatuara nga organizata të shoqërisë civile	
Vlera e synuar 2018	Hartimi dhe miratimi i programit Anti-Korrupsion (duke përfshirë dhe Planin e Veprimit 2019-2020)	Programi Anti-Korrupsion nuk u miratua në vitin 2018
Vlera e synuar 2019	Hartimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Programit Anti-Korrupsion (si pjesë e veçantë e raportit vjetor të Agjencisë)	Programi Anti-Korrupsion u miratua në vitin 2019
Vlera e synuar 2020	Është kryer vlerësimi i jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit Anti-Korrupsion të vitit 2019	Vlerësimi i jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit Anti-Korrupsion të vitit 2019 nuk është kryer
Vlera e synuar 2021	Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2020.	Është hartuar dhe publikuar vlerësimi për programin antikorrupsion të vitit 2020.

### C.3.b

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.b** për vitin 2021 vlera e synuar është rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm, për vitin 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Gjatë vitit 2020, vlera e synuar për treguesin e performancës C.3.b ishte: rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm, vlerë e cila nuk u arrit.

Për vitin 2021, vlera e synuar është financimi nga AMSHC në masën 25% i projekteve mbi anti-korrupsionin.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1.1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1.2	Pritja e aplikimeve; 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)
C.3.1.3	Vlerësimi i aplikimeve
C.3.1.4	Shpallja e fituesve

C.3.1.5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1.6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Në periudhën e monitorimit, *janar-dhjetor 2021*, janë hartuar termat e referencës, janë pritur aplikime për projekte, të cilat janë vlerësuar dhe janë shpallur fituesit. Lista e projekteve fituese është publikuar në faqen zyrtare të AMSHC, në linkun: <https://amshc.gov.al/thirrje-nr-14-per-projekte/>. Projektet e identifikuar mbi luftën kundër korrupsionit, do të shfaqen në Planin e Antikorrupsionit në faqen zyrtare të AMSHC së bashku me të dhënat e tyre, qëllimin, target - grupet, etj. Aktiviteti C.3.1.6 është i pazbatuar për shkak se projekti vijon të implementohet.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar, për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se vetëm 0.44 % e projekteve aplikuese, kanë qenë të orientuara nga programi antikorrupsion, çka nuk arrin targetin e synuar prej 25% të parashikuar për zbatim gjatë vitit 2021.


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	14.29%
	2018	N/A
	2019	20%
	2020	20% (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>25%</b>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>0%</b>
	2022	25%
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	25%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet në tabelën më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	14.29%	

Vlera e synuar 2018	20%	0
Vlera e synuar 2019	25%	17.3%
Vlera e synuar 2020	25%	0
Vlera e synuar 2021	25%	0



### C.3.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.c** për vitin 2021 është: **rritje 25% në krahasim me vitin e mëparshëm**, për vitin 2022 dhe 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Gjatë vitit 2020, nga informacioni i raportuar për moskryerje të asnjë aktiviteti dhe produkti të parashikuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, nuk është arritur vlera e synuar.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

C.3.1	Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV)
C.3.1.1	Hartimi i termave të referencës
C.3.1.2	Pritja e aplikimeve 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit)
C.3.1.3	Vlerësimi i aplikimeve

C.3.1.4	Shpallja e fituesve
C.3.1.5	Raportimet finale të OSHC-ve
C.3.1.6	Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Për periudhën e monitorimit, *janar-dhjetor 2021*, nuk është arritur vlera e synuar, gjë e cila argumentohet si më poshtë:

Viti 2021, solli përmirësim të gjendjes nga Pandemia Globale ndaj dhe AMShC vijoi procesin normal të ofrimit të asistencës financiare në funksion të programit AK. Aktualisht, AMShC ka shpallur kandidatë përfitues të fondeve, një numër organizatash me një vlerë rreth 11.850.000 Lek, që përbën 46,93% të vlerës prej 25.250.000. Kjo shifër nuk ka arritur targetin vjetor për vitin 2021, i përcaktuar në masën 25.250.000 (si vlera e 25% të parashikuar për financim të projekteve lidhur me anti- korrupsionin).


Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<b>Vlerat Bazë</b>	N/A	
	N/A	
	2017	13.56%
	2018	N/A
	2019	20%
	2020	20% (treguesi është arritur në masën 0%)
<b>Vlera e synuar/ Targeti</b>	<b>2021 (targeti i synuar)</b>	<b>25%</b>
	<b>2021 (targeti i arritur)</b>	<b>0%</b>
	2022	25%
<b>Vlera e synuar/Targeti</b>	2023	25%

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet në tabelën më poshtë:

	Projeksioni sipas vlerës së synuar	Vlera e arritur
E dhëna fillestare bazë	13.56%	

Vlera e synuar 2018	20%	0
Vlera e synuar 2019	25%	20%
Vlera e synuar 2020	20%	0
Vlera e synuar 2021	25%	0



### ***Niveli i realizimit të Objektivit C.3***

Niveli i realizimit të *Objektivit C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 **është 33.3%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ C.3 = \frac{TP1\ C.3.a\ (100\%) + TP2\ C.3.b\ (0\%) + TP3\ C.3.c\ (0\%)}{3TP} \times 100\% = 33.3\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit C.3 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31-50 për qind e masave të realizuara).

### **Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për monitorimin e vitit 2021. Lista e projekteve

fituese është publikuar në faqen zyrtare të AMShC- së në linkun: (<https://amshc.gov.al/thirrje-nr-14-per-projekte/>)

### **Risqet për realizimin e Objektivit C.3**

Risku i realizimit të këtij objekti është i ulët për shkak të mosorganizmit dhe proceseve të brendshme rregullatore, pra ka mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të lartë të tij.

#### ***Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit (Qasja C)***

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit është 44.33%.

Objektivi	Realizueshmëria
C.1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	100%
C.2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	100%
C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	33.3%

Ndërgjegjësimi i qytetarëve në luftën kundër korrupsionit është padyshim një nga 3 kolonat kryesore të kësaj përpjekje të përbashkët në nivel kombëtar. Për këtë arsye, institucionet e përcaktuara nga Plani i Veprimit duhet të marrin në tërësi një rol proaktiv për të arritur rezultate më të larta sidomos në ato objektiva që kanë pasur një realizueshmëri kostante jo të mirë përgjatë viteve 2019, 2020 e aktualisht 2021. Duke mbajtur në konsideratë të gjitha portalet aktive ku denoncohen rastet e korrupsionit, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje përveç faktit që i përcjell të dhënat pranë Ministrisë së Drejtësisë, do duhej të bëjë edhe një kategorizim të raportimeve/sinjalizimeve të qytetarëve mbi fusha të ndryshme ku qytetarët shprehin shqetësimet e tyre. Nga ana tjetër, nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit duhet të njohë patjetër një zhvillim të ri, pasi gjatë vitit 2021, siç vihet re nga analiza totale e këtij raporti monitorimi, mekanizmat për denoncimin e korrupsionit janë aktive dhe të aksesueshme nga qytetarët. Organizatat e shoqërisë civile kanë aplikuar në projekte konkrete që

lidhen me fushën e korrupsionit. Nga monitorimi i qasjes ndërgjegjësuere, rezulton se AMSHC do duhet t'i orientojë ato për të zhvilluar fushata konkrete sipas specifikimit në masat dhe aktivitetet e Planit të Veprimit, me qëllim përmirësimin e realizueshmërisë të kësaj qasjeje. Mekanizmat për denoncimin e korrupsionit shërbejnë si bazë e rëndësishme për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë mbi fenomenin e korrupsionit, rritur standartet në nivel kombëtar dhe siguruar që Shqipëria të rrisë nivelin e performancës në kudër të përpjekjeve në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

### III. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT REZULTATET DHE IMPAKTIN

#### 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të aktiviteteve dhe masave të realizuara, të treguesve të performances, realizimi i objektivave për *janar - dhjetor 2021* është si më poshtë.

Realizimi sipas aktiviteteve/masave	Realizimi sipas treguesve <sup>46</sup>
Dobët - 0 objektiva	Dobët - 2 objektiva
Mjaftueshëm - 4 objektiva	Mjaftueshëm - 4 objektiva
Mirë - 10 objektiva	Mirë - 3 objektiva
Shumë mirë - 4 objektiva	Shumë mirë - 7 objektiva
Tejkaluar – N/A objektiv	Tejkaluar - 2 objektiva

#### Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën *janar – dhjetor 2021*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit janë si më poshtë vijon:

1. Për vitin 2021, është rritur transparenca e autoriteteve publike në nivel qendror dhe vendor. 300 nga 374 autoritete publike kanë zbatuar saktë programin e transparencës. Regjistri elektronik qendror për ankesat dhe përgjigjet në autoritetet publike, është operacional në 95 autoritete në përfundim të vitit 2021.
2. Për vitin 2021, nga APP janë miratuar rregullat e prokurimit publik, të cilat detajojnë përmbajtjen e njoftimeve paraprake dhe ka miratuar edhe 29 sete të dokumentave standarde

<sup>46</sup> Ibid footnote 5.



të tenderit sipas tipit të kontratës mall, punë apo shërbim, pjesë e të cilave janë edhe formularët standard për këto njoftime.

3. Për vitin 2021, AKSHI ka vijuar me shtimin e shërbimeve për ofrimin e aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset, online, total prej 1212 shërbimesh elektronike. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe punonjësit e administratës publike mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve.
4. Për vitin 2021, Policia e Shtetit ka kryer 35 procedime penale me shumë se gjatë vitit 2020, në fushën e korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Gjatë vitit 2021, janë kallëzuar pranë strukturave të policisë 110 vepra penale, si rezultat i kallzimeve nga qytetarët, të cilat edhe janë referuar në prokuroritë e rretheve gjyqësore; janë imlikuar 154 autorë, nga të cilët 8 janë arrestuar dhe 146 janë proceduar në gjendje të lirë. Është ngritur njësia hetimore për krimin ekonomik e financiar në Drejtorinë Qendrore Hetimore, brenda Departamentit të Policisë Kriminale, në Policinë e Shtetit, me 50 oficerë në organike.
5. Për vitin 2021, Ministria e Drejtësisë ka ngritur dhe organizuar strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në rolin e saj si Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit. Janë zhvilluar 4 komunikime publike ku janë bërë publike veprimet ligjore të KKK, i cili ka vepruar në mënyrë proaktive duke kryer kallzime penale për raste konkrete pranë organeve të zbatimit të ligjit. Është rishikuar Plani vjetor të 2021 i Vizibilitetit dhe Komunikimit në fushën e antikorrupsionit. Janë ndërmarrë aktivitete, takime, forume, konferenca me grupe interesi në fusha të ndryshme si akademi, sport, biznes, shoqëri civile, etj. Është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik në 4 shkolla të arsimit të mesëm të lartë, në Tiranë dhe ka filluar të hartohet prej muajit qershor 2021, e në vijim, një buletin mujor me përmbledhje të produkteve dhe aktiviteteve kryesore të Ministrisë së Drejtësisë/KKK.
6. Për vitin 2021, janë hartuar dhe miratuar Planet e Integritetit në 12 institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
7. Për vitin 2021, është ngritur regjistri elektronik për mbajtjen dhe raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, që administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i cili është funksional në 90 % të tij.
8. Për vitin 2021, janë hetuar gjithsej 255 procedime me 129 persona në hetim. Janë regjistruar të reja gjithsej 123 procedime me 56 persona nën hetim përgjatë vitit. Janë përfunduar 90 procedime penale me 80 persona. Janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 25 procedime penale me 53 të pandehur ndërsa me kërkesë për pushim, 21 procedime penale me 8 persona në hetim. Janë transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 35 procedime penale me 19 persona në hetim. Janë pezulluar 9 procedime penale dhe mbeten në hetim 153 procedime penale me 48 persona në hetim.

9. Për vitin 2021, Policia e Shtetit ka arritur të ketë akses në 9 baza të dhënash të reja, konkretisht: Regjistri i Gjendjes Civile; Regjistri i lejeve të drejtimit; Regjistri i Institutit të Sigurimeve Shoqërore; Regjistri i QKB; Regjistri i automjeteve; Sistemi TIMS; Regjistri mbi Aplikimet në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve; Regjistri i Aplikimeve të bëra në Zyrën e Punësimit dhe Regjistri i të Dhënave Spitalore. Policia e Shtetit ka akses në 20 databaza të dhënash gjithësej, duke kaluar kështu objektivin me 18 databaza, të përcaktuar si target për vitin 2021.
10. Për vitin 2021, SHÇBA ka referuar pranë organit të Prokurorisë 224 çështje për 329 subjekte, të cilat sipas nivelit të drejtimit, ndahen në: 88 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 223 punonjës policie të nivelit zbatues; 10 punonjës civil (administrativ); 3 efektiv të Gardës; 5 PMNZSH dhe 61 shtetas.

### **3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit**

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2021*, rezultojnë se fushat që kanë treguar performance jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi janë objektive specifike të shpërndarë në të tre qasjet e SNKK, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezultojnë se:

1. Çështjet që lidhen me komunikimin, informimin, proceset operationale dhe sistemet e komunikimit brenda vetë institucioneve raportuese, çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm që afektojnë direkt zbatueshmërinë e masave dhe aktiviteteve të planifikuara për zbatim, janë sfida, mangësi dhe shkaktarë të joefikasitetit në disa objektiva (psh A.11, B2, B3 e C2) gjatë zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion.
2. Ka nevojë të forcohen kapacitetet dhe të përmirësohet bashkëpunimi me sektorët e financës të pikave të kontaktit antikorrupsion, pasi mungesa e raportimit financiar passjell vërshtirësi në procesin e analizës së raportimit të kryer, ekzekutimin e buxhetit dhe sidomos rezultatet përfundimtare.
3. Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional në shkëmbimin e të dhënave, dhënies akses në baza të përbashkëta sipas procesve të punës, ndërmarrja e nismave aktive për të ngritur grupe të përbashkëta ndërinstytucionale, do të shërbejnë në përmirësimin e nivelit të realizueshmërisë së objektivave vjetorë si dhe masave dhe aktiviteteve që paraqet Plani i Veprimit 2020 - 2023.
4. Lidhur me qasjen ndërgjegjësuese, ka ende shumë hapësirë për të përfshirë dhe orientuar organizatat që të adresojnë çështje të antikorrupsionit në fushatat e tyre publike, duke përfshirë edukimin mbi parandalimin dhe mekanizmat e denoncimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit.
5. Çështjet që lidhen me kapacitetet administrative planifikuese, zbatuese dhe raportuese të institucioneve përgjegjëse të Planit të Veprimit, çështje që lidhen me partnerët e jashtëm

si dhe rreziqe që lidhen me planifikimin, proceset, sistemet IT dhe sistemet e tjera mbështetëse, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në objektivet e disa institucioneve.

6. Ka ende nevojë të plotësohet verifikueshmëria e të dhënave të raportuara nga institucionet zbatuese.

### 3.3 Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës (Qasjeve të strategjisë), të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (output/produkte) të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – dhjetor 2021*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

- Me qëllim që të forcohen kapacitetet e strukturave teknike dhe strukturave raportuese që japin kontributet e tyre në funksion të këtij raporti monitorimi, sugjerohet që të zhvillohen disa trajnime me fokus zhvillimin e dokumentave të politikave (policy paper) dhe të kryhen aktivitete konkrete në këtë drejtim.
- Duke synuar përmirësimin e procedurave administrative institucionale, rritur cilësinë gjatë punës si dhe përparimit të ndjeshëm drejt objektivave strategjike, ministritë e linjës sugjerohen të krijojnë praktika të konsoliduara pune dhe raporte vjetore mbi proceset e tyre administrative, në mënyrë që të krijojnë rezultate efektive dhe të amortizojnë pengesat apo vështrirësitë që dalin në përballimin e kostove teknike, financiare dhe njerëzore.
- Duke mbajtur në konsideratë temat e ndryshme të trajnimeve që përcakton Plani i Veprimit 2020-2023, të shpërndara në masat dhe aktivitetet respektive, është shumë e rëndësishme që insitucionet raportuese të japin të dhëna indikative mbi: tematikat vjetore që trajtohen; qëllimin e kryerjes së trajnimit dhe stafin e përfshirë. Gjithashtu, sa i takon planifikimit strategjik vjetor të tematikave të trajnimit, ato duhet të hartohen duke patur në vëmendje nevojat e stafit teknik, mangësitë më të mprehta që janë evidentuar, nevojat e punës dhe gjithashtu parashikimet në këtë plan veprimi, apo strategji të tjera, të cilat janë të detyrueshme

për t'u ndjekur dhe zbatuar nga secili institucion. Kjo gjë duhet të mbahet parasysh sa i takon përcaktimit të temave të trajnimeve për vitin 2022, 2023 e me rradhë.

- Sugjerohet që analiza e riskut të bëhet mbi baza reale, duke u mbështetur fort mbi masat dhe aktivitetet e përealizuara, të realizuara pjesërisht apo që rezultojnë në proces, duke krijuar kështu premisën reale për të korigjuar të metat e evidentuara dhe shmangur riskun për aq sa është e mundur, në raportet vijuese të monitorimit të Planit të Veprimit.
- Të përmirësohet arritja e vlerave të synuara në treguesit për treguesit e performancës A7; A.11, B1; B2, B3, e C3, të cilët duhet të kishin një nivel të mirë realizueshmërie për periudhën konkrete, si dhe të vijojë me përmirësimin e vlerës së synuar në treguesit e raportuar shumë mirë, por ende nuk kanë arritur vlerën 100% të tij si për shembull objektivi A5.
- Kërkohej të adresohen aktivitete konkrete të Planit të Veprimit 2020 – 2023, të cilat janë të pazbatuara, apo kanë patur një trend të ulët përgjatë gjithë periudhës së zbatimit, me qëllim që të reflektohen dhe të integrohen në një dokument të ri politikash.
- Duke mbajtur në konsideratë faktin se Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, përfundon aktualisht në vitin e shtatë të zbatimit të saj, në raportimin e ardhshëm pikat e kontaktit antikorrupsion (rrjeti) të orientohen drejt kryerjes së një analize në nivelin makro, sa i takon aktivitetet, masave dhe treguesve të performancës që lidhen ngushtësisht me fushën e tyre të përgjegjësisë. Kjo analizë do të na shërbente për të matur nivelin e zbatimit të tyre përgjatë këtyre viteve, krahasuar me ato objektiva për të cilët Shqipëria do duhet ende të përmirësohet, për të arritur standartet e synuara në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European.

#### **IV. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR**

##### **4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit**

Në këtë raport monitorimi, *janar – dhjetor 2021*, është kryer vlerësimi i riskut për çdo objektiv në përputhje me analizën e riskut të sjell prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të kësaj analize, të vlerësimit që vetë stafi AK i ka bërë riskut në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së objektivave.

Ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet institucionale, kapacitetet financiare, mjedisin rregullator, partneriteti dhe bashkëveprimi institucional, komunikimi, proceset e punës por dhe faktorë të tjerë të jashtëm.

Objektivë me risk të ulët janë: 6 objektiva

Objektivë me risk të mesëm janë: 8 objektiva

Objektivë me risk të lartë janë: 4 objektiva

## 4.2 Hapat e radhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për periudhën *janar-dhjetor 2021*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

Objektivi A5: Të fillojë kryerja e deklaramit të pasurisë dhe interesave privatë nga subjektet deklaruese dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet sistemit online dhe vijimi i punës me regjistrimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm.

Objektivi A6: Të zhvillohet modeli i raportimit financiar si dhe me trajnimet përkatëse me personat përgjegjës për financat e partive politike për vitin kalendarik. Të merren mesa për auditimin e raporteve financiare të fushatës elektorale dhe partive politike gjithashtu.

Objektivi A7: Shqyrtimi i sinjalizimeve të jashtme të regjistruara për inspektim financiar publik dhe rritja e rasteve të auditit të brendshëm, për të cilat duhet të referohen inspektimet financiare.

Objektivi A11: Miratimi i planeve të integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut nga bashkitë e tjera dhe alokimi i buxhetit përkatës për zbatimin e tyre.

Objektivi B1: Përditësimi dhe plotësimi i regjistrimit elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe rritja e kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit.

Objektivi B2: Të vijohet me rritjen e numrit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore për policinë dhe prokurorinë me qëllim që të arrihen treguesit e performancës në vijim

Objektivi B3: Finalizimi i vendimmarrjes dhe ngritja e funksionimi i Zyrës së Rekuperimit të Aseteve.

Objektivi C3: AMSHC duhet të nxisë organizatat e shoqërisë civile që të aplikojnë në projekte që lidhen me tematikën e antikorrupsionit, duke u fokusuar mbi fusha të ndryshme, në të cilat rezultoni se është më i përhapur korrupsioni në vend. Gjithashtu AMSHC do duhet të hartojë një program anti-korrupsioni, si një tregues performancë i përealizuar në vite.